**Republika e Kosovës / Republicof Kosova**
**Komuna - Municipality**
**Hani i Elezit**

**01/Nr.05 46/2023**

**Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:**

## F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e dymbëdhjetë -XII- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 28.12.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

## RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2024.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
5. Draft plani lokal i veprimit për Barazi Gjinore .
6. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
7. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
8. Raporti i planit të integritetit për vitin 2023.
9. Të ndryshme.

**Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-**

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e planit të punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
- Materialin e planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2024.
- Materialin e planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
- Materialin e draft planit lokal i veprimit për Barazi Gjinore .
- Materialin e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
- Materialin e informatës për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
- Materialin e raportit të planit të integritetit për vitin 2023.

Hani i Elezit
Data:-19.12.2023

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Florim Shkreta**

**01/Nr. 10547 /2023**
**Data:19.12.2023**

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.11.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi**(Kryetar i Komunës), **Kimete Kuka -Hasallari**(Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** ( Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** ( Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për pronat komerciale.**
3. **Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.**
4. **Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.**
5. **Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.**
6. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikave të rendit të punës të cilat ua kemi përcjellë kemi edhe dy materiale shtesë që na i ka përcjell ekzekutivi i komunës propozim vendimin për fillimin e hartimit të planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit propozim vendimi për faljen e faturave të tatimit në pronë për vitin 2023 deri në shumën prej 100 euro, për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

**Procedojmë me këtë rend të punës:**

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për pronat komerciale.**
3. **Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.**
4. **Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.**
5. **Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.**
6. **Propozim vendimin për fillimin e hartimit të planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit.**
7. **Propozim vendimi për faljen e faturave të tatimit në pronë për vitin 2023 deri në shumën prej 100 euro.**
8. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

2. **Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për pronat komerciale.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- departamenti i tatimit në pronë në Ministrinë e Financave dhe Transfereve ka bërë vlerësimin e pronave në kategorinë e pronave komerciale në tokë dhe në objekte si dhe janë përcaktuar zonat e vlerave dhe nivelet e vlerave të pronave të paluajtshme brenda territorit të Komunës . Departamenti është bazuar në kontratat e shitblerjeve që ka të bëjë me shitblerjen e tokave apo të objekteve me vullnet të lirë të të dya palëve , gjithashtu janë bazuar edhe te anketa me qytetarë opinione dhe sugjerime nga zyrtarët komunal dhe të bankave. Në material e keni raportin e detajuar.

**Hyrijete Isufi** thekson:- këto vijën të gatshme prej nivelit qendrorë dhe nuk kemi diçka se çka të shtojmë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUAR VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË TATIMIT PËR PRONAT KOMERCIALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2024**

3. **Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- është dokument i rëndësishëm për komunën tonë sepse çdo ditë dhuna po rritet në nivel nacional dhe në nivel global. Falënderojmë përfaqësuesit e OSB-së të cilët kanë kontribuar në hartimin e këtij draft plani që fokusi kryesorë ka qenë në parandalimin e këtyre dukurive.

**Sherif Berisha** thekson:- ky plan po besoj që është bërë nga personat përgjegjës dhe profesional dhe është me rëndësi që kontakte se ku duhet të drejtohet një viktimë e dhunës në familje të arrijë në secilën shtëpi dhe në secilën familje. Ky mekanizëm duhet gjetur metoda për njoftim të qytetarëve se cilave institucione të ju drejtohet dhe kjo besojë që është shumë me rëndësi, ndonëse ky plan nuk do të mbetet vetëm në letër. Sa i përket objektivave specifike të cilat i keni paraqitur të implementohen në praktikë dhe të punohet në parandalimin e dhunës në familje dhe në ngritjen e vetëdijes qytetare se dhuna në familje nuk duhet të ndodhë në asnjë rrethanë. Po ashtu keni paraqitur rastet e dhunës në familje të raportuara për tri vite po ashtu keni potencuar se shifrat janë edhe më të mëdha por nuk janë paraqitur në raport. Ne duhet të punojmë që ti inkurajojmë qytetarët që rastet e dhunës në familje që të raportohen në organet përgjegjëse. Në këtë plan të veprimit keni paraqitur një kosto buxhetore nga viti 2024-2026 në shumë prej 2550 € por nuk e di a është paraparë në buxhet kjo shumë e mjeteve financiare.

**Hyrijete Isufi** thekson:- a keni pasur më herët plan veprimi për parandalimin e dhunës në familje.

**Amir Bushi** thekson:- plan strategjik nacional ka pasur ndërsa komuna nuk ka pasur plan të veprimit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE 2024-2026**

4. **Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- Ministria përkatëse na e ka obliguar që ta themelojmë një ekip për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe po ashtu na kanë obliguar që të kemi planin e veprimit për dy vitet e ardhshme. Në plan janë të parapara objektivat që do të realizohen përmes drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe të gjithë akterëve që janë pjesëmarrës në këtë plan.

**Sherif Berisha** thekson:- ky plan kërkojmë që të implementohet në praktikë por edhe ky plan ka kosto buxhetore por nuk kam informacion se a është përfshirë në vitin 2024.

**Amir Bushi** thekson:- ky plan është bërë në harmonizim me projektet kapitale të cilat do të realizohen në tri vitet e ardhshme.

**Lindita Ballazhi** thekson:- çdo aktivitet që është në kuadër të dy planeve janë disa burime të financimit si të hyra të komunës dhe nga grandet qeveritare dhe është lënë edhe një hapësirë prej organizatave dhe donatorëve të ndryshëm.

**Sherif Berisha** thekson:- është e paqartë se nuk ka specifikim të drejtë për drejtë për këtë kategori është dashur të specifikohet shuma.

**Amir Bushi** thekson:- gjatë hartimit të këtij plani janë paraparë shuma në rregullim të kanalizimeve, ujësjellësit dhe ajo shifër është në të mirë të qytetarëve. Plani ka për qëllim që me i nxitur drejtorët komunal që me nxitë komunën për me i kryer obligimet e veta. Në kuadër të këtij plani drejtoritë përkatëse obligohen me i realizuar projektet që i mungojnë komunës së Hanit të Elezit.

**Hyrijete Isufi** thekson:- në plan janë paraprë të drejtat e fëmijëve për shkollim por dihet që shkolla fillore është e obligueshme dhe jemi të vetëdijshëm që u japim mundësinë edhe për shkollim të mesëm por çdo e drejtë që e fiton i ka edhe përgjegjësitë e veta dhe nuk është përgjegjsi sepse vjen në shkollë dhe nuk e mbanë asnjë orë pastaj potencon se e dua shkollën dhe duke ju dhënë të drejta po na humbin do sjellje të mirëfillta.

**Amir Bushi** thekson:- në kuadër të vetëdijesimit duhet me pasur parasysh evokimin dhe vetëdijesimin dhe në kuadër tyre ligjërimi nuk duhet të jetë vetëm për fëmijët sepse e kuptojnë se kanë të drejtë për shkak se nëse potencojmë një të drejtë, i ka dhjetë deri në pesëmbëdhjetë përgjegjësi mbrapa dhe për atë arsye duhet të jemi të përgatitur që kur të bëhet ky evokim të jenë persona profesional që me i vetëdijësuar fëmijët dhe të rinjtë në këtë rast.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PLNI I PUNËS SË EKIPËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE 2024-2026**

## 5. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për performancën në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare '' Dr.Menduh Kaloshi" Qendrën Për Punë Sociale. Aktivitetet gjatë muajit Janar-Tetor në kuadër të DSHMS-së, Më 31.01.2023 kemi pranuar donacion nga kompania Ipko: aparaturë Ultrazë me vlerë 12,000€. Rregullimin e disa filterave të ngrohjes në QKMF. Kam përcjell në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Shëndetësisë kërkesën për shtim të stafit në QKMF. Rregullimin dhe riparimin e rrjetit elektrik ne objektin e QKMF-së. Ndërrimin e sanitarisë në QKMF. Janë dhuruar 100 pako ushqimore familjeve në nevojë nga Arabia Saudite në bashkëpunim me organiztën Bereqeti. Janë dhuruar 300 pako ushqimore për familjet në nevojë nga organizata Qatar Charity. Me 20.04.2023 kemi bërë pranimin e donacionit nga kontingjenti i KFOR-it Italian të paneleve solare 12 kë për kursim të energjisë elektrike në QKMF. Përmes CARITAS-it kemi kontraktuar për shërbime shëndetësore, katër infermier dhe një mjekë i përgjithshëm. Nga data 05.07.2023 kemi bërë dezinfektimin dhe deratizimin e gjitha institucioneve publike në komunën ton me përjashtim të institucioneve shkollore ku do të realizohet në fund të muajit gushtë. Kemi rishpallur procedurat e projektit "Ndërtimi i depos në QKMF". SHARRCEM ka mbështetur edhe për gjashtë muaj stomatologun dhe infermieren. Më 02.06.2023 kemi mbajtur aktivitetin e dhurimit të gjakut, rreth 133 dhurues. Më 27.06.2023 organizata Humany First Kosova kanë dhuruar 60 pako me produkte të mishit për 60 familje ne nevojë. Më 29.06.2023 nga organizata Qatar Cherity janë shpërnda 100 pako me mish për familjet në nevojë. Është bërë dezinsektimi i gjitha hapësirave në Komunën e Hanit të Elezit në tri faza. Kemi nënshkruar marrëveshjen me Islamik Relief për mbështetjen me staf. Është bërë pastrimi i gjitha hapësirave në QKMF. Kanë filluar punimet e depos së QKMFS-së. Janë mbajtur aktivitete të shumta gjatë muajit Rozë për ndërgjegjësimin e sëmundjes së Kancerit të gjirit si: ekskursion një ditor me gratë e prekura me kancer të gjirit, ligjërata në disa fshatra dhe marrëveshjen me Spitalin Rajonal të Ferizajt të mamografis për 20 gra të komunës sonë.

**Zaim Bela** thekson:- procedurat me Islamik Reliefin për rekrutim të stafit ku kanë mbërri për shkak se dëgjova se një ditë i ka dërguar me veturë private dikush pacientët e dializës. Kërkoj sqarim për këtë çështje.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- sa i përket anës së komunës si drejtori i kemi përmbushur obligimet duke siguruar veturën dhe derivatet, ndërsa përgjegjësia e organizimit është direkt te drejtori i Qendrës së mjekësisë familjare dhe punëtori i cili është vozitës dhe nga kjo pa përgjegjësi kemi pasur një shqetësim javën e kaluar dhe kam kërkuar nga drejtori që të merren masa për shkak se ka ndodhur që shpesh kemi pasur problematika të tilla. Me shoqatën Relief Islamik kemi kërkuar që të kemi një shoferë i cili do të jetë i dedikuar vetëm për këtë kategori të pacientëve. Procedurat e rekrutimit të stafit janë në faza përfundimtare sepse janë duke i pritur afatet për shkak rregullave të cilat i kanë.

**Sherif Berisha** thekson:- furnizimi i rregullt me barna mjekësore nga lista esenciale nga Ministria e Shëndetësisë, ka ankesa të shumta të qytetarëve sa i përket barnave nga lista esenciale , mirëpo drejtoria ka një shumë të mjeteve prej dhjetë mijë euro dhe pse ka mungesë të barnave pasi që e keni këtë shumë. Planifikimi i rritjes së numrit për vizitat shtëpiake për nënat dhe fëmijët zero deri në tri vite si planifikohet të bëhet. Më intereson të dijë numrin e saktë të mjekëve në QKMF për shkak se na e dimë që dy mjekë janë larguar. Për çështjen e röntgenit i njëjti person jep përsëri kujdestari.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- sa i përket furnizimit me barna e dimë që ministria na i bien listën e mangët të barnave esenciale dhe pikërisht për këtë arsye e kemi kontratën e veçantë me kompaninë private dhe fatkeqësisht që ka skaduar kontrata e kompanisë dhe ka marr kohë procedura deri sa kemi lidhur kontratë me kompaninë tjetër dhe po besoj që nga fillimi i muajit furnizimi do të jetë i kënaqshëm. Organizimin e punëve atje e bënë pikërisht drejtori dhe unë nuk mundë të jem prezentë në çdo kohë atje për menaxhimin e punëve të cilat janë në përgjegjësi të vetë stafit menaxhus në QKMF. Sa i përket planifikimit të vizitave për nënat dhe fëmijët e kemi një program që është i implementuar në komunën tonë që zakonisht pas lindjeve dhe gjatë shtatëzanis bëhet së paku dy herë në vit për nënat dhe fëmijët , mirëpo numri i vizitave ka pasur rënie në krahasim me vitin e kaluar për shkak të rënies së numrit të lindjeve . Stafi mjekësorë nuk është i njëjtë sikur me numrin siç e kemi paraqitur në tabelë, mirëpo informata është për muajin janar tetor por mungesën e mjekëve e kemi në muajin nëntor.

**Kryesuesi** thekson:- është e vërtetë që punët në QKMF i menaxhon drejtori por ju jeni mbi drejtorin dhe shqetësimet e asamblistëve që bëhen vazhdimisht si drejtoresh duhet ta ngriti këtë çështje dhe të merrni masa e jo i njëjti problem me u diskutuar në çdo mbledhje të kuvendit.

**Resul Suma** thekson:- e pashë që është hapur konkursi edhe me Ministri për një infermierë, a janë zhvilluar procedurat. Ultrazëri i cili është në QKMF a e përdorë ndonjë kush. Mjeku që e ka lënë e di që ka pasur me u financuar prej komunës edhe për specializim çka ndodhë me mjetet financiare që janë të planifikuara.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- konkursi është për një infermierë, dy pozita të mjekut dhe pozita e drejtorit. Sa i përket ultrazërit mjekët të cilët e kanë përdoru atë pajisje nuk janë më dhe shpresojmë që me rritje të stafit të japim praktika edhe të mjekëve të rijë që ta kryejnë këtë shërbim. Për çështje të rëntgenit jam konsultuar me drejtorin dhe nuk besoj që do të përsëritet më për shkak se kemi infermierë të mjaftueshëm. Me shkëputjen e kontratës me komunën tonë i shkëputet e drejta për specializim dhe mjetet barten në komunën tonë dhe nuk mundem me u zëvendsuar me ndonjë person tjetër për specializim.

**Refet Kalisi** thekson:- kërkoj sqarim për çështjen e filterëve për ngrohje. Dezinfektimi a ka qenë prej komunës si tenderë apo ka qenë donacion.

**Malik Berisha** thekson:- pasi që do ti kemi dy mjekë përmes Islamik Reliefit a do të ketë mundësi që në AMF-në e fshatit Gorancë që mjeku të jetë dy herë në javë.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- me filterët e ngrohjes kemi pasur probleme kur është ndërprerë rryma elektrike dhe e kemi ftuar kompaninë që ta sheh se ku është problemi dhe kompania na sugjeroj që të i ndërrojmë disa filterë në mënyrë që mos me pasur probleme gjatë nxehjes . Dezinfektimi dhe dezinfektimi ka qenë procedurë që e kam zhvilluar përmes drejtorisë së shëndetësisë që realisht është obligim ligjorë me u bërë dhe kompanitë përzgjidhen përmes zyrës së prokurimit. Me shtimin e stafit besoj që do të ketë mjekë dy herë në javë por ndoshta edhe më shumë .

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. **Propozim vendimin për fillimin e hartimit të planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- sipas legjislacionit në fuqi të gjitha komunat janë të obliguara që ta hartojnë planin për cilësi të ajrit që përmes objektivave të qarta dhe gjithë përfshirëse të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit në territorin e komunës respektivisht parandalimin e ndotjes së ajrit.

**Refet Kalisi** thekson:- a janë ndarë mjetet financiare për vitin 2024 për këtë plan.

**Nexhmedin Daci** thekson:- mallra dhe shpenzime kemi shumën prej njëzet mijë euro por nuk ka kosto të lartë plani.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMET PËR CILËSIN TË AJRIT**

**7. Propozim vendimi për faljen e faturave të tatimit në pronë për vitin 2023 deri në shumën prej 100 euro.**

**Kryesuesi** thekson:- para se të procedojmë më tutje me këtë pikë të rendit të punës, kërkoj një pauzë prej dhjetë minuta me shefat e grupeve parlamentare dhe drejtoreshën e financave në mënyrë që të konsultohemi për këtë pikë të rendit të punës. Pas konsultës të cilën e patëm me shefat e grupeve parlamentare fjalën ja jap Drejtoreshës për Financa.

**Lindita Ballazhi** thekson:- nga departamenti i tatimit në pronë i Ministrisë së Financave jemi njoftuar për vendimin e Gjykatës Kushtetuese e cila ka vendosur që dispozita shuma për faljen e mjeteve financiare të faturave të tatimit në pronë deri në 100 € është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Sipas vendimit të gjykatës komunave nuk ju cenohen përgjegjësitë komunale. Nëse merret vendimi për faljen e tatimit në pronë do t'i ketë disa pasoja sepse në bazë të disa llogaritjeve të cilat i kemi bërë humbja që do ta pësojmë është shuma rreth 163 000 €, kjo shumë mund të mos jetë e saktë pasi që kalkulimet e sakta duhet të bëhen nga departamenti i tatimit në pronë. Te falja e tatimit në pronë për vitin 2023 nuk e dimë se a përfshihet edhe kamata por kjo do të varet prej departamentit të tatimit në pronë.

**Refet Kalisi** thekson:- a merret për bazë viti 2023 për ata qytetarë të cilët nuk e kanë paguar apo u falet qytetarëve që me vite nuk kanë paguar.

**Sherif Berisha** thekson:- drejtoresha nuk e shpjegoi shumën tavan prej njëqind euro dhe pjesën tjetër që kushdo që ka më shumë se njëqind euro do të falen faturat deri në njëqind euro dhe ata të cilët kanë paguar vitin e ardhshëm u falet tatimi në pronë .

**Resul Suma** thekson:- është mirë të shënohet në vendim çmimi tavan deri në njëqind euro.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ju e dini që në seancën e Kuvendit kur kemi diskutuar për këtë çështje kam potencuar që duhet ta presim vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi është ardhur dhe ka një afat pesëmbëdhjetë ditorë kur ne duhet të marrim vendim në Kuvend po veç nuk e kemi detyrim për me falur por kemi shprehur vullnet për me i mbajtur edhe fjalët e mia që i kam dhënë këtu që pas vendimit të gjykatës ne mund ta diskutojmë këtë çështje. Çmimi tavan është deri në njëqind euro dhe nëse nuk është cekur në propozim vendim mund të përmirësohet sepse mund të jetë lëshim teknik. Deri njëqind euro janë falje e këtij viti 2023 dhe ata të cilët kanë paguar minusohen në vitin 2024. Çështjen e kamatës nuk e dimë por sipas mendimit tim nuk besojë që hiqet për shkak se obligim e ka secili me paguar tatimin. Shumica e komunave ndoshta nuk do ta kalojnë në kuvend se implikimi buxhetorë është shumë më i madh se te na dhe na tu e pasur vullnetin gjithë kemi ardhur me një propozim vendim për faljen deri në njëqind euro por përsëri do të jetë në dorën e juaj se a do ta falni apo nuk do ta falni se këto janë çështje tona dhe mos u bazoni në asnjë komunë se as unë nuk jam bazuar.

**Lindita Ballazhi** thekson:-vendimi vlen për të gjithë qytetarët si për ato të cilët nuk kanë paguar me vite të tëra si dhe për tatim paguesit e rregullt. Nëse miratohet propozim vendimi tatimi do të falet vetëm për vitin 2023 deri në vlerën prej njëqind euro.

**Kryesuesi** thekson:- kjo çështje është diskutuar edhe më herët por nuk kemi qenë të sigurt se a është në rregull me legjislacionin në fuqi. Ka qenë premtim edhe i Kryetarit të Komunës i cili është pro këtij vendimi për faljen e tatimit ndaj qytetarëve duke u bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Me shefat e grupeve parlamentare u dakorduam pro këtij propozim vendimi. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR FALJEN E FATURAVE TË TATIMIT NË PRONË PËR VITIN 2023 DERI NË SHUMËN PRE NJËQIND EURO**

**6. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Refet Kalisi** thekson:- kërkoj sqarim për çështjen e faturimin e çështjes së ujit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- e kam diskutuar çështje por e para ka qenë çështja e sigurimit të gjeneratorit, ndërsa çështja e faturimit varet prej atyre kur ata janë të gatshëm për me faturuar. Nëse nuk gabojë janë afër një qind orë pa u vendosur të ujëmatësve por është politikë e kompanisë "Bifurkacioni" se kur fillon inkasimin për shkak se ata i kanë politikat e tyre.

**Sherif Berisha** thekson:- kush do të merret me blerjen e gjeneratorit për shkak se nëse ndalet rryma po mbesim pa ujë . Me leje të kujt janë bërë ndryshimet e stafit në buxhetin për vitin 2024 dhe futja e projekteve të shëndetësisë dhe drejtorisë së kulturës. I drejtohem z.Sadik Rexhallari që ta bëjë publike listën e donatorëve për blerjen e parcelës për ndërtimin e shkollës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket gjeneratorit janë procedurat që duhet të udhëhiqen po nuk guxojmë me i zhvilluar sepse nuk kemi mjete financiare, por në vitin e kaluar i kemi planifikuar 30 000 € për me ja dedikuar kompanisë "Bifurkacioni" për ujëmatësit, për shkak të mungesës së mjeteve financiare nuk kemi mundësi blerë gjeneratorin . Sa i përket listës së donatorëve ju e dini që është një grup i qytetarëve të cilët e kanë regjistruar një OJQ dhe nuk besoj që është e rrugës që listën me publikuar por ne kemi menduar që në fund të tërë procesit me pasur listën e donatorëve dhe me lënë në arkiv të asaj shkolle. Nuk e di qa është rëndësia e publikimit të asaj liste, a është për ndonjë motivim apo për najë nxitje . Ka raste që dikush ka dhënë shumë të mjeteve financiare dhe ka kërkuar që mos me ju bërë publike emri dhe shtrohet pyetja në emër të kujt me ja publikuar, ka raste që dikush i ka dhënë dhjetë euro dhe ndihet keq nëse krahasohet me shumën prej dhjetë mijë euro për atë e kemi parë të arsyeshme që në fund të kryerjes së procesit listën në lënë në arkiv të shkollës.

**Resul Suma** thekson:- për çështjen e gjeneratorit a ka mundësi rryma me u lidhur m pjesën e poshtme të Dimcës, ndërsa pjesa lartë është e lidhur me Neqafe dhe kur po ka erëra të forta rryma po ndërprehët. Është mirë me ua potencuar përfaqësuesve të kompanisë së "Bifurkacionit" sepse orëmatësit të cilët i kanë vendosur janë te faturuar edhe pjesën e ajrit para se me ardhur uji. Janë duke e neglizhuar sepse kur ka qenë koha e mirë i kanë vendosur nga pesë orë në ditë në vend që me i vendosur nga 20 apo tridhjetë që me u kryer procesi më shpejtë. Është një puset te këndi i lojërave dhe është e dëmtuar dhe paraqet rrezik për fëmijët. Pyetje kemi parashtruar nga mbledhja e kaluar se pse nuk bëhen vendimet në komunën tonë dhe e kisha një rast një rast familjarë që ka kërkuar me ndërruar vendbanimin dhe zyrtari i cili është aty nuk e kryen punën.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- fabrika ende nuk është e lidhur në trafon e vetë por me të Paldenicës ashtu e kanë potencuar përfaqësuesit e KEDS-it. Fatkeqësisht them që KEDS-i është shumë neglizhentë për këtë çështje sepse shumë herë e kemi thirr dhe shpesh herë ka ndodhë që nuk e kanë hapur as telefonin dhe në momentin që komunikojmë potencojnë që ka me u kryer. Nga një herë disa çështje nuk janë për Kuvend por i kuptojë politikat që bëhen. Një puset para ndërtesës së madhe e kemi rregulluar për këtë tjetrën nuk jam në dioni por me gjithë atë është çështje që mund të rregullohet. Sa i paketë ndërrimit të vendbanimit është çështje e mos pajtimit me koeficientin të ciline ka shërbyesi civil. Kërkesën të cilën e ka parashtruar shërbyesi civil në këtë rast ne nuk kemi mundësi me ngritur në pozitën që ai e kërkon për arsye ligjore dhe ai pretendon që ka të drejtë ne nuk i kemi mundësitë dhe nuk e kryen punën sepse pretendon që nuk e kam në domenin e përgjegjësive të mia.

**Lindita Ballazhi** thekson:- me pranimin e qarkoreve buxhetore është specifikuar se sa do të jetë numri i stafit për vitin 2024, që ka të bëjë me administratën komunale sektorin e shëndetësisë dhe sektorin e arsimit. Në publikimet që i kam bërë në vebfaqe ka pasur disa ndryshime në disa programe dhe nën programe. Është bërë ndryshimi i statutit të komunës muaj më përpara dhe është ndarë drejtoria e arsimit dhe është formuar drejtoria për kulturë, rini dhe sport . Drejtorisë për zhvillim ekonomik ju ka shtuar edhe turizmi. Kanë ndodhur edhe disa ndryshime të vogla edhe në staf, drejtoria për kulturë rini dhe sport është ndarë në drejtori në vete kemi bërë kërkesë në Ministri për krijimin e një programi të rinë buxhetorë që përfshinë kulturën rininë dhe sportin që në këtë drejtori duhet të ketë edhe staf që do të jetë drejtorë apo drejtoreshë, është bërë kërkesë për dy shërbyesit civil që kanë qenë në kuadër të drejtorisë për arsim kulturë rini dhe sport do të bëhet transferi në drejtorinë në të cilën i përkasin. Drejtoria për kulturë rini dhe sport do të ketë një staf prej katër pozitave.

**Erblin Meliqi** thekson:- bashkësia islame ka bërë kërkesë te drejtoria për shërbime publike për me i rritur shpenzimet e varrimit dhe ende nuk kanë marr përgjigjie prej drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë. A ka shef të gjendjes civile komuna e Hanit të Elezit se komunat e tjera e kishin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- zyrtarisht me letra nuk ka shef të gjendjes civile sepse nuk ka vende të lira të caktuara dhe më herët përgjegjësitë i ka ndarë dikush tjetër dhe në bazë të përgjegjësive të punës është ajo që është. Unë e kam shikuar kontratën e punës që e ka dhe në fakt nuk ka për arsye se nuk kemi vend. Para se me ardhur në kuvend në legjislacionin e fundit është marr vendim për mi hequr shpenzimet e varrimit dhe ai vendim mund të merret për ngritje nga kuvendi i komunës sepse drejtori nuk i ngritë shpenzimet për shkak se nuk ka drejtë mi ngritë por duhet të merret vendimi duke u bazuar në mundësitë buxhetore. Kur janë bërë ndarjet buxhetore keni mundur me propozuar që me i ngritur shpenzimet për shërbimet e varrimit.

**Kryesuesi** thekson:- gjatë planifikimeve buxhetore kam kërkuar nga drejtoria që të parasheh këtë çështje për shkak se ka qenë premtim edhe i kryetarit për me i rritur shpenzimet e varrimit për shkak se janë ngritur çmimet e shpenzimeve të tjera. Sa i përket çështjes së ndryshimit të emrit apo mbiemrit shumë herët e kam diskutuar me drejtorët që të parashihen këto gjëra për ndryshim pozite që në të ardhmen siç e kemi situatën sot që shumë shpejtë dhe lehtë i kishim rregulluar këto çështje por nuk është marr parasysh e jo rastësisht jemi në këtë gjendje ku është një çështje shumë me rëndësi sepse edhe unë kam ankesa prej qytetarëve por ndoshta dëshira është e madhe e mundësit janë të kufizuara.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë kam pasur vullnet te gjendja civile për me i mbështetur për me i ngritur në detyrë për shkak të volumit të punëve dhe përgjegjësisë në punë që e kanë por nuk kam pasur mundësi ligjore. Nuk është ideja pse nuk është marr parasysh por mundësitë ligjore. Ne mund të themi se na vyen edhe dy asamblistë se pesëmbëdhjetë pak po na doken dëshirën e kemi por a mundemi mi shtuar nuk mundemi ligjërisht me i shtuar dhe nëse janë 249 pozita në institucione nuk mundemi mi bërë 250 . Nëse nuk ke pozicion të një shefi të gjendjes civile nuk mundemi me shpikur. Këtë çështje e kemi diskutuar disa herë sepse është lehtë me bërë vendimin por nuk është ligjore dhe nuk mundë të bëjmë vendim të kundërligjshëm . Kjo çështje ka mundur më herët me u kryer sepse sa kemi ne koordinatorë të administratës, shefa të autoparkut e lloj tjerë që mos ti përmendi ka mundur me u bërë edhe një shef i zyrës më herët e jo sodë kur nuk kemi vende. Kur janë nxënë krejt vendet tjera sot kërkohet diçka e pamundur, unë nuk mundem me shpikur sepse nuk dua të merrem me gjykata.

**Erblin Meliqi** thekson:- edhe ne nuk jemi kundër ligjit por komunat e tjera në organogram e kanë pse Hani i Elezit nuk e ka apo pse nuk është shikuar nga fillimi sepse komunat tjera e kanë këtë pozitë dhe Hanit të Elezit i mungon kjo pozitë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë e sqarova më lartë sepse pozitat janë zënë dhe nuk mundemi me shpikë për shkak se nuk kemi pozitë të lirë. I kam sugjeruar shërbyesit civil që të drejtohet në këshill të pavarur dhe nëse e kthen këshilli që me shpallë një konkurs të brendshëm atëherë përgjegjësia i bien këshillit dhe e shpalli konkursin.

**Zaim Bela** thekson:- sipas informatave që kam stafi i pylltarisë nga viti i ardhshëm kalon me agjension pyjorë a ua kanë ndalë buxhetin për këtë çështje.

**Lindita Ballazhi** thekson:- gjatë hartimit të buxhetit nuk ka pasur ndonjë vendim të tillë kështu që gjithë planifikimi i stafit është bërë në kuadër të drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, nëse do të ketë ndonjë ndryshim në muajt në vijim ndryshimi do të bëhet nga Ministria e Financave automatikisht në sistem.

**Sherif Berisha** thekson:- pse kanë probleme për çështje të printimeve nëpër shkolla dhe një lloj presioni për numër të kufizuar të printimeve. Kur është miratuar buxheti për shpenzimet e varrimit ka qenë një vijë dhe nuk ka pasur asnjë shumë dhe përgjigje kam marr se paguhen nga mallrat dhe shërbime.

**Hisni Luri** thekson:- më herët kemi pasur probleme për me i rregulluar printerët e vjetër të cilët i kemi pasur, kështu që së bashku me administratën e komunës kemi kontraktuar kompaninë dhe kemi paguar printimet nëpër shkolla dhe pastaj edhe komuna të vetat, mirëpo ka ardhur një faturë prej shkollës "Ilaz Thaçi" që ka arritur shumë prej 600 € dhe logjika po i bien që ne po shpenzojmë më shumë se sa me i pasur printerët tonë dhe kjo ka qenë arsyeja se pse i kemi ndërprerë kontratën të cilin e kemi pasur me kompaninë. Do të mundohemi që tash me i siguruar ngjyrat për printerët të cilët i kemi pasur.

**Refet Kalisi** thekson:- është e vërtetë që ka pasur pozita të shefave por janë zënë dhe a është e mundur që me bërë kompromis për me i shtuar orë tepër për mos me pësuar qytetarët.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- e kuptojë vullnetin tënd por nuk është e ligjshme për një punë që e ka përgjegjësi me bërë dhe ai pretendon që ka të drejtë mos me bërë për shkak se nuk është shef i shërbimit civil dhe atë të drejtë duhet me orientuar në këshillin e pavarur. Orë shtesë i jepen dikujt që punon jashtë orarit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:10.

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi**<br>**Avni Bushi** | **Kryesuesi i Kuvendit**<br>**Florim Shkreta** |

Republika e Kosovës / Republic of Kosova

Komuna - Municipality

Hani i Elezit

02/Nr. 10286 2023

| | |
|---|---|
| **DATA:** | 11.12.2023 |
| **PËR:** | Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës |
| **NGA:** | Mehmet Ballazhi,<br>Kryetar i Komunës |
| **LËNDA:** | Shkresë përcjellëse: Plani i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024 |

Të nderuar/a,

Me anë të kësaj shkrese, ju përcjellim materialin për Planin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Me respekt,

PLANI I I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2024

| AKTIVITETE | OBJEKTIVAT | PERIUDHA KOHORE | REZULTATET | PËRGJEGJËSIA |
|---|---|---|---|---|
| Takimet e KKSB-së | Gjendja e sigurisë ne komunë | Çdo dy muaj | Siguria e qytetarëve | Zyra e kryetarit dhe anëtarët e KKSB-së |
| Riparimi i dëmtimit të kapakëve të pusetave nga pa-përgjegjësia e ndërmarrjeve | Qarkullimi pa rreziqe në rrugë | Në vazhdimësi | Siguria e qytetarëve | Komuna-Drejtoria për Shërbime Publike |
| Siguria në shkolla (patrullime të policisë, legjitimime të herë pas hershme nga ana e policisë tek të rinjtë pa paralajmërim, ligjërata etj) | Evitimi i problemeve dhe incidenteve | Në vazhdimësi | Siguria e qytetarëve | Drejtoria për arsim Kulturë Rini dhe Sport, drejtorët e shkollave, Policia e Kosovës |
| Bashkëpunimi me KEDS-in për riparimi e rrjetit elektrik që paraqet rrezik direkt për jetën e banorëve dhe problemeve me rrymën elektrike | Evitimi i rrezikut nga rryma elektrike | Në vazhdimësi | Siguria e qytetarëve | DSHPE dhe KEDS-i |
| Organizimi i aksioneve të pastrim të mjedisit | Rritja e vetëdijes për ruajtjen e mjedisit | Së paku dy herë në vit | Mjedisi më i pastër | DKA, DSHPE, OJQ, etj |
| Siguria e Nxënësve gjatë Transportit | Zvogëlimi i rreziqeve për fëmijët shkollorë | Në vazhdimësi | Siguri më e mirë për nxënësit | DKA (Drejtoria Komunale e Arsimit) |
| Siguria në komunikacion (përmes vendosjes së shejave të komunikacionit dhe zebrat) | Parandalimi i aksidenteve | Në vazhdimësi | Zvogëlimi i aksidenteve dhe qarkullimi i lirshëm | Policia, KKSB-ja |
| Sensibilizim për parandalimin e narkotikëve dhe duhanit | Parandalimi i dukurive negative | Në vazhdimësi | Parandalimi i dukurive negative | Komuna, DKA, QPS, OJQ. |
| Vendosja e mbrojtëseve nëpër trotuare | Siguri per qytetarët | Në vazhdimësi | Siguria e qytetarëve | Komuna |
| Evidentimi i drunjve dhe objekteve të vjetra të cilat rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe marrja e masave që ky rrezik të evidentohet. KKSB do të caktojë rendin e ditës sipas rrethanave të paraqitura. | Zvoglimi i rreziqeve per qytetarë | Në vazhdimësi | Siguria e qytetarëve dhe ruajtja e pasurisë së qytetarëve | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural |
| Trajtimi dhe vetëdijesimi kundër dhunës në familje dhe fëmijëve. ( mbajtja e ligjeratave, shpërndarja e broshurave etj) | Familja e shëndoshë | Në vazhdimësi | Shoqëri pa dhunë | Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale dhe mekanizmi kundër dhunës në familje. |
| Parandalimi i Sjelljeve Devijante tek të rinjtë | | Në vazhdimësi | Shoqëri pa dhunë | |
| Trajnimi me nxënës për vetëdijesim nga minat , mjetet e pashpërthyera dhe përdorimin e mjeteve piroteknike | Evitimi i aksidenteve të ndryshme | Në vazhdimësi | Jetë më e sigurtë për qytetarë | Drejtoria për arsim Kulturë Rini dhe Sport, FSK-ja, Policia e Kosovës |
| Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave | Ambient i pastër | Së paku dy herë në vit | Ambient më të pastër | Drejtoria për Shërbime Publike kompania publike lokale Pastrimi |
| Luftimi i Ekstremizmit | Zvogëlim dhe parandalim i ekstremizmit të dhunshmëm | Në vazhdimësi | Siguri | |

**Republika e Kosovës / Republic of Kosova**
**Komuna -Municipality**
**Hani i Elezit**

---

**02/Nr.10256/2023**

| | |
|---|---|
| **DATA:** | 08.12.2023 |
| **PËR :** | Komitetin për Politik e Financa dhe Kuvendin e Komunës |
| **NGA:** | Kryetari i Komunës<br>z. Mehmet Ballazhi |
| **LËNDA:** | Shkresë Përcjellëse: Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024. |

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim Planin e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.

Me respekt

Republika e Kosovës / Republic of Kosova

Komuna - Municipality

Hani i Elezit

**01/Nr.9967/2022**

| | |
|---|---|
| **DATA:** | 11.12.2023 |
| **PËR:** | Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës |
| **NGA:** | Kryesuesi i Komitetit për Komunitete<br>Mefail Suma |
| **LËNDA:** | Shkresë përcjellëse:Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024. |

Me anë të kësaj shkrese ua përcjellim Planin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

Me respekt

**PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024**

Ky plan, kryesisht përpilohet dhe hartohet në bazë të LVL-s, Statutit të Komunës, Rregullores së Punës dhe akteve normative tjera.

| | |
|---|---|
| **JANAR** | |
| **1** | Njohuri me kompetencat e Komitetit për Komunitete |
| **2** | Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë. |
| **3** | Rastet Sociale në komunën e Hanit të Elezit. |
| **4** | Takim me Drejtorinë e  Mirëqenies Sociale. |
| **5** | Eventuale |
| **SHKURT** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Drejtorinë e Administratës. |
| **3** | Identifikimi i dhe parandalimi i dukurive  negativenë Komunën e Han të Elezit. |
| **4** | Eventuale |
| **MARS** | |
| **1** | Miratimi iprocesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomi . |
| **3** | Takim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari  dhe Zhvillimit Rural. |
| **4** | Eventuale |
| **PRILL** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Zyrtarin e Zyrës për barazi gjinore. (Lufta kundërdhunës) |
| **3** | Takim me Zyrtarin e Zyrës Kadastrale. |
| **4** | Takim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit. |
| **5** | Eventuale |

| | |
|---|---|
| **MAJ** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Zyrtarin e Zyrës për barazi gjinore. (Lufta kundër dhunës) |
| **3** | Takim me përfaqësuesit e BI  në Han të Elezit. |
| **4** | Eventuale |
| **QERSHOR** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Nënkryetarin e Komunës. |
| **3** | Takim me përfaqësuesin e HENDIKOS në Han të Elezit. |
| **4** | Eventuale |
| **KORRIK** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Zyrtarin e Zyrës së Prokurimit. |
| **3** | Takim me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër  dhe Mbrojte  të Mjedisit. |
| **4** | Eventuale |
| **GUSHT** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Zyrtarin e Zyrës për Informim dhe transparence. |
| **3** | Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë. |
| **4** | Eventuale |
| **SHTATOR** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Takim me Zyrtarin e Zyrës Ligjore. |
| **3** | Takim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa. |
| **4** | Eventuale |

| | |
|---|---|
| **TETOR** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Inspektor i Sanitarise |
| **3** | Takim me Zyrtarin e Zyrës për kthim. |
| **4** | Eventuale |
| **NENTOR** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Inspektor i Tregut |
| **3** | Inspektor i Komunikacionit |
| **4** | Eventuale |
| **DHJETOR** | |
| **1** | Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. |
| **2** | Hartimi i Planit të Punës të Komitetit për Komunitete,për viti 2024. |
| **3** | Eventuale |

Vërejte: Takimet të parapara në planin e punës do të mbahen në ditën dhe orën e caktuar në zyren e takimeve.

P.s.Në rast të mungesës së të ftuarëve,do të përsërite ftesa,për takim tjetër.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,

Mefail Suma.

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna Hani i Elezit**

**Opština Elez Han – Municipality of Hani i Elezit**

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

Dhjetor 2023

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 u përgatit nga Komuna Hani i Elezit, me mbështetjen e UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit "Gender Equality Facility" (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

**Grupi Punues:**

1. **Sevdi Dernjani -** Nënkryetar i Komunës;
2. **Florim Shkreta –** Kryesues i Kuvendit Komunal;
3. **Liridona Ballazhi –** Shefe e Kabinetit të Kryetarit;
4. **Lindita Ballazhi –** Drejtore për Buxhet dhe Financa;
5. **Majlinda Kaloshi –** Drejtore e Zhvillimit Ekonomik;
6. **Vjosa Rogaqi –** Zyrtare për Barazi Gjinore;
7. **Bajrush Laçi –** Udhëheqës i Zyrës Ligjore;
8. **Sevime Bajrami –** Zyrtare Kryesore Financiare;
9. **Avni Bushi –** Sekretar i Kuvendit Komunal;
10. **Sara Berisha –** Asistente e Kuvendit Komunal;
11. **Betime Dernjani –** Zyrtare e Burimeve Njerëzore.

**Ekspertiza teknike nga UN Women / GEF:**
Artan Binaku, Koordinator Projekti
Monika Kocaqi, Konsulente ndërkombëtare

© Komuna Hani i Elezit, 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Të nderuar qytetarë/e

Është kënaqësi për mua të jem në krye të një komune e cila harton Planin e Veprimit Lokal për Barazi Gjinore 2024 -2026 për Komunën e Hanit të Elezit.

Si Kryetar i Komunës Hani i Elezit, është detyra ime të siguroj se të gjithë qytetarët/et tanë/tona, pavarësisht gjinisë së tyre, gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi në jetën e tyre të përditshme. Barazia gjinore nuk është thjesht një aspiratë, por një nevojë e rëndësishme për të zhvilluar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Në këtë komunë, ne duhet të jemi të përkushtuar për të promovuar barazinë gjinore në të gjitha sferat e jetës, duke filluar nga puna dhe arsimi deri tek shëndetësia dhe pjesëmarrja në vendimmarrje. Ne duhet të sigurojmë se gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta në karrierë dhe zhvillim personal, duke e bërë kështu komunën tonë një vend ku fuqia e gjithë individëve është vlerësuar në mënyrë të barabartë.

Në vazhdimësi, duhet të luftojmë diskriminimin dhe stereotipet gjinore, duke krijuar një mjedis ku të gjithë janë të lirë të jetojnë dhe të punojnë pa ndonjë paragjykim për shkak të gjinisë së tyre. Duke e promovuar një kulturë të përfshirjes dhe respektit për të gjithë, ne mund të ndërtojmë një shoqëri që i jep vlerë kontributit të çdo individit, pa dallim gjinie.

Në fund, dua të theksoj se barazia gjinore është një detyrim për të gjithë ne, jo vetëm si qytetarë, por edhe si liderë dhe model për të tjerët. Ne duhet të punojmë së bashku për të ndërtuar një shoqëri ku gratë dhe burrat kanë të njëjtat mundësi për të arritur potencialet e tyre të plotë dhe për të kontribuar në zhvillimin e komunës sonë.

Nëse jemi të përkushtuar për këtë qëllim të madh, besoj se mund të krijojmë një komunë model për barazinë gjinore, duke treguar se respektimi i të drejtave dhe vlerave të të gjithëve është themelet e një shoqërie të fortë dhe të pajtueshme.

Faleminderit për vëmendjen tuaj dhe për përkushtimin tuaj drejt kësaj çështjeje të rëndësishme. Së bashku, ne jemi në gjendje të bëjmë ndryshime të mëdha për të gjithë komunitetin tonë.

Ju faleminderit!

# TABELA E PËRMBAJTJES


LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE ........ 5

I. HYRJE ........ 6

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE ........ 7

III. METODOLOGJIA ........ 10

IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE ........ 12

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2024 - 2026 ........ 15

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI ........ 18

VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026 ........ 19

## LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

| | |
|---|---|
| AZHRL | Agjensioni për Zhvillim Rajonal – Lindje |
| BDPfA | Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit |
| CEDAW | Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| DBF | Drejtoria për Buxhet dhe Financa |
| DBPZHR | Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| DKRS | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte |
| DSHMS | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| DUKMM | Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| DZHET | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit |
| EU GAP III | Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III |
| KKAKSHMS | Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| KKZHEPUMM | Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| KPF | Komiteti për Politikë dhe Financa |
| MASHTI | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit |
| MZHR | Ministria e Zhvillimit Rajonal |
| OJQ | Organizatë Jo-Qeveritare |
| ON | Organizatë Ndërkombëtare |
| PKBGJ | Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore |
| PLVBGJ | Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore |
| QKMF | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare |
| QPS | Qendra për Punë Sociale |
| SDG | Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm |
| ZBGJ | Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore |
| ZK | Zyra e Kryetarit |

# I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 u përgatit nga Komuna Hani i Elezit, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore. të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integrimit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin e Grave Asambleiste, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës Hani i Elezit, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit "Gender Equality Facility" (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

**Barazia gjinore** nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë afësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

**Drejtësia gjinore** nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).[1]

Siç përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale[2], njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave[3], të rejave dhe të rinjve[4], vajzave dhe djemve[5].Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale.

Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si njëçështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore,

[1]Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: https://eige.europa.eu/thesaurus/browse
[2]Tekstin e Kartws mund ta gjeni nw: https://charter-equality.eu/the-charter/lobservatoire-europeen-en.html
[3] "Gra dhe burra" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 35 vjeç, deri në fund tëjetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).
[4]"Të reja dhe të rinj" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 35 vjeç.
[5]"Vajza dhe djem" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifikë për zbatimine të cilave duhet tëpunojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë. Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi, Komuna Hani i Elezit, ka të emëruar një Zyrtare për Barazinë Gjinore e cila në mënyrë të përvitshme harton dhe zbaton një plan të veprimeve konkrete për përparimin drejt barazisë gjinore. Ky plan e ka gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga komuna dhe donatorë, përmes partneriteteve e bashkëpunimit.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e steriotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikat e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

PLVBGJ 2024-2026 është konceptuar dhe lidhur pikërisht me kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare, por mbështetet dhe merr frymëzim edhe nga dokumentet ndërkombëtarë të rëndësishëm, e synon të përafrohet me standardet dhe kërkësat e *acquis* të BE-së për barazinë gjinore. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan, janë hartuar duke pasur parasysh faktin që asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjithë antareve dhe antarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithëpërfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PLVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja **“në të gjithë diversitetin e tyre”.**[6]Përmes saj theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave (por edhe burrave, të rinjve e djemve) në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur, për shkak të seksit, moshës, zonës ku jetojnë, etnisë, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, të qenit prind i vetëm, të qenit viktimë / e mbijetuar / i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore, apo formave të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statusit të migrantes / migrantit, azilkërkueses / azilkërkuesit, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PLVBGJ 2024 – 2026, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit përkatës dhe dokumentat kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.

## II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikurse Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (njohur si CEDAW), Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, apo Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit), drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast

[6]Në kuadër edhe të përafrimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore me Planin e Veprimit të BE-së për Brarazinë Gjinore – EU GAP III.

konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

Program i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve[7].

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026 i Komunës Hani i Elezit, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore nëKosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. **Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:**
   - Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
   - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
   - Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
   - Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
   - Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
   - Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve,
   - Deklarata dhe Platforma për Veprimit e Pekinit,
   - Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje,
   - Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë,
   - Agjenda e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qendrueshëm, 2030,
   - Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025,
   - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

2. **Korniza ligjoredhe zhvillimore kombëtarepër barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:**
   - Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7, 21 dhe 22,
   - Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020,
   - Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26,
   - Ligji i Familjes Nr.2004/32,
   - Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.05/L-021,
   - Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154,
   - Ligji i Punës Nr. 03/L-212,
   - Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore Nr. 08/L-185,
   - Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 - 2024,
   - Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
   - Programi i Reformave Ekonomike,
   - Strategjia për Rregullim më të Mirë,
   - Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave,
   - Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,
   - Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PLVBGJ 2024 – 2026 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuar sipas fushave të tyre.

[7]Shih PKBGJ, fq. 11

Përgjegjëse kryesore për zbatimin e PLVBGJ mbetet Komuna. Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe aktorët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse komuna nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukturore që të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mundësi, duke përfshirë edhe OJQ, institucionet private, organizatat ndërkombëtare, etj. Zyrtarja për Barazi Gjinore (ZBGJ) do të mbetet përgjegjëse për një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara në PLVBGJ, por, tashmë ky është një plan i të gjithë komunës ndaj dhe përgjegjësia kryesore për këtë plan në tërësi jo domosdoshmërisht bie mbi ZBGJ. Gjithashtu, PLVBGJ 2024 – 2026, i zbërthyer vit pas viti, zëvendëson edhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore që ZBGJ përgatiste dhe paraqiste përpara Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë të përvitshme.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin lokal luan edhe Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste, i cili duhet të fuqizohet.

Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PLVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PLVBGJ.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është:

- një **mjet praktik i lokalizimit të dokumentave të rëndësishëm kombëtarë, por edhe ndërkombëtarë në lidhje me barazinë gjinore** (veçanërisht instrumentat drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).
- një **dokument ihartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës**, me hapa të mirëpërcaktuar, e **në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat** e ndeshura ndër vite nga Komuna, **në përparimin drejt barazisë gjinore**.
- një **pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësive të domosdoshme** për t’u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim **zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë**, në të gjithë diversitetin e tyre, në Komunën Hani i Elezit.

## III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PLVBGJ 2024-2026 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- ✓ **Ngritja e Grupit Punues për përgatitjen e këtij plani, me urdhër të Kryetarit të Komunës**. Grupi Punues për përgatitjen e këtij PLVBGJ u ngrit me Urdhër të Kryetarit **Nr.02/9204/2023**, e datës 26.10.2023 dhe kishtë në përbërje të tij 11 zyrtare / zyrtarë, konkretisht:
  - **Sevdi Dernjani** - Nënkryetar i Komunës;
  - **Florim Shkreta** – Kryesues i Kuvendit Komunal;
  - **Liridona Ballazhi** – Shefe e Kabinetit të Kryetarit;
  - **Lindita Ballazhi** – Drejtore për Buxhet dhe Financa;
  - **Majlinda Kaloshi** – Drejtore e Zhvillimit Ekonomik;
  - **Vjosa Rogaqi** – Zyrtare për Barazi Gjinore;
  - **Bajrush Laçi** – Udhëheqës i Zyrës Ligjore;
  - **Sevime Bajrami** – Zyrtare Kryesore Financiare;
  - **Avni Bushi** – Sekretar i Kuvendit Komunal;
  - **Sara Berisha** – Asistente e Kuvendit Komunal;
  - **Betime Dernjani** – Zyrtare e Burimeve Njerëzore.

- ✓ **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues**.Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentash ekzistues të komunës, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kornizës ligjore dhe të politikave ekzistuese kombëtare e lokale, të lidhura me çështjet gjinore.

- ✓ **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes**, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2024-2026.Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, si vlerësimi i arritjeve dhe sfidave të komunës për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, identifikimi i prioriteteve bazuar në analizën e cekur më sipër, marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimet me stafin e komunës, etj).

- ✓ **Konsultimet paraprake brenda komunës dhe hartimi i draft matricës së PLVBGJ**.Këto konsultime u zhvilluan me stafin e komunës si dhe në veçanti me anëtaret / anëtarët e Grupit Punues. Që prej fillimit të këtyre konsultimeve u prezatuan instrumente kryesore të rëndësishme ndërkombëtare, sidomos ato të BE-së të lidhura me barazinë gjinore (si për shembul Plani i Veprimit i BE-së për Barazinë Gjinore / EU GAP III, apo Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.). Po kështu u prezatuan edhe prioritetet e cekura në dokumente të rëndësishme kombëtare si Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 - 2024, Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III, 2021 – 2025, etj. Më pas u kalua në përgatitjen e draft matricës së PLVBGJ-së, e cila përmbante objektivat strategjikë, rezultatet e pritshme, dokumentet se ku referoheshin masat dhe veprimet e parashikuara, objektivat specifikë, treguesit në nivel objektivi, së bashku me vlerën bazë (e matur për vitin 2023 ose që do përcaktohet gjatë vitit 2024) dhe vlerën e synuar (target) deri në vitin 2026, rezultatin në nivel të objektivit specifik, si dhe aktivitetet, drejtorinë përgjegjëse për zbatim, partnerët dhe bashkëpunëtorët, afatin kohor, koston për tre vitet, burimin e financimit, treguesit për çdo aktivitet, si dhe përgjegjësit për monitorimin e zbatimit të PLVBGJ.

- ✓ **Postimi në faqen e Komunës për komente dhe sugjerime nga individët dhe grupet e interesit**. Draft matrica e PLVBGJ 2024 – 2026 u postua në datën 1 nëntor 2023 në linkun https://kk.rks-gov.net/haniielezit/category/konsultime-publike/postimi qëndroi i hapur për komente dhe sugjerime deri në datën 29 nëntor, duke plotësuar kështu detyrimin për konsultimin publik, në mbështetje të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03L-040 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

- ✓ **Mbajtja e konsultimit publik me banoret dhe banorët e Komunës**. Në përputhje dhe vijim të sa cekur më sipër, Komuna Hani i Elezit, mbajti edhe sesionin e dëgjimit publik në datën 29 nëntor 2023, në ora 14.00.

- ✓ **Përmirësimi i drat matricës së PLVBGJ.** Pas seancës së dëgjimit publik dhe në përfundim të të gjithë procesit të konsultimit publik, Grupi Punues bëri edhe përmirësimin e draft matricës së PLVBGJ, bazuar në të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra. Gjithashtu Grupi Punues e plotësoi këtë draft matricë edhe me përshkrimin narrativ të të gjithë PLVBGJ, pra e kompletoi tërësisht dokumentin e përgatitur.

- ✓ **Kostimi i matricës së PLVBGJ**. Procesi i kostimit të matricës së PLVBGJ ishte një proces tepër i rëndësishëm që gjithashtu mori kohën e tij përgjatë përgatitjes së dokumentit të plotë. Kostimi u krye për secilin nga aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së dhe fondet u ndanë sipas burimit të financimit, konkretisht fonde të mbuluara nga komuna, me burime ekzistuese njerëzore, infrastrukturore apo financiare, fonde të mbuluara nga donatorët, por edhe fonde për gjetjen e të cilave duhet të bëhen rishikime dhe planifikime në buxhetet përkatëse të viteve të ardhshme, ose duhet të lobohet për t'i siguruar përmes bashkëpunimit me donatorët, subjektet private e OJQ-të (pra hendeku financiar).

- ✓ **Dorëzimi i dokumentit të plotë, tëkostuar e përfunduar, për miratim në Kuvendin Komunal**. Pas përgatitjes dhe përfundimit të të gjithë procesit, dokumenti i plotë i PLVBGJ, edhe i kostuar, u dorëzua për miratim në Kuvendin Komunal, duke ndjekur të gjitha hapat, detyrimet dhe afatet ligjore përkatëse.

- ✓ **Miratimi i PLVBGJ në Kuvendin Komunal.** PLVBGJ u miratua në mbledhjen e rradhës së Kuvendit Komunal nëdhjetor 2023.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë jo vetëm me detyrimet kombëtare, por edhe me metodologjinë e përgatitjes së PLVBGJ-ve siç sugjerohet nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE)[8]. Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PLVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Women Kosovë, përmes një ekipi të mirëpërgatitur si dhe njëkonsulenteje[9] të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të Projektit "Gender Equality Facility" (GEF) qëfinancohet nga Bashkimi Evropian.

---

8 Për më shumë shikoni në: https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html

9 Znj. Monika Kocaqi, konsulente ndërkombëtare.

## IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

**Vizioni i PLVBGJ-së adreson:**

"Një qeverisje të mirë, gjithëpërfshirëse e të drejtë gjinore, ku gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Hanit të Elezit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantes/migrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës".

**Parimet**[10] që udhëheqin zbatimin e PLVBGJ, mbështeten kryesisht në parimet që udhëheqin në tërësi zbatimine Kartës Evropiane për Barazi tëGrave dhe Burrave nëJetën Lokale, siç paraqiten në vijim:

1. **Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore**. Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë; ajo përfshin gjithashtu edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, të drejtpërdrejta apo të tërthorta.

2. **Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.** Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore duhet të marrin parasysh dhe të trajtojnë – nga një këndvështrim gjithëpërfshirës, sistemik dhe strukturor – mënyrat se si ndërvepron gjinia me faktorë të tjerë si seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinionesh të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, origjina në lindje, aftësitë e kufizuara, mosha, ose orientimi seksual.

3. **Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike**. E drejta për barazi të grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, kërkon që organet vetëqeverisëse lokale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së balancuar në të gjitha sferat e vendimmarrjes.

4. **Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore**. Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të nxisin punën për eliminimin e stereotipeve dhe pengesave që krijojnë pabarazi në statusin dhe gjendjen e grave / të rejave / vajzave dhe që janë burimi i vlerësimit të pabarabartë të roleve të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve nga pikëpamja politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

5. **Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes lokale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore**.Perspektiva gjinore duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullsisë lokale – për shembull përmes përdorimit të teknikave të "vlerësimeve gjinore", "auditimit gjinor", "integrimit gjinor", dhe të "buxhetimit të përgjegjshëm gjinor". Për arritjen e këtij synimi duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e shumta dhe të gjera të grupeve të ndryshme të grave në jetën lokale, si edhe kushtet e jetesës dhe të punës së tyre.

---

10 Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

6. **Planete veprimit, të mbështetura meburimet e duhura, janë instrumente të nevojshmepër çuarjen përpara të barazisë gjinore**.Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të hartojnë plane dhe programe veprimi për barazinë gjinore, të mbështetura me burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

**Objektivat strategjikë të PLVBGJ.**

PLVBGJ 2024 – 2026 përbëhet nga katër objektiva strategjike, të cilat janë harmonizuar edhe me:

- Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore,
- Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024,
- Planin e Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën të Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025,
- Konventën për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit),
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPfA),
- Agjendën 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030,
- Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III),
- Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

**Katwr objektivat strategjike tw PLVBGJ 2024 – 2026 tw Komunws Hani i Elezit, renditen nw vijim:**

1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
4. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Secila nga këto objektiva strategjike është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ.

**Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit**

| |
|---|
| **Objektivi strategjik:**<br>**1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.** |
| **Rezultatet e pritshme:** |

1.a. Praktika lokale të përmirësuara që mundësojnë fuqizimin ekonomik dhe angazhimin në ndërmarrësi të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, nëpërmjet krijimit të lehtësirave fiskale dhe mbështetjes me mjete monetare.

1.b. Më shumë gra dhe të reja të pajisura me shkathtësi për të pasur qasje në tregun e punës, në përputhje me kërkesat e këtij të fundit, duke u fokusuar edhe në fushat deficitare.

**Objektivat specifikë:**

1.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.
1.2. Rritja e vetëdijësimit dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit, duke mundësuar ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve.
1.3. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.

**Treguesit në nivel objektivi:**

1.1.a. Numri i grave dhe të rejave të subvencionuara për të filluar apo për të zhvilluar bizneset dhe fermat/serat e tyre.

1.2.a. Numri i banoreve / banorëve të informuar për ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave/ të rejave / vajzave dhe burrave / të rinjve / djemve.

1.3.a. Përqindja e studenteve / studentëve që kanë përfituar subvencionime për të studiuar në drejtime deficitare/jodeficitare, përmes ndarjes së bursave komunale.

**Objektivi strategjik:**

**2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.**

**Rezultatet e pritshme:**

2.a. Qasja e grave, të rejave e vajzave në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore cilësore, si dhe të seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.

**Objektivat specifikë:**

2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.

**Treguesit në nivel objektivi:**

2.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë qasje në kujdesin dhe shërbimet cilësore shëndetësore, si dhe informacion mbi shëndetin seksual e riprodhues.

**Objektivi strategjik:**

**3.Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.**

**Rezultatet e pritshme:**

3.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e Komunës për përmbushjen e angazhimit publik zyrtar për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.

3.b. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar.

| |
|---|
| **Objektivat specifikë:**<br>3.1. Rritja e vetëdijesimit të grave, të rejave e vajzave mbi të drejtat e tyre dhe rëndësinë e ofrimittë mundësive të barabarta për pjesëmarrje dhe lidership, për të gjitha/gjithë banoret/banorët e Komunës.<br>3.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. |
| **Treguesit në nivel objektivi:**<br>3.1.a. Përqindja e banoreve/banorëve të Komunës të vetëdijësuar mbi rëndësinë e ofrimit të mundësive dhe angazhimit të barabartë për të gjitha/gjithë.<br>3.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore. |
| **Objektivi strategjik:**<br>**4. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.** |
| **Rezultatet e pritshme:**<br>4.a. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, me gjithë diversitetin e tyre, janë agjentë të ndryshimit në lidhje me normat shoqërore diskriminuese, stereotipet gjinore dhe nxitësit gjinor të konfliktit. |
| **Objektivat specifikë:**<br>4.1. Informimi dhe vetëdijesimi i grave, të rejave e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre mbi steriotipet gjinore dhe praktikat e dëmshme që ushqejnë dhunën me bazë gjinore. |
| **Treguesit në nivel objektivi:**<br>4.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave të informuara mbi steriotipet gjinore dhe praktikat e dëmshme që ushqejnë dhunën me bazë gjinore. |

## V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2024 - 2026

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ 2024 – 2026 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Komuna (si me burimet ekzistuese njerëzore, financiare e infrastrukturore, ashtu edhe me burime që duhet të shtojë), kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Komuna e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra zyrtareve / zyrtarëve, të cilat/cilët aktualisht marrin një pagë fikse, sallave/ambjenteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj., në këtë Plan Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PLVBGJ nuk merr jetë, Komuna

duhet të përfshijë në kornizën e parashikimeve buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në këtë PLVBGJ. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë Grupi i Jo Formal i Grave Asambleiste për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Komunës, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Lokal të Veprimit, ***duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara***, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo KAB-et e Komunës, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së KAB-eve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PLVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PLVBGJ 2024-2026 janë në vlerën **824,066 EUR**. Nga këto:

- ***742,464 EUR*** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
- **54,948** ***EUR*** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
- **10,635** ***EUR*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes 3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
- ***16,020 EUR*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes 4.Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Në totalin e kostos 824,066 EUR të nevojshme për zbatimin në tërësi të PLVBGJ 2024-2026 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tre vite):

- ***673,238 EURjanë kosto që do të mbulohen nga Komuna*** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj), pra ***të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukturore ekzistojnë.*****Këtu përfshihen edhe grante apo subvencionime të planifikuara për fusha të caktuara dhe për banoret dhe banorët në të gjithë diversitetin e tyre dhe vit pas citi do maten se sa kanë përfituar gratë, të rejat dhe vajzat në veçanti.**
- ***61,400 EUR janë kosto që mbulohen nga donatorë*** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PLVBGJ-së).
- ***14,429 EUR (ose 2% e totalit të buxhetit të tre viteve) janë hendek financiar,*** për të cilat komuna do të lobojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në KAB-et e ardhshme, duke filluar nga KAB 2024 - 2026.

| **Objektivat strategjikë** | **Objektivat specifikë** | **Gjithsej kosto për tre vjet** | **Komuna** | **Donatorë të konfirmuar** | **Hendek financiar** |
|---|---|---|---|---|---|
| **1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.** | 1.1.Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre. | 161,867 EUR | 99,147 EUR | 61,170 EUR | 1,550 EUR |
| | 1.2. Rritja e vetëdijësimit dhe përmirësimi i qasjes | 52,606 EUR | 51,010 EUR | 0 EUR | 1,596 EUR |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | në shërbimet e kujdesit, duke mundësuar ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve. | | | | |
| | 1.3. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre. | 527,991 EUR | 450,090EUR | 0 EUR | 2,901 EUR |
| **Gjithsej Objektivi strategjik 1:** | | **742,464 EUR** | **600,247 EUR** | **61,170 EUR** | **6,047 EUR** |
| **2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.** | 2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues. | 54,948 EUR | 50,,020 EUR | 0 EUR | 4,928 EUR |
| **Gjithsej Objektivi strategjik 2:** | | **54,948 EUR** | **50,,020 EUR** | **0 EUR** | **4,928 EUR** |
| **3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.** | 3.1. Rritja e vetëdijesimit të grave, të rejave e vajzave mbi të drejtat e tyre dhe rëndësinë e ofrimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrje dhe lidership, për të gjitha/gjithë banoret/banorët e Komunës. | 5,462 EUR | 4,640 EUR | 0 EUR | 822 EUR |
| | 3.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. | 5,173 EUR | 4,531 EUR | 230 EUR | 412 EUR |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej Objektivi strategjik 3:** | | **10,635 EUR** | **9,171 EUR** | **230 EUR** | **1,234 EUR** |
| **4. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.** | 4.1. Informimi dhe vetëdijesimi i grave, të rejave e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre mbi steriotipet gjinore dhe praktikat e dëmshme që ushqejnë dhunën me bazë gjinore. | 16,020 EUR | 13,800 EUR | 0 EUR | 2,220 EUR |
| **Gjithsej Objektivi strategjik 4:** | | **16,020 EUR** | **13,800 EUR** | **0 EUR** | **2,220 EUR** |

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit Lokal të Veprimit në vijim.

## VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

***Procesi i raportimit*** për aktvitetet e zbatuarado të kryhet nga Drejtoria përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit tek***Zyra e Kryetarit, Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale*** si dhe***Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.***Menjëherë pas miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, si hap i parë i zbatimit të tij, do të mblidhen të dhënat për vlerën bazë të treguesve në nivel të objektivave specifikë. Po kështu do tëhartohen edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifikë. ***Raportimet mbi akivitetet*** **do të jenë** ***periodike (çdo 3 muaj)*** ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit. ***Raportimet në bazë të objektivave specifikë*** do të përgatiten ***dy herë në vit (çdo 6 muaj).***

***Monitorimi*** i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit ***<u>në nivel të objektivave</u>*** do të kryhet nga ***Zyra e Kryetarit***, nga ***Komiteti për Politikë dhe Financa,*** nga***Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale*** si dhe ***Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.*** Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Grupi iJo Formmal i Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore.

Bazuar në monitorimin e kryer, PLVBGJ ***duhet të rishikohet dhe përmirësohet*** në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

## VII. MATRICA E PLANIT LOKALTË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

| | |
|---|---|
| **OBJEKTIVI STRATEGJIK:** | **1. PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE.** |
| **Rezultatet e pritshme:** | 1.a. Praktika lokale të përmirësuara që mundësojnë fuqizimin ekonomik dhe angazhimin në ndërmarrësi të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, nëpërmjet krijimit të lehtësirave fiskale dhe mbështetjes me mjete monetare.<br>1.b. Më shumë gra dhe të reja të pajisura me shkathtësi për të pasur qasje në tregun e punës, në përputhje me kërkesat e këtij të fundit, duke u fokusuar edhe në fushat deficitare. |
| **Dokumentet kryesore që u referohemi:** | - Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12, 15, 16, 17 dhe 18.<br>- Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivat specifike 1.1 dhe 1.2.<br>- Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 3, objektivat specifikë 2, 3, 4, 5 dhe 6.<br>- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) – nenet 2, 3, 4, 5, 11, 13 dhe 14.<br>- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6.<br>- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 1, 2 dhe 6<br>- Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, targets 5.1, 5.4 dhe 5.a, treguesit, 5.1.1, 5.4.1 dhe 5.a.1, SDG 8, targets 8.5 dhe 8.6, treguesit 8.5.2 dhe 8.6.1.<br>- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 3.<br>- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 10, 11, 15, 18, 27, 31, 34 dhe 35. |
| ***Objektivi specifik:*** | ***1.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.*** |

| **Treguesi** | **Vlera bazë (2023/2024)** | **Synimi i vitit të fundit (2026)** | **Rezultati** |
|---|---|---|---|
| 1.1.a. Numri i grave dhe të rejave të subvencionuara për të filluar apo për të zhvilluar bizneset dhe fermat/serat e tyre. | Do përcaktohet | Rritur me 30% | Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në ndërmarrësi. |

| **AKTIVITETET** | **ZBATIMI** | | **AFATI KOHOR** | **KOSTO (EUR)** | | | **BURIMI I FINANCIMIT** | **TREGUESIT** | **MONITORIMI** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Drejtoria / zyra** | **Drejtoritë / institucionet** | | **2024** | **2025** | **2026** | | | |

| | përgjegjëse | mbështetëse | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.1.Takime informuese me këshillat e fshatrave mbi subvencionimet me mjete monetare të bizneseve dhe ndërmarrësive, me synim nxitjen e aplikimit të grave dhe të rejave. | DZHET | DBF<br>DBPZHR<br>ZBGJ<br>DKRS | 2024<br>-<br>2026 | 280 €<br>*(nga të cilat 110 € komuna dhe 170 € hendek financiar)* | 280 €<br>*(nga të cilat 110 € komuna dhe 170 € hendek financiar)* | 280 €<br>*(nga të cilat 110 € komuna dhe 170 € hendek financiar)* | DZHET | - 3 takime të zhvilluara (1 çdo vit).<br>- 28 persona të pranishëm në çdo takim, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etj. | KPF<br>KKAKSHMS<br>KKZHEPUMM |
| 1.1.2. Subvencionimi me mjete monetare, i bizneseve në pronësi të grave/të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre. | Zyra e Kryetarit<br>DZHET | DBF<br>DBPZHR<br>ZBGJ | 2024<br>–<br>2026 | 4,000 € | 4,000 € | 4,000 € | ZK<br>DZHET | - 6 biznese të grave / të rejave të subvencionuara (2 në vit) | KPF<br>KKAKSHMS<br>KKZHEPUMM |
| 1.1.3. Lirimi nga taksat komunale i bizneseve të regjistruara në pronësi të grave/të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre. | DZHET | DBF<br>DBPZHR | 2024<br>–<br>2026 | 500 € | 500 € | 500 € | DZHET | - 21 biznese të grave të liruara nga taksat komunale (7 çdo vit) | KPF<br>KKAKSHMS<br>KKZHEPUMM |
| 22 | Avdulla Berisha | grurë | 0.81 ha | 200.00 | 200.00 |
| 23 | Servet Berisha | grurë | 0.90 ha | 200.00 | 200.00 |
| 24 | Sherif berisha | grurë | 0.94 ha | 200.00 | 200.00 |
| 25 | Ariana dernjani | grurë | 0.86 ha | 200.00 | 200.00 |
| 26 | Shemsedin Lusnjani | grurë | 0.74 ha | 200.00 | 200.00 |
| 27 | Arif thaçi | grurë | 0.69 ha | 200.00 | 200.00 |
| | | | | | |
| Tot. | 27 | | | | 5,400.00 € |

***Pagesa për aplikuesit e subvencioneve komunale për grurë për vitin 2023 është 5,400.00€***

Data:11/12/2023

Drejtori i DBPZHR-së
Abduraman Bushi

**Republika e Kosovës / Republic of Kosova**
**Komuna - Municipality**
**Hani i Elezit**

---

**03/Nr.10563/2023**

| | |
|---|---|
| **DATA:** | 20.12.2023 |
| **PËR:** | Kuvendin e Komunës |
| **CC:** | z.Mehmet Ballazhi- Kryetar i Komunës |
| **NGA:** | Natyra Kalisi – Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme |
| **LËNDA:** | Shkresë Përcjellëse për raportimin e Planit të Integritetit |

Të nderuar,

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, ju përcjellim raportimi në Kuvendin Komunal mbi implementimin e planit të integritetit.

Me respekt,

Duke marrë parasysh që plani i integritetit është dokument strategjik që mbështet rezultatet e arritura gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut të integritetit dhe hapave të ndërmarra në Komunën e Hanit të Elezit, komuna e Hanit të Elezit gjatë periudhës kohore nga miratimi i këtij Plani nga Kuvendi Komunal me numër 01/6387/2022 me datë 30.08.2022 ka arritur të përmbush disa nga objektivat për këtë plan.

***Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:***

1. Drejtimi dhe menaxhimi
2. Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve
3. Planifikimi dhe menaxhimi financiar
4. Komunikimi dhe Informimi

***Në fushën e drejtimit dhe menaxhimit*** janë ndërmarr masa në realizimin e raporteve javore dhe mujore të zyrtarëve komunal si dhe drejtrive përkatëse, janë mbajtur punëtori për hartimin e kodit të etikës etë ndryshme.
***Në fushen e politikës së burimeve njërëzore***, procedurat e rekrutimit janë plotësisht transparente, shpallja e procedurave të rekrutimit bëhet përmes ëeb faqes së komunës. Sistemit informativetë menaxhimit të burimeve njerëzore dhe tabelës digjitale të shpalljeve, gjithashtu verifikimi paraprak i dokumentacioneve bëhet nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe kandidatët pjesmarrës në procedurë rekrutimi njoftohen brenda afateve ligjore sipas Ligji nr 08/L-197 për zyrtarët publik 197 duke përfshirë edhe verifikimi i kandidatit fitues në fazën e emërtimit
Ndërsa sa i përkët përshkrimit të punës, nëpunësit aktual kanë përshkrimin e punës për pozitën që mban, ndërsa për nëpunësit e rinjë aplikohet rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil dhe orari i punës menaxhohet nga  Sistemi për Menaxhimin e Vijueshmërisë në Punë ku përcillet rregullisht nga mbikqyrësit e drejtëpërdrejt dhe monitorohet nga NJBNJ dhe Udhëheqësi mëi lartë administrative  shikohet orari i punës sa respektohet.
Keqpërdorimi i udhëtimeve zyrtare: në raste të trajnimeve respektohet rregullorja që 24orë para udhëtimit të bëhët kërëkesa për automjet.
***Në planifikimit dhe menaxhimin financiar*** kemi bërë ndryshimin e rregullores së taksave dhe tarifave për menaxhimi i të ardhurave.
Planifikimi i buxheti kemi mbajtur 11 dëgjime buxhetore lidhur me KAB-in si dhe për hartimin e Projekt Buxhetit 2024-2026 me grupe të margjinalizuara, me Ekzekutivin dhe Asamblenë Komunale, me biznese,shoqata dhe ojq si qytetarët e vendbanimeve të ndryshme zona rurale dhe urbane, ku kemi marrë parasysh çdo kërkesë dhe nevojë të akterëve të lartëpërmendur në hartimin e Projekt Buxhetit si dhe kemi planifikuar projekte të cilat përmbushin objektivat dhe strategjitë Komunale,
Mungesa e koordinimit ndërmjet njësive të ndryshme në planifikimin e buxhetit e kemi reduktuar maksimalisht, pasi që gjatë planifikimit të Projekt Buxhetit kanë qenë të përfshime të gjitha Departamentet Komunale, sektori i Arsimit dhe sektori i Shëndetësisë, si dhe qytetarët.
Shpenzimet buxhetore realizohen bazë të shpërndarjes së mjeteve në baza mujore, pra, në bazë të Planit të Cash-it, i realizojmë edhe shpenzimet tona.
Procesi i regjistrimit të aseteve jo financiare është jo efikase, janë ndërmarrë hapa për të  dërguar zyrtarët në trajnime vazhdimisht rreth regjistrimit të aseteve, pra, është bërë rritja e kapaciteteve tek zyrtarët, me ç'rast është përmirësuar edhe regjistrimi, mirëmbajtja e aseteve.

Kapacitetipamjaftueshëmi inventarit funksional është bërë procesi i inventarizimit dhe janë përgatitur raporte për ZKA-në.
*Ne aspektin e komunikimit dhe informimit* nuk janë ndërmarrë masa.

***Ndërsafushatspecifike të rrezikut janë:***

1. *Prokurimi publik*
2. *Administrata Komunale*
3. *Konflikti i interesit*
4. *Deklarimi i pasurive*
5. *Kabineti i Kryetarit*
6. *Licencimi i shërbimeve publike dhe objekteve*
7. *Inspektimi*
8. *Urbanizmi dhe planifikimi*
9. *Edukimi dhe kultura;*
10. *Shëndetësia dhe mirëqenia sociale &*
11. *Bujqësia dhe zhvillimi rural*

*Në aspektin e prokurimit publik* nuk janë ndërmarrë masa.

*Administrata komunale* në këtë aspekt ka rritur menaxhimin përmes menaxherëve të kontratave për shërbimet logjstike të cilët kanë mundur të bëjnë lëshime në blerje dhe shërbimet logjistike për komunë si dhe përmes funksionalizimit të sistemit të e-pasurisë tashmë adresimi i kërkesave logjistike është filluar të menaxhohet pjesërisht.
Tek kontratat ku furnizuesit kanë dështuar për performim të kontratës janë ndërprerë përmës shkresave të përbashkëta me ankesa dhe masa të tjerat të cilat ne i kemi si dëshmi ndaj operatorëve ekonomik, kemi rastin me operatorin ekonomik të fotokopjes me qira.
Raportimi i kontratave bëhet përmes platformës elektronike të eprokurimit ku zyrtarët i mbushin ato sipas vendimeve për menaxher të kontratave.
Shpenzimet të cilat lidhen me blerjen e karburantit është pikë e përmbushur për mos tejkalim dhe kontroll të shpenzimeve ku janë vendosur pajisjet e GPS-ve nëpër makina zyrtare.
*Në fushën e konfliktit të interesit* është miratuar plani për integritet për mbrorjtjen nga konflikti i interesit, në kuadër të planeve të trajnimeve kanë marrë pjesë zyrtarë për konfliktin e interesit gjatë këtij viti, në momentin që zyrtari ka konflikt interesi me shkresë zyrtare dhe arsyetim ata kërkojnë largim nga komisioni ku duhet të mirret vendimi.
*Në fushën e deklarimi i pasurive* ka deklaruar pasurinë sipas rregulllave dhe dispozitave ligjore në këtë drejtim dhe janë ndërmarrë masa.
*Në fushën e kabinetit të kryetarit* janë ndërmarrë masa në vendosjen e kutisë së ankesave ku të gjithë kanë mundësitë të shprehin ankesat dhe pakënaqësitë, ndërsa takimet dhe koordinimi i zingjirit komunikimit me qytetarë bëhet në mënyrë të organizuar që çdo qytetarë të ketë komunikim me kryetarin apo stafin e kabiniteti të tij, ndërsa sa i përket mekanizmit të ankesave ekziston zyrtari ligjor që mirret me përgjigjjen e ankesave dhe mbajtjen e tyre si lënd sipas ligjit në fuqi.
*Në fushën e licensimi i shërbimeve publike dhe objekteve* tek fusha e menaxhimit dhe realizimit të projekteve kapitale është i realizuar pasi që të gjitha projektet në këtë drejtori janë implementuar sipas planit të punës. Për rritjen e menaxhimit në menaxhim të mbeturinave është

ristrukturuar rregullorja e re si për menaxhimin e mbeturinaveve me të gjitha detajet përkatëse. Ndërsa mungesa e stafit është reduktuar pak për shkak se gjatë këtij viti është bërë një rekrutim i ri në shërbimet publike.
*Në fushën e inspektimit* nuk janë ndërmarrë masa.
*Në fushën e urbanizmi dhe planifikimi* është në proces pune Plani i zhvillimit, poastu çështjet e ndërgjegjësimit janë publikuar në faqen e komunës për legalizim të shtëpive të banimit etj.
*Në fushën e edukimi dhe kulturës* janë riparuar dhe restauruar infrastruktura shkollore në përputhje me nevojat dhe kërkesat, poashtu në fushën e punonjësve teknik ato janë të angazhuar në mirëmbajtjen e ndërtesave shkollore, ekziston një bashkëpunim i madh me OJQ-të, partnerët e biznesit dhe të tjerë në bashkëpunim për ndihmesë në fushën e edukimit dhe kulturës. Rekrutimi është efikas dhe punohet në këtë drejtim që nxënësit të kenë mësimdhënës në orët mësimore.
*Në fushën e shëndetësisë* për infeksione jepen udhëzime të posaçshme nga mjekt, ndërsa në stafin profesional kemi ngritje të stafit si bashkëpunim i komunës me organizata joqeveritare Caritas dhe Islamic Relief Kosova, buxheti është menaxhuar dhe është rritur në varësi të kërkesave tona .përveq kontratave të veçanta që kemi zhvillu përmes prokurimit per stafë të përkohshëm, në planifikimin e barnave bëhet përmes procedurave tenderuese të prokurimit publikdhe kemi edhe barna të cilat i sjell ministria përkatëse.
*Në fushën e bujqësisë dhe zhvillimi rural* ndarja e subvencioneve është bërë në bazë të ligjit për ndarjen e subvencioneve në mënyrë transparente dhe korrekte. Për inspektorët në bujqësi nuk e kemi këtë si pozitë, për kampanjat vetëdijësuese kemi shpërndar informata në tabelën digjitale për mbrojtjen e tokës, kultivimin e tokës se të ngjajshme

Realizimi i këtij plani është në fazën implementuese pasi që edhe kemi diskutuar që të bëjmë përpjekje në realizimin e objektivave që dalin nga ky plan i integritetit dhe informatat të cilat gjenden këto janënë bazë të raporteve të përjellura prej deparatamenteve përkatëse në secilën fushë të rrezikshmërisë.



# STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

## 2024-2028

## HANI I ELEZIT

# STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK 2024 - 2028

# HANI I ELEZIT

Ky dokument është përgatitur nga Komuna e Hanit të Elezit, respektivisht nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Komunës së Hanit të Elezit.

Hani i Elezit, 2023

## Fjala e Kryetarit të Komunës

Të nderuar bashkëvendas,
Strategjia për Zhvillim Ekonomik 2024-2028 është një nga dokumentet kyçe që posedon institucioni komunal, përmes së cilit identifikohet potenciali zhvillimor ekonomik që posedon Komuna e Hanit të Elezit.

Në kohët e tashme, është e rëndësishme të kemi një vizion të qartë për të ardhmen ekonomike të komunës sonë. Një strategji e mirëplanifikuar dhe e mirëhartuar do të na ndihmojë të identifikojmë sfidat, të përcaktojmë objektivat dhe të zhvillojmë veprime të qëndrueshme për të forcuar zhvillimin ekonomik.

Qëllimi i kësaj strategjie është të krijojmë një mjedis të favorshëm për investime, inovacion dhe rritje të qëndrueshme. Nëpërmjet studimeve të hollësishme dhe konsultimeve të përgjegjshme me përfaqësuesit e drejtorive komunale, zyreve dhe njësive komunale, shoqërisë civile, komiteteve konsultative komunale dhe bashkëpunëtorët nga agjencionet zhvillimore, kemi identifikuar disa sektorë kyç për ta fokusuar përkushtimin tonë.

Në këtë strategji, fokusohemi në përmirësimin e infrastrukturës së transportit, krijimin e një ambienti të favorshëm biznesor, mbështetjen e sektorit të turizmit dhe ndërtimit të kapaciteteve të komunitetit lokal. Ne i shikojmë këta sektorë si motorë të zhvillimit ekonomik të komunës sonë dhe do të ndërmarrim hapa konkretë për të stimuluar rritjen dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Kam besim të plotë në potencialin e Komunës së Hani i Elezit dhe në aftësitë e banorëve tanë për të krijuar një të ardhme të ndritur. Së bashku, do të ndërtojmë bazën e një ekonomie të qëndrueshme dhe të forcojmë pozicionin tonë në nivel vendi dhe rajoni.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe mbështetjen tuaj në këtë dokument. Së bashku, mund të bëjmë ndryshime reale dhe të krijojmë një qytet vendqëndrues dhe jo vetëm si vendkalues.

Ju faleminderit!"

# Përmbajtja

**Grupi Punues** .......... 5
**Indeksi i shkurtesave** .......... 6
**Indeksi i tabelave** .......... 7
**Indeksi i figurave** .......... 8
**Grafiku** .......... 8
**Hyrja** .......... 9
**1. Metodologjia** .......... 10
**2. Historiku** .......... 13
**2.1. Pozita gjeografike** .......... 14
**2.2. Kushtet klimatike dhe relievi** .......... 15
**2.3. Popullsia dhe vendbanimet** .......... 16
**3. Zhvillimi ekonomik** .......... 21
**3. Zhvillimi ekonomik** .......... 21
**3.1. Sektori privat** .......... 21
**3.2. Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit.** .......... 22
**3.3. Regjistrimi i pronarëve të bizneseve sipas gjinisë.** .......... 22
**3.4. Regjistrimi bizneseve 2019-2022** .......... 23
**3.5. Industria** .......... 24
**3.6. Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia** .......... 25
**3.7. Burimet kryesore të jetesës** .......... 26
**4. Bujqësia** .......... 28
**4.1. Toka bujqësore** .......... 28
**4.2. Prodhimet buqësore** .......... 29
**4.3. Blegtoria** .......... 30
**4.4. Pyjet** .......... 30
**5. Arsimi** .......... 32
**6. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale** .......... 36
**6.1. Sektori privat** .......... **Error! Bookmark not defined.**
**7. Hapësirat Publike** .......... 38
**7.1. Parku i Qytezës** .......... 38
**7.2. Koridoret e gjelbëra** .......... 38
**7.3. Menaxhimi i mbeturinave** .......... 38
**7.4. Hapësirat e gjelbërta** .......... 39

**7.5. Degradimi i mjedisit** ........ 40
**7.6. Ndotja e ujit** ........ 40
**7.7. Ndotja e tokës** ........ 41
**7.8. Ndotja akustike** ........ 41
**8. Infrastruktura** ........ 43
**8.1. Transporti** ........ 44
**8.2. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre** ........ 45
**8.3. Mbulimi me shërbimin e kanalizimit** ........ 48
**9.1. Kultura** ........ 51
**9. Kultura dhe Sporti** ........ 51
**9.2. Sporti** ........ 51
**9.3. Turizmi** ........ 51
**10. Buxhet** ........ 53
**10.1. Të hyrat komunale** ........ 54
**10.2. Shpenzimet Buxhetore** ........ 54
**Analiza SWOT** ........ 56
**Vizioni dhe Misioni** ........ 57
**Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2027** ........ 57
**Objektivat e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik** ........ 58

## Grupi Punues

Majlinda Kaloshi - Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, Udhëheqëse e grupit
Sevdi Dernjani - Nënkryetar i komunës
Kimete Kuka - Drejtoreshë për Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale
Hisni Luri - Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Nexhmedin Daci - Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
Lindita Ballazhi - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
Natyra Kalisi - Drejtoreshë për Administratë
Arsim Dernjani - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
Abduraman Bushi - Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Durim Dernjani - Menaxher i Projekteve
Bajrush Laçi - Shef i zyrës ligjore dhe përfaqësues juridik
AZHR Lindje - Agjencion Rajonal për Zhvillim

Teuta Hasallari - Përfaqësuese e KVRL-së
Amir Qajani - Konsulent i jashtëm
Florim Shkreta – Anëtar i Asamblesë Komunale
Resul Suma - Anëtar i Asamblesë Komunale
Sherif Berisha - Anëtar i Asamblesë Komunale
Hyrijete Isufi - Anëtare e Asamblesë Komunale
Ibadete Kuka – Anëtare e Asamblesë Komunale
Zaim Bela - Anëtar i Asamblesë Komunale
Nora Xhoni – Anëtare e Asamblesë Komunale
Refet Kalisi - Anëtar i Asamblesë Komunale

**Kontribues të tjerë:**
Fatbardha Bushi – Inspektore për Mjedis
Bujar Bushi – Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve
Amir Berisha – Inspektor i Komunikacionit
Rezart Memedi – OSCE

## Indeksi i shkurtesave

| | |
|---|---|
| AMF | Ambulancës së Mjekësisë Familjare |
| APK | Agjencia e Pyjeve të Kosovës |
| ARRU | Autoriteti Rregullativ për Ujësjellës |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| EAMS | Sistemin e Menaxhimit të Aseteve të Ndërmarrjes |
| DAKRS | Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport |
| DZHE | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik |
| DSHMS | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| DSHPE | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë |
| DUKMM | Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit |
| FAO | Organizata Botërore e Ushqimit |
| KKEE | Fondi Kosovar *për Efiçiencë të Energjisë* |
| GIZ | Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur |
| GZK | Gazeta Zyrtare e Kosovës |
| IHMK | Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës |
| IKMN | Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës |
| IKSHPK | Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës |
| IMMK | Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës |
| IPA | Instrumenti i Para Anëtarësimit |
| JICA | Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë |
| KINP | Kontrolli i Integruar për Parandalimin e Ndotjes |
| KVRL | Këshilli Rinor për Veprim Lokal |

| | |
|---|---|
| KINP | Kontrolli i Integruar për Parandalimin e Ndotjes |
| KVRL | Këshilli Rinor për Veprim Lokal |
| KRU | Kompania Regjionale e Ujësjellësit |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| MFK | Fondacioni Kosovar i Mileniumit |
| NPL | Ndërmarrja Publike Lokale |
| KIPM | Kontrollin e Integruar për Parandalimin e Ndotjes |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| OJQ | Organizata Joqeveritare |
| PKVEE | Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë për Komunën e Hanit të Elezit 2019-2021 |
| PLVM | Plani Lokal i Veprimit në Mjedis |
| PNJK | Pilot Njësi Komunale |
| PRU | Plani Rregullues Urban i Komunës së Hanit të Elezit |
| PZHK | Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Hanit të Elezit 2010-2025+ |
| QKMF | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare |
| QPS | Qendra për Punë Sociale |
| SHFMU | Shkolla fillore e mesme e ulët |
| SHML | Shkolla e mesme e lart |

## Indeksi i tabelave


**Tabela 1:** Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Hanit të Elezit
**Tabela 2:** Popullsia dhe, ekonomitë familjare sipas lokaliteve të Hanit të Elezit
**Tabela 3:** Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit.
**Tabela 4:** Regjistrimi i pronarve të bizneseve sipas gjinisë
**Tabela 5:** Regjistrimi bizneseve 2019-2022
**Tabela 6**: Punësimi
**Tabela 7:** Numri i të punësuarve dhe të papunëve nga popullsia e aftë për punë
**Tabela 8:** Burimet kryesore të jetesës
**Tabela 9:** Sipërfaqja e tokës bujqësore
**Tabela 10:** Sipërfaqja e kultivuar bujqësore
**Tabela 11:** Numri i krerëve të kafshëve blegtorale
**Tabela 12** Niveli i arsimimit në Han të Elezit dhe Kosovë
**Tabela 13:** Stafi shëndetësor në Han të Elezit i ndarë sipas shërbimeve të ofruara
**Tabela 14:** Infrastruktura në komunën e Hanit të Elezit
**Tabela 15:** Infrastruktura transportuese rrugore dhe hekurudhore në territorin e komunës së Hanit të Elezit
**Tabela 16:** Shërbimi i ujësjellësit sipas vendbanimeve
**Tabela 17:** Mbulushmëria me shërbimin e ujësjellësit
**Tabela 18:** Shërbimi i kanalizimit sipas vendbanimeve
**Tabela 19:** Mbulushmëria me shërbimin e kanalizimit

**Tabela 20:** Numri i klientëve të shërbyer dhe gjatësia e rutës së shërbimit për vendbanime
**Tabela 21:** Emetimet në ajër nga Sharrcem (2018-2020)
**Tabela 22:** Përqendrimet vjetore dhe tejkalimet e standardeve kosovare për ndotës të caktuar (2018-2022)
**Tabela 23:** Të hyrat vetanake
**Tabela 24:** Transferat qeveritare
**Tabela 25:** Shpenzimet komunale

## Indeksi i figurave

**Figura 1:** Metodologjia e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomike
**Figura 2**: Pozita gjeografike e komunës së Hani të Elezit
**Figura 3:** Harta relievore e Komunës së Hanit të Elezit
**Figura 4:** Harta e qyteti dhe fshatrave të Komunës së Hanit të Elezit
**Figura 5 :** Harta e objekteve shkollore dhe shëndetësore të Komunës së Hanit të Elezit
**Figura 6:** Harta infraskturore urbane e territorit të komunës së Hanit të Elezit
**Figura 7:** Harta e rrugëve dhe transportit publik
**Figura 8**: Skema e Procesit të prodhimit dhe ndikimit në mjedis të Sharrcemit

## Grafiku

**Grafiku 1**: Struktura etnike në Komunën e Hani të Elezit
**Grafiku 2:** Popullsia në komunën e Hanit të Elezit, 1948-2011
**Grafiku 3:** Struktura gjinore në komunën e Hani të Elezit
**Grafiku 4**: Shpërndarja e moshave në komunën e Hani të Elezit
**Grafiku 5:** Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit
**Grafiku 6:** Regjistrimi i pronarëve të bizneseve sipas gjinisë
**Grafiku 7:** Regjistrimi bizneseve 2019-2022
**Grafiku 8:** Numri i stafit në institucionet publike parauniversitare, 2018-2022
**Grafiku 9:** Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2018-2022
**Grafiku 10:** Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitet 2021-2025

# Hyrja

Zhvillimi i qëndrueshëm urban i një vendi, me rini që janë të orientuar nga inovacioni dhe teknologjia, promovimi i potencialeve dhe resurseve natyrore pa ndikuar negativisht në ambient, përkrahje të bizneseve dhe industrisë në tërësi e përbëjnë procesin zhvillim ekonomik të një vendi, me qëllim të gjenerimit të vendeve të reja të punës.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal është një dokument që prezanton përcaktimin e synimeve, qëllimet strategjike, sfidave që përballet vendi, objektivat e së ardhmes, buxhetin dhe proceset e vlerësimit të projekteve, duke zhvilluar një vizion afatgjatë të Komunës së Hanit të Elezit. Ajo ka rëndësinë e një materiali largpamës dhe vizionar duke tentuar drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm ndërmjet shfrytëzimit të potencialeve poseduese.

Përmes këtij dokumenti strategjik Komuna e Hanit të Elezit paraqet një planifikim gjithëpërfshirës për një orientim drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm duke prekur të gjithë sektorët që do të ndikojnë për një periudhe kohore, 2024-2028. Vizioni për pesë vitet e ardhshme e projekton Hanin e Elezit si një qytet relativisht të ri por njëkohësisht mjaftë të zhvilluar duke rigjeneruar zonat urbane, zhvillim të balancuar, arsim cilësor, kushte shumë të mira shëndetësore, infrastrukturë të përmirësuar teknike duke siguruar një mirëqenie për të gjithë.

Institucioni duhet të strukturojë dhe menaxhojë administratën e saj, buxhetin dhe proceset e planifikimit për t'i dhënë përparësi nevojave themelore të komunitetit dhe të promovojnë zhvillimin social dhe ekonomik të saj.

# 1. Metodologjia

Me rekomandim të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik pranë Komunës së Hanit të Elezit, Kryetari i Komunës ka themeluar grupin punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik në të cilin janë përfshirë të gjitha grupet e interesit. Në këtë strukturë kanë qenë pjesëmarrës drejtoritë komunale, zyrtar komunal, organizata joqeveritare, agjenci zhvillimore, përfaqësues të bizneseve, konsulentë të jashtëm dhe pjesë të shoqërisë civile.

Për hartimin e këtij dokumenti, udhëheqësi i grupit, ka përgatitur planin e hartimit të tij e që ka përfshirë këto faza:




**Figura. 2** Metodologjia e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomike

Gjatë hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomike të komunës së Hanit të Elezit janë mbajtur takime të rregullta pune me përfaqësuesit e komunës së Hanit të Elezit, përfaqësues të shoqërisë civile, bizneset lokale etj.. Si rrjedhojë janë identifikuar akterët kryesorë dhe përfaqësuesit e tyre janë përfshirë në ekipin e punës. Tutje është bërë planifikimi i procesit të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik. Pastaj janë mbledhur të dhënat mbi veçoritë gjeografike dhe demografike, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, tregun e punës, industrinë, shërbimet administrative të komunës, infrastrukturën, furnizimin me ujë të pijshëm, mbeturinat, ndotjen, kulturën, sportin dhe ekonominë lokale të komunës së Hanit të Elezit.

Strategjia për Zhvillimit Ekonomik mbështetet me projekte për arritjen e objektivave zhvillimore të cilat reflektojnë interesat e qytetarëve, komunitetit të biznesit dhe akterëve tjerë në komunën e Hani të Elezit, për të krijuar dhe ofruar kushte cilësore të jetesës për qytetarët e kësaj komune. Ky dokument strategjik bazohet në politikat strategjike për zhvillim ekonomik lokal si:

| Dokumenti | Qëllimi dhe fushëveprimi |
|---|---|
| **Statuti i Komunës së Hanit të Elezit** | Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake te organeve komunale. |
| **Profili Ekonomik i Komunës 2022/2023** | Dokument Informativ mbi Komunën |
| **Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Hanit të Elezit 2010-2025+** | Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Hanit të Elezit, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike. |
| **Plani Rregullues Urban i Komunës së Hanit të Elezit** | Qëllimi i këtij plani është që të organizojë ndërtimet në pjesën urbane të qytetit që është edhe pjesa identifikuese e komunës së Hanit të Elezit. |
| **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012-2017** | Dokument lokal që është zbatuar gjatë periudhës 2012-2017 me synim që të zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura. |
| **Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Komuna e Hanit të Elezit 2016-2021** | Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave të Hanit të Elezit është dokument planifikimi që rregullon Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal. Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës. |
| **Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë për Komunën e Hanit të Elezit (PKVEE) 2019-2021** | Objektivi i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Hanit të Elezit. |
| **Strategjia e Zhvillimit Rajonal për Rajonin Ekonomik Lindje** | Ky dokument ka paraqitur Zhvillimin Rajonal Lindje të Kosovës, objektivat në zhvillim socio-ekonomik të komunave ne lindje të Kosovës |

**Tabela 1 :** Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Hanit të Elezit



# Të dhënat Gjeografike dhe Demografike

# 2. Historiku

Komuna ka gjithsej 11 zona kadastrale, dy prej të cilave kanë qenë të shpopulluara që nga viti 1999. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i popullsisë së vitit 2011, Komuna e Hanit të Elezit ka 9.403 banorë. Që nga themelimi i fabrikës së çimentos në vitin 1936, numri i popullsisë në Han të Elezit është rritur vazhdimisht.

Territori i sotëm i komunës, dikur ishte i njohur me emrin Sar, dhe ka qenë i banuar që prej kohës së Romakëve. Këtë e vërtetojnë zbulimet e materialeve të ndryshme arkeologjike, siç është mbishkrimi në gjuhë latine i një perandori romak. Zbulimet e materialeve të vjetra në afërsi të rrugëve që e lidhnin dikur rajonin me Scupi-n (Shkupin e sotëm), mbështesin idenë se në këtë rajon ka ekzistuar një vendbanimi Ilir. Kjo argumentohet me gjetjen e materialeve arkeologjike të kalasë (castela). Gjetje janë bërë edhe në shumë fshatra të kësaj komune siç janë rrënojat e kishës dhe manastirit të gjetura në Gorancë pastaj, në Paldenicë janë gjetur mbeturinat e një nekropoli, qeramika të vjetra, materiale bronzi, një stelë nga një varrezë e shekullit të tretë pas Krishtit dhe dy monedha. Në fshatin Dërmjak është gjetur një statujë romake dhe ekzistojnë edhe shumë materiale të tjerat të lashta, të cilat janë gjetur në fshatrat tjera.

Edhe pse Hani i Elezit dhe rrethinat e saj kanë pasur statusin e një komune që nga viti 1913, një ndarje e re administrative e miratuar në vitin 1961, ka themeluar komuna më të mëdha dhe ka shkrirë territorin e Hanit të Elezit në komunën e Kaçanikut. Hani i Elezit është themeluar si Pilot Njësi Komunale (PNJK) si rezultat i procesit të decentralizimit në shtator të vitit 2005, në bazë të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2005/11 për krijimin e Pilot Njësive Komunale. Më 13 gusht të vitit 2008 ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me shkresë njoftuese nr. 02-527 njoftoi se, komuna e Hanit të Elezit është certifikuar në të njëjtin nivel të kompetencave dhe përgjegjësive me komunat tjera në Republikën e Kosovës.
Komuna e Hanit të Elezit është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e cila brenda territorit të saj ushtron pushtetin dhe përgjegjësitë, të cilat nuk janë rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.
Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës që zbatohet brenda kufijve të Komunës së Hanit të Elezit. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ, i cili miraton Rregullore dhe vendime të rëndësishme për Komunën.
Komuna është person juridik me të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie publike, për të ushtruar padi dhe për të qenë e paditur në gjykata, për të lidhë kontrata, për të punësuar stafin si dhe për aktivitete tjera në përmbushjen e përgjegjësive ligjore.

## 2.1. Pozita gjeografike

Në pjesën jug-lindore të Kosovës shtrihet Hani i Elezit, qytet në afërsi të pikës kufitare të Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, pjesë territoriale që përfshinë një sipërfaqe prej 83 km².
E rrethuar nga kufijtë natyror që përbëhen nga malet e bukura të Sharrit dhe Karadakut të Shkupit, qyteti i Hanit të Elezit shtrihet në fushëgropën që e ndanë lugina e lumit Lepenc.
Kufijtë administrativ përfshijnë Komunën e Kaçanikut dhe pjesën e Maqedonisë së Veriut, si shtet fqinj, ndërsa rrethohet nga 11 vendbanimet që ka.
Vendbanimi i qytezës së Hanit të Elezit ka një pozitë gjeografike shumë të përshtatshme pasiqë është nyje kryesore për qarkullimin e rrugëve Prishtinë-Shkup, duke përfshirë magjistralen dhe autostradën "Arbën Xhaferi". Nga kjo pozitë e favorshme ka rezultuar me industri shumë të zhvilluar dhe të njohur jo vetëm për Kosovën por edhe për vendet jashtë saj. Transporti i mallrave kryhet përmes pikës së njohur kufitare në Han të Elezit, pikë kyqe për rajonin duke rezultuar me tregti dhe transport mjaftë të zhvilluar.
Rruga Magjistrale Prishtinë-Shkup rreth 12 km e gjatë në territorin e Hanit të Elezit, kalon përmes Grykës së Kaçanikut, lidh Hanin e Elezit dhe më tej deri në Maqedoninë e Veriut.
Autostrada "Arbën Xhaferi" është infrastruktura tejet mirë e zhvilluar që ndërlidhë Hanin e Elezit me qendrat më të mëdha të Kosovës, si kryeqytetin Prishtinën, Ferizaj dhe Kaçanikun përmes së cilave arrihet edhe në qytetet tjera të mëdha. Kjo rrugë është e rëndësisë së madhe pasi qarkullimi i saj është relativisht i lartë duke ndikuar kështu në ekonominë e Hanit të Elezit.
Rruga që lidh dy pikat kufitare (Hani i Elezit dhe Glloboçicë) gjithashtu kalon përmes këtij territori. Rruga është 13 km e gjatë dhe e asfaltuar pjesë e cila kalon nëpër malet e Sharrit. Rruga përmes Hanit të Elezit ndjek pjesën perëndimore të territorit, duke kaluar nëpër fshatin Gorancë dhe arrin në Glloboçicë si një pikë kufitare alternative.



**Figura 3**: Pozita gjeografike e komunës së Hani të Elezit

## 2.2. Kushtet klimatike dhe relievi

Klima e Hanit të Elezit është tipike kontinentale, me dimra të ashpëra dhe temperatura minimale që sillen nga -10 gradë Celsius deri në 5 gradë Celsius, dhe vera të nxehta me temperatura maksimale që arrijnë deri në 40 gradë Celsius. Muaji më i nxehtë është korriku, ndërsa muaji me ftohtë është janari.

Në klimën e komunës ka një ndikim të fuqishëm nga lugina e Vardarit (klima e butë me ndikim të fortë gjatë dimrit që pasohet nga sasi të vogla të reshurave të borës) dhe Gryka e Kaçanikut (klimë tipike kontinentale me ndikim të fuqishëm gjatë verës).

Zona është e karakterizuar nga reshje të dobëta, me një mesatare 476ml/m2/vit. Reshjet janë të dobëta gjatë verës dhe janë të forta në dhjetor dhe janar. Lagështia mesatare është rreth 65% (minimumi 51% dhe maksimumi 87%). Drejtimi kryesor i erës është veri - jug. Aktualisht nuk ka ndonjë stacion lokal klimatik në territorin e Komunës.

Pjesa më e madhe e territorit të Komunës së Hanit të Elezit shtrihet në lartësi mbidetare 500-700 metra, dhe përfshinë territorin e vendbanimeve Gorancë, Seçishtë, Rezhancë, Pustenik, Paldenicë dhe Dimcë. Një pjesë e konsiderueshme e territorit të komunës shtrihet ndërmjet lartësisë mbidetare 700-1000 metra, duke përfshirë hapësirat e vendbanimeve Krivenik, Dromjak dhe Neçevcë.




**Figura 4:** Harta relievore e Komunës së Hanit të Elezit

## 2.3.Popullsia dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të vitit 2011, Hani i Elezit 9403 banorë, kryesisht e përbërë nga shqiptarët (99.5%) dhe boshnjakët (0.44%).




**Grafiku 1**: Struktura etnike në Komunën e Hani të Elezit

Zona urbane e Hanit të Elezit, paraqet lokalitetin me numrin më të madh të popullsisë (3.749 banorë), ndërsa që zonat më të mëdha rurale sa i përket numrit të banorëve dhe që kanë mbi 1 mijë banorë janë Paldenica dhe Seçishta. Rreth 1 mijë banorë ka edhe Goranca, ndërsa që lokalitetet me numrin më të vogël të banorëve janë Dermjaku dhe Neçavci. Dendësia e popullsisë është 121 banorë/km$^2$. Në tabelën në vijim është prezantuar numri i popullsisë për secilin vendbanim dhe sipërfaqja e vendbanimeve janë paraqitur edhe në hartën më poshtë. Gjithashtu edhe në grafikun janë paraqitur regjistrimi i popullsisë prej vitit 1941 deri në vitin 2011 ku shohim një ngritje të vazhdueshme të numrit te popullsisë.

Sipas vlerësimit të fundit të popullsisë të realizuar nga Agjencia e Statistikave për vitin 2021, komuna e Hanit të Elezit ka 10111 banorë.

| Lokaliteti | Popullata | Nr. i ekonomive familjare |
|---|---:|---:|
| Hani i Elezit | 3.749 | 578 |
| Paldenicë | 1.750 | 270 |
| Seçishtë | 1.002 | 154 |
| Gorancë | 957 | 147 |
| Rezhancë | 749 | 115 |
| Pustenik | 612 | 94 |
| Krivenik | 306 | 47 |
| Dimcë | 215 | 33 |

| | | |
|---|---:|---:|
| Dermjak | 49 | 7 |
| Neçavc | 4 | 1 |
| **Gjithsejt** | **9.403** | **1446** |

**Tabela 2 .** Popullsia dhe, ekonomitë familjare sipas lokaliteve të Hanit të Elezit




**Figura 5:** Harta e qyteti dhe fshatrave të Komunës së Hanit të Elezit




**Grafiku 2:** Popullsia në komunën e Hanit të Elezit, 1948-201

**Mosha dhe struktura gjinore**: Komuna e Hanit të Elezit ka një popullsi të re. Sipas këtyre të dhënave mbi 60% e popullsisë është popullsi aktive.
Struktura gjinore ka disa dallime: 51% janë meshkuj 49% janë femra.




**Grafiku 3:** Struktura gjinore në komunën e Hani të Elezit

Shpërndarja e moshave në Hanin e Elezit është si në vijim, rreth 29% e popullsisë është 0-14 vjeç, 10% janë 15-19, 9% janë të moshës 20-24, 8% të moshës 25-29, 8% janë të moshës 30-34, 7% janë 35-39, 7% janë 40-44, 6% janë 45-49, 5% janë 50-54, 3% janë 55-59, 3% janë 60-64 dhe vetëm rreth 5% janë të moshës mbi 65 vjeç. Me poshtë i kemi paraqitur edhe me anë të grafikut




**Grafiku 4**: Shpërndarja e moshave në komunën e Hani të Elezit

Në Han të Elezit ka 1446 ekonomi familjare, rreth 11% ekonomive familjare kanë më shumë se 10 anëtarë të familjes, ndërsa rreth 22% prej tyre kanë 5 anëtarë për një familje. Madhësia mesatare e ekonomive familjare është 6.5 anëtarë. Migrimi i popullsisë është një nga sfidat e që ka ndikim në çështjet demografike, kulturore, ekonomike dhe politike. Sipas të dhënave në Han të Elezit ka një tendencë të migrimit nga zonat rurale ne zonën urbane. Gjithashtu ekziston një tendencë e migrimit jashtë vendit. Vlerësohet se rreth 12% e popullsisë së Hanit të Elezit, ka emigruar jashtë vendit dhe jashtë Kosovës[1].

[1] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

# Profili Ekonomik

# 3. Zhvillimi Ekonomik

Peizazhi dhe organizimi hapësinor i qytezës së Hanit të Elezit lë të nënkuptojë se industria e materialeve ndërtimore ende mbetet aktiviteti kryesor ekonomik në vend. Në këtë industri dominon prodhimi i çimentos si veprimtari e vetme në Kosovë e ndjekur nga prodhimi i rërës/ zhavorrit (3 prodhues) dhe stiroporit në masa më të vogla. Kjo industri ka tërhequr me vete edhe transportin e materialeve ndërtimore si një veprimtari mjaft e zhvilluar me mbi 100 kamionë në pronësi të kompanive të ndryshme lokale.

Duke marrë parasysh lidhjen e lehtë dhe shumë të mirë me arteriet kyçe nacionale rrugore, bizneset shërbyese hoteliere deri vonë kishin gjithashtu një zhvillim solid posaçërisht përgjatë rrugës nacionale duke sjellë të hyra shtesë nga jashtë Komunës. Mirëpo, ndërtimi i autoudhës i ka kufizuar këto të hyra dhe tashmë shërbimet hoteliere jepen kryesisht për banorët lokal.

Edhe pse me tokë bujqësore kualitative të kufizuar, në numër i madh i banorëve të komunës janë marrë tradicionalisht me bujqësi. Si kultura më të mëdha kemi kryesisht: misrin që kultivohet në luginën Lepenc, grurin në rrafshnaltën e Krivenikut dhe livadhet si aktivitet përcjellës i zhvillimit blegtoral në Bjeshkët e Sharrit dhe Karadakut. Përtej kësaj banorët vazhdojnë edhe më tej të kultivojnë fruta/ perime në kopshtet e tyre (në raste edhe me serra) si dhe fruta mali në sasi të kufizuara kur ato janë subvencionuar.

Turizmi malor paraqet degën e re ekonomike që sapo ka filluar të zhvillohet në pjesën e Pustenikut, Neçavcit dhe ndonjë hapësire tjetër.

Edhe përkundër asaj që u përmend më lart, Komuna e Hanit të Elezit vlerësohet të ketë zhvillim të ulët ekonomik. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme. Potenciali për procesim të materialeve ndërtimore si zhavorr dhe çimento në elemente ndërtimore montazhe apo gjysmë montazhe mbetet për tu analizuar. Potenciali turistik (natyra/ kultura në bashkëpunim me shërbimet hotelierike) mund të zhvillohet edhe më tej ku si ndihmesë mund të jetë edhe prodhimi i përmirësuar bujqësor lokal.

## 3.1. Sektori privat

Në komunë janë të regjistruara gjithsej 357 biznese. Sektorët ekonomik dominues janë kryesisht tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet shërbyese dhe ato transportuese. Tregtia përfshinë 20% të ndërmarrjeve, aktivitetet shërbyese 16%, transporti 18%, ndërtimtaria 6%, ndërsa sektorët tjerë përfshinë pjesën tjetër prej 40%. Përkundër potencialeve në vend për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet fare pak i përfaqësuar me një përqindje tepër të ulët. 93% e bizneseve janë të përqendruara në qytezë dhe përgjatë rrugës nacionale N2.

Sikur në tërë Kosovën, informaliteti ekonomik është shumë i lartë. Ai është shumë i theksuar në formën e bizneseve të paregjistruara ndërtimore, shërbime profesionale të ofruara nëpër amvisëri, prodhimtari bujqësore etj. Informaliteti gjithashtu shprehet edhe te bizneset e regjistruara kur një pjesë e aktivitetit të tyre nuk regjistrohet fare.

Të gjitha ndërmarrjet janë private me përjashtim të Kompanisë për Menaxhim të Mbeturinave “Pastrimi” dhe Kompanisë Regjionale për Ujësjellës/ Kanalizim “Bifurkacioni” – Njësia në Han të Elezit, të cilat janë publike. Dominimi i sektorit privat është një tregues se ka nevojë për përkrahje të mëtejme të tyre, duke i pasur parasysh edhe potencialet lokale.

Sa i përket tregut, përveç drithërave që për momentin e kanë atë më të organizuar, prodhimet tjera vendase kanë vështirësi që të plasohen në treg dhe të shiten. Tregu i këtyre prodhimeve në Kosovë nuk është i rregulluar. Në Han të Elezit nuk ekziston tregu i qytetit, por wshtw nw planet e Drejtorisw pwr Zhvillim Ekonomik.

Prodhimet e mjedrës janë ulur ndjeshëm për shkak të tregut jo të organizuar dhe çmimit të ulët, përderisa pemët dhe perimet e ndryshme plasohen në tregun më të gjerë kosovar me shumë vështirësi.

Gjithsesi janë bërë hapat e parë për standardizimin e produkteve bujqësore si dhe trajnime dhe mbështetje permanente të bujqëve për kultivim sa më mirë dhe efikas të kulturave të lartpërmendura. Trajnime dhe mbështetje ka pasur edhe për aktivitete biznesore të natyrave tjera. Këto aktivitete pritet të intensifikohen në vitet në vijim.

## 3.2. Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit.

| | | |
|---|---|---|
| Biznesi Individuale (B.I.) | 223 | 62.47% |
| Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.) | 133 | 37.25% |
| Shoqëritë Aksionare (SH.A.) | 1 | 0.28% |

**Tabela 3:** Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit.




**Grafiku 5:** Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit

## 3.3. Regjistrimi i pronarëve të bizneseve sipas gjinisë.

Më poshtë me anë të tabelës dhe grafikut kemi paraqitur regjistrimin e pronarëve të bizneseve sipas gjinisë në komunën e Hanit të Elezit.

| | | |
|---|---|---|
| Meshkuj | 290 | 81.23% |
| Femra | 67 | 18.77% |

**Tabela 4:** Regjistrimi i pronarëve të bizneseve sipas gjinisë




**Grafiku 6:** Regjistrimi i pronarëve të bizneseve sipas gjinisë

## 3.4. Regjistrimi bizneseve 2019-2022

Regjistrimi i bizneseve të reja dhe bizneseve të shuara për vitet 2019-2022 janë paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

| Regjistrimi bizneseve 2019-2022 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
| Aktive | 38 | 46 | 30 | 40 |
| Të shuara | 5 | 3 | 3 | 2 |

**Tabela 5:** Regjistrimi bizneseve 2019-2022




**Grafiku 7:** Regjistrimi bizneseve 2019-2022

### 3.5. Industria

Si një zhvillim që i ka dhënë karakterin qytezës dhe në të njëjtën kohë ishte edhe shkaktar i evoluimit dhe zhvillimit të saj, industria është dega më e zhvilluar ekonomike në Han të Elezit. Bazuar në burimin natyror nëntokësor mergele si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, i cili më vonë (gjatë viteve 70 dhe 80) u hulumtua në sasinë e 13.438.260 ton në Han të Elezit (e verifikuar) dhe 25.985.030 ton në Paldenicë (e pa verifikuar); kapacitetet prodhuese fillestare të çimentos (sot quhet fabrika për prodhimin e çimentos "Sharrcem") u ndërtuan që në vitin 1936 duke u shtuar më vonë në vazhdimësi në vitet e 70-ta dhe 80-ta. Nga viti 2000 deri 2010 fabrika ishte e komercializuar nga firma zvicerane Holcim, kurse nga 2010 ajo është privatizuar nga firma greke Titan Group. Gjatë këtyre viteve janë bërë edhe hapa substancial në përmirësimin dhe digjitalizimin e linjave prodhuese, përmirësime në rritjen e efiçiencës, automatizim të punëve, menaxhim më të mirë të shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, reduktimet e ndotjes, etj.

Prodhimi i çimentos ka variuar nëpër vite. Gjatë sistemit të mëparshëm kishte arritur kulmin e prodhimtarisë më 1982 me 550.000 ton në vit. Pas montimit të teknologjisë më të avancuar, më 2009 u arrit sasia e rreth 600.000 tonëve në vit. Që nga atëherë e deri më 2014, prodhimtaria ka arritur çdo herë mbi 500.000 tonë në vit. Në vitin 2j015 prodhimtaria vjetore arriti në 630.000 ton[2]. Me këtë sasi të prodhuar, nevojat e Kosovës mbulohen në sasinë nën 50%. Përqindja tjetër importohet kryesisht nga Maqedonia por edhe Shqipëria dhe Serbia.

Që nga viti 2002 e në disa raste edhe më parë, Sharrcem ka shfrytëzuar rreth 500.000 ton mergele në vit në mihjen sipërfaqësore në Han të Elezit duke arritur totalin e mbi 10.000.000 tonëve deri në fund të 2021. Kjo sasi duhet analizuar në kontekstin e sasisë totale të mergeles së verifikuar në zonat e lartpërmendura. Bazuar në këtë si dhe vrojtimeve në terren, mund të thuhet se rezervat e mergeles në Dimcë janë shpenzuar në sasi relativisht të mirë që qon në përfundim se duhet shtuar masat në shfrytëzim sa më racional të kësaj lënde të parë.

Përveç qëllimit kryesor të prodhimtarisë, Sharrcem ka ndërmarrë edhe hapa për rrjetëzimin e tij si dhe për mbështetje të komuniteti në Han të Elezit. Në vitin 2011, Sharrcem ishte iniciues në themelimin e Rrjetit për Përgjegjësi Shoqërore të Korporatave (CSR). Gjithashtu është themelues dhe financuesi kryesor i Laboratorit për Aktivitete të Biznesit (LAB), i themeluar më 2014 me qëllim që të kontribuojë në edukimin dhe mbështetjen financiare të iniciativave që do të mundësonin alternativa të vetë-punësimit dhe gjenerimit të të hyrave për qytetarët e Hanit të Elezit. Në kuadër të Lab-it dhe nismave tjera për komunitetin si dhe për përfitime sociale, Sharrcemi ka investuar në vlerë mbi 450.000 euro deri në vitin 2021.

Guri gëlqeror, si burim tjetër industrial, shfrytëzohet relativisht mirë në Han të Elezit. Janë gjithsej 3 gurëthyes dhe dy nga ata operojnë për nevoja të Sharrcem.

Fabrika "Kosovaplast" për prodhimin e stiroporit gjithashtu është privatizuar dhe shndërruar në biznes të ngushtë familjar me numër minimal të punëtorëve dhe me aktivitet të limituar. Gjithashtu ekziston një fabrikë e betonit dhe disa biznese prodhuese tjera të vogla.

[2] Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Po ashtu vitin 2020 ka filluar punën impianti për pasurimin e mineralit të kromit në fshatin Gorancë (Zheden). Është ky një investim Zviceran dhe parashihet punësimi i 50 punëtorëve të profileve të ndryshme. I tërë prodhimi është i paraparë për eksport.
Resurse tjera natyrore të pashfrytëzuara në Han të Elezit janë edhe argjila e vërtetuar me mbi 26 milion ton, guri dekorativ, kromi, hekuri dhe uji mineral[3].

### 3.6. Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia

Shkalla e lartë e papunësisë është një nga çështjet më sfiduese në Kosovë, duke qenë një nga sfidat kryesore edhe për Komunën e Hanit të Elezit. Për ta treguar nivelin e punësimit, në Kosovë merret në shqyrtim popullsia e aftë për punë, përkatësisht grup mosha 15-64 vjeç. Fillimisht bëhet ndarja e popullsisë aktive në dy kategori: popullsia aktive dhe joaktive. Popullsia aktive (fuqia punëtore) përfshinë personat që punojnë dhe ata që në mënyrë aktive kërkojnë punë. Popullsia joaktive përfshinë personat që nuk punojnë dhe që nuk janë duke kërkuar punë (studentët, amviset, pensionistët dhe ata që nuk janë në gjendje për të punuar).
Sipas vlerësimeve aktuale nga sondazhi në terren dhe të dhënave nga ndërmarrjet në HiE[4], përqindja e papunësisë është 67%. Ka një numër të vogël të punësuarve në sektorin jo formal ekonomik. Megjithatë, nuk ka të dhëna të sakta pasi që të punësuarit në bizneset jo formale nuk janë të regjistruar. Sipas statistikave, popullsia e moshës aktive për punë përbënë rreth 65% të numrit total të popullsisë, të dhëna këto që vërtetojnë për një potencial për zhvillim duke u bazuar në fuqinë punëtore që ka Hani i Elezit.

Më poshtë me anë të tabelës kemi paraqitur të dhënat për punësim si llojit të vendit të punës dhe në tabelën tjetër kemi paraqitur popullsinë e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual në komunën e Hanit të Elezit:

| Punsimi | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Vendi fiks i punës | 970 | 130 | 1100 |
| Punon kryesisht në/nga shtëpia | 9 | 1 | 10 |
| Nuk ka vend fiks të punës | 54 | 1 | 55 |
| Nuk janë në dispozicion | 4 | 0 | 4 |
| Gjithsej | 1037 | 132 | 1169 |

**Tabela 6**: Punësimi

| | Ekonomikisht aktive | Të punësuar | Të papunësuar, ka punuar më pare | Të papunësuar, nuk kanë punuar kurrë më pare | Të papunësuar, presin të fillojnë punën në të cilën janë pranuar | Ekonomikisht jo aktiv |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Meshkuj | 2142 | 1037 | 443 | 654 | 8 | 1238 |
| Femra | 353 | 132 | 19 | 198 | 4 | 2892 |
| Gjithsej | 2,495 | 1169 | 462 | 852 | 12 | 4,130 |

**Tabela 7:** Numri i të punësuarve dhe të papunëve nga popullsia e aftë për punë

[4] Zyra e Punësimi komuna Hani I Elezit

## 3.7. Burimet kryesore të jetesës

Duke u bazuar në burimet e të hyrave në komunën e Hanit të Elezit, shihet se përqindja e të hyrave nga punësimi është shumë i ulët. Po ashtu, niveli i mbështetjes përmes pensioneve dhe skemave sociale është shumë i ulët. Banorët e komunës janë kryesisht të varur nga të hyrat që vijnë nga persona të tjerë dhe nga remitancat.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2011, vetëm 14.5% e banorëve mbështeten në të hyrat nga punësimi. Të ardhurat nga skema e pensioneve, ndihmës sociale dhe nga fondet e tjera ndihmëse (papunësia) janë 11.1%/. Mbështetja kryesore financiare vjen nga personat e tjerë nga të cilat varen 64.7% e banorëve, 3.2% nga remitancat dhe 6.8% nga burime të tjera. Shikuar përgjithësisht, niveli i varfërisë në komunë mbetet i lartë.

| | | Puna (përfshirë punën në prona, biznesit privat ose të biznesit familjar | Pasuritë e patundshme, I nvestimet, (qira, interesi) | Pensione | Ndihma sociale | Transferet tjera (përfitimet nga papunësia, sëmundjet, pushimi i lehonisë, bursave) | Remitencat (Të ardhurat nga të afërmit nga jashtë vendit) | Mbështetje nga njerëzit e tjerë | Burimet e tjera | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Hani i Elezit | Nr. | 1365 | 36 | 560 | 484 | 27 | 303 | 6087 | 541 | 9403 |
| | % | 14.5 | 0.4 | 6.0 | 5.8 | 0.3 | 3.2 | 64.7 | 5.8 | 100 |
| Kosova | Nr. | 390281 | 6330 | 112020 | 84683 | 7102 | 92317 | 922464 | 124628 | 1739825 |
| | % | 22.4 | 0.4 | 6.4 | 5.2 | 0.4 | 5.3 | 53 | 7.2 | 100 |

**Tabela 8:** Burimet kryesore të jetesës

Sipas regjistrimit të vitit 2011 numri i popullsisë së aftë për punë (15-65 vjeç) në Komunën e Hanit të Elezit ishte 6101. Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, numri i të punësuarve në ndërmarrjet (publike/ private) dhe administratën lokale/ qendrore brenda Komunës së Hanit të Elezit është 1024, që përfshinë vetëm rreth 17% të popullsisë së aftë për punë (15-64 vjeç). Nga ky numër, 272 janë të punësuar në administratë dhe ndërmarrje publike, ndërsa tjerët në sektorin privat (752). Nëse krahasohet numri i të punësuarve me numrin e ndërmarrjeve private, madhësia mesatare e ndërmarrjes del të jetë 3.13 punëtorë, që është vlerë e ulët.

Megjithatë, për shkak të jo-formalitetit është e vështirë të përcaktohet qartë numri total i të punësuarve dhe rrjedhimisht përqindja e papunësisë. Agjencia e Statistikave e Kosovës[5] në vlerësimet e tyre 3 mujore vlerëson se gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, në nivel të Kosovës, shkalla e papunësisë është 25.8%. Papunësia më e theksuar është te femrat me 29.7%, krahasuar me meshkujt, 24.2%. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grup moshat 15-24 vjeçare me 48.6%.

[5] Agjencia e Statistikave të Kosovës

# Bujqësia



# 4. Bujqësia

Bujqësia me rol mesatar në zhvillimin e gjithëmbarshëm të Hanit të Elezit sipas regjistrimit të fundit të ekonomive familjare (2011) kishte vetëm 26 të punësuar që përbënë vetëm rreth 2.5% të totalit të punësuarve. Numri i ndërmarrjeve bujqësore është tejet i ulët. Siç u përmend më lartë, numri total i ndërmarrjeve të regjistruara bujqësore përbën vetëm 4% të ndërmarrjeve në komunë, që tregon përgjithësisht për kapacitete të vogla të ndërmarrjeve dhe strukturim kryesisht familjar.

Toka bujqësore e kategorizuar sipas kualitetit i takon ekskluzivisht kategorive 5-8, përveç ndonjë sipërfaqe rreth lumit Lepenc e cila tashmë është ndërtuar veçanërisht në Lagjen e Re.

Aktiviteti kryesisht zhvillohet në formë të bujqësisë familjare për krijimin e të ardhurave shtesë në familje, me parcela të vogla private bujqësore dhe me mekanizëm bujqësor të munguar apo vjetëruar (amortizuar) me përjashtim të rasteve të pakta kur mekanizmi është subvencionuar. Sipërfaqet e tokës bujqësore përgjatë Lumit Lepenc (kulturat bujqësore - lavërtare të mbjella kryesisht me misër) ujiten përmes kanaleve të hapura të ujitjes të ndërtuara si kanale klasike dheu. Serrat e perimeve, frutat e pyllit si dhe disa pemishte, të subvencionuara këto nga entitete të ndryshme, kanë sistemet enkas të ndërtuara për ujitje pikë-pikë. Perimet në hapësirat e jashtme dhe shumica e pemishteve ujiten duke shfrytëzuar burimet private, lumenjtë/përrojet si dhe ujin nga ujësjellësi. Nuk ka ndonjë sistem të mirëfilltë të ujitjes sepse shumica e këtyre sipërfaqeve bujqësore janë të shpërndara nëpër të gjithë territorin e komunës.
Viteve të fundit ka filluar përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit nga qeveria qendrore/ lokale, LAB-i (i treguar më lart), IKC-ja, Caritas Luxembourg, Caritas Kosova, Fondacioni Kosovë-Luxembourg gjithnjë në bashkëpunim me komunitetin. Në të shumtën e rasteve, subvencionimi ka përfshirë 90% të lëndës (serra së bashku me sistemin e ujitjes, farërat dhe plehrat/ushqimin e duhur apo shtalla së bashku numrin e kafshëve shtëpiake). Në disa raste janë subvencionuar edhe mekanizmat bujqësore si motokultivatorët dhe mekanizmat bujqësor përcjellës. Megjithatë nevojat për përkrahje janë ende më të mëdha se mundësitë buxhetore.

## 4.1. Toka bujqësore

Sipas të dhënave nga Sektori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, bazuar sipas regjistrit të vitit 1958, sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore është si në vijim:

| **Sipërfaqja e tokës bujqësore (ha)** | | |
|---|---|---|
| Tokë pjellore | Tokë lavërtarë | 1.177,30 |
| | Livadhe | 230,16 |
| | Kullosa | 1.693,26 |
| | Gjithsej | 3.100,72 |
| Tokë jo pjellore | | 519,40 |
| Gjithsej | | 3,620.12 |

**Tabela 9:** Sipërfaqja e tokës bujqësore

Nga zhvillimet në terren dhe të dhënat komunale është më se e qartë së toka lavërtare është duke u shfrytëzuar kualitativisht vetëm rreth 13%. Pjesa tjetër e sipërfaqes është duke u shndërruar dita-ditës në tokë ndërtimore (posaçërisht Lagja e Re), lënë djerrë apo duke iu ndërruar destinimi në favor të livadheve/ kullosave.

## 4.2. Prodhimet buqësore

Sa i përket tokës lavërtare, tradicionalisht në territorin e Hanit të Elezit (në të shumtën në rrafshnaltën e Krivenikut) është mbjellë gruri. Kulturat tjera që mbillet tradicionalisht janë misri, elbi, tërshëra dhe patatja të cilat janë në sasi më të vogla. Mesatarja e prodhimit të drithërave sillet nga 3.5 t/ha deri  në 4.5 t/ha te gruri dhe nga 5t/ha  deri në 6.5 t/ha te misri. Edhe kultivimi i perimeve ka marrë hov viteve të fundit. Janë ndërtuar serra për kultivim ekstensiv të domates, specit, trangullit, pjeprit por edhe perimeve barishtore. Këto kultura mbillen edhe në hapësira të jashtme.

Në vazhdën e këtij hovi përfshihet edhe kultivimi i frutave të pyllit si dredhëza dhe mjedra. Në kuadër të pemëtarisë është prezantuar edhe rrushi i tryezës. Vazhdojnë të kultivohen edhe arrat, mollët, kumbullat, dardhat dhe frutat e tjera. Kultivimi i foragjereve përfshinë barin klasik (sanë) dhe jonxhën. Këto të fundit po kultivohen nëpër toka të destinuara si livadhe.

Sipërfaqet e mbjella me këto kultura janë dhënë në vijim:

| **Sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme (ha)** | | |
|---|---|---|
| Drithërat dhe të ngjashme | Gruri | 15,00 |
| | Misri | 00,00 |
| | Elbi | 13,50 |
| | Tërshëra | 2,50 |
| | Patatja | 5,00 |
| | **Gjithsej** | **36,10** |
| Perime të ndryshme (domate, speca, tranguj, pjepër, perime barishtore, etj.) | Në serra | 2,50 |
| | Në hapësirë të jashtme | 1,50 |
| | **Gjithsej** | **4,00** |
| Fruta pylli | Mjedra | 1,50 |
| | Dredhëza | 2,50 |
| | **Gjithsej** | **4,00** |
| Pemishte | Arra | 7,70 |
| | Pemishte tjera (molla, dardha, ftoj, kumbulla, etj.) | 5,00 |
| | **Gjithsej** | **12,70** |
| Vreshta | | 1,50 |
| **Gjithsej sipërfaqe e kultivuar bujqësore** | | **58,30** |

**Tabela 10:** Sipërfaqja e kultivuar bujqësore

## 4.3. Blegtoria

Blegtoria është zhvilluar gjithashtu në kohët e fundit duke bërë që të shtohet veçanërisht numri i lopëve qumështore, por edhe të deleve dhe dhive. Edhe numri i pulave dhe kolonive të bletëve është shtuar me të madhe. Numri i tyre është dhënë në tabelën në vijim[6]:

| **Numri i krerëve të kafshëve shtëpiake/ shpezëve/ kolonive të bletëve** | | |
|---|---|---|
| Gjedhi | Lopë qumështore | 450 |
| | Pjesa tjetër e gjedhit | 135 |
| | Gjithsej | 585 |
| Delet | | 1639 |
| Dhitë | | 52 |
| Pulat | | 200 |
| Kolonitë e bletëve | | 2060 |

**Tabela 11:** Numri i krerëve të kafshëve blegtorale

Prodhimtaria e qumështit vlerësohet në 87,67 litra/ ditë, e mishit në 3500 kg/ vit, e vezëve 180 copë/ ditë dhe e mjaltit në 4000 kg/ vit.

## 4.4. Pyjet

Po sipas të dhënave nga Sektori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës[7], tokat pyjore përfshijnë 4.848,56 ha. E tërë sipërfaqja pyjore kategorizohet si e mbrojtur, pa destinim për ndonjë qëllim komercial.

Sipërfaqja reale e pyjeve nuk përkon me atë destinuar si më lart. Duke filluar nga vitet e 90-ta, pyjet janë dëmtuar (zjarre) dhe prerë në vazhdimësi në mënyrë jo-formale për tu shfrytëzuar si lëndë djegëse (burim kryesor për ekonomitë familjare). Në të vërtetë pyje të larta kanë mbetur në sipërfaqe relativisht të vogël. Një gjë pozitive është se aty ku pyjet janë prerë kanë filluar të rriten pyje të reja të cilat duhet ruajtur dhe zhvilluar. Shumica e sipërfaqes është potencial për pyje të larta përveç anës jug-perëndimore e cila mbulohet nga shkurret. Më së shumti është i përhapur ahu por ka edhe sipërfaqe me bung, shkozë, pishë, frashër[8], etj.

Në dhjetë vitet e fundit ka pasur aktivitete të pyllëzimit si mbjellja e 17 hektarëve me pisha në Gorancë nga qeveria lokale dhe qendrore, etj. Këto aktivitete planifikohen të vazhdojnë edhe në të ardhmen së bashku me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të pyjeve. Rrallimet komerciale dhe para-komerciale janë të përvitshme dhe ndikojnë pozitivisht në mirëmbajtjen e pyjeve dhe në shërbim më të mirë të ngrohjes.

---

[6] Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

[7] Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtja e Mjedisit
[8] Zyra për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronës

# Arsimi



# 5. Arsimi

Arsimi është institucion më i rëndësishëm shoqëror i cili ndikon në përmirësimin e të gjitha vlerave shoqërore, në zhvillimin ekonomik, në përmirësimin e të drejtave të njeriut, ngritjen e normave kulturore, në ngritjen e aftësive në punë, në zvogëlimin dhe zhdukjen e varfërisë, në barazinë gjinore, në respektimin e grupeve vulnerabile, dhe në përmirësimin e jetës së çdo individi.

Sistemi arsimor në Kosovë është duke funksionuar sipas modelit 5+4+3 nga viti 2002. Sipas këtij modeli 5 vite janë në arsimin fillor, pastaj vazhdohet me 4 vite të shkollimit fillor të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë.

Në komunën e Hani të Elezit arsimi është i organizuar në gjithsej 5 (pesë) institucione shkollore. Prej tyre 1 është institucion parashkollor "Ardhmëria". 3(Tri) shkolla të shkolla fillore të mesme të ulët (në Han të Elezit SHFMU "Ilaz Thaçi e cila ka dhe paralelet në fshatin Seçishtë dhe në fshatin Krivenik për klasat nga I-V, SHFMU Kështjella e Diturisë në Fshatin Paldenicë dhe SHFMU "Veli Ballazhi" në Fshatin Gorancë) dhe 1 (një) shkollë e mesme e lartë SHML "Dardania".
Të gjitha shkollat posedojnë kushte të mira si infrastrukturë të mirëfilltë, pajisje të nevojshme shkollore, kabinete etj.
Gjithashtu 3 (tri) shkollat fillore të mesme të ulët SHFMU posedojnë salla sportive me pajisjet e domosdoshme përkatës për aktivitete sportive dhe kulturore.

Komuna çdo vit ka investuar dhe do të investojë në përmirësimin e kushteve jo vetëm në infrastrukturë por edhe në cilësi, duke blerë kompjuterë, projektorë, pajisje tjera teknologjike, duke i angazhuar arsimtaret në trajnime të ndryshme, duke ju siguruar transportin për fëmijët që janë larg nga shkollat etj.
Në institucionet e arsimit publik ne Komunën e Hanit të Elezit për vitin shkollor 2020/2021 janë të punësuar gjithsej 119 nga të cilët 98 janë mësimdhënës ku 46 janë të gjinisë femërore dhe 33 të gjinisë mashkullore, 19 Administrata ku 3 janë të gjinisë femërore dhe 16 të gjinisë mashkullore dhe 2 staf profesional ku një është e gjinisë femërore dhe një gjinisë mashkullore.




**Grafiku 8:** Numri i stafit në institucionet publike parauniversitare, 2018-2022

Në institucion parashkollor "Ardhmëria" për vitin 2022/2023 ka gjithsej 54 fëmijë nga ta 30 te gjinisë mashkullore dhe 22 të gjinisë femërore. Gjithashtu kemi 10 punëtor të gjithë të gjinisë femërore.

Siç shihet edhe në grafikun më poshtë numrin i nxënësve në vitet e fundit është zvogëluar kjo për shkak të migrimit por edhe të natalitetit të ulët. Gjithashtu më poshtë kemi paraqitur edhe hartën e Komunës së Hanit të Elezit me vendodhjen e objektives shkollore.




**Grafiku 9:** Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2018-2022




**Figura 6:** Harta e objekteve shkollore dhe shëndetësore të Komunës së Hanit të Elezit

## 6.2 Niveli i arsimimit

Sipas regjistrimit të fundit (2011)[9] për nivelin e arsimit mbi 10 vjet, Komuna e Hanit të Elezit[10] ka një nivel me ndryshime të vogla krahasuar me normën mesatare të nivelit të Kosovës. Përderisa, përqindja arsimimit mbi 12 klasë është më e lartë se ajo e Kosovës, përqindja për nivelet kolegj e mbi janë më të ulëta se e mesatares së Kosovës.

| **Niveli i arsimimit** | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Nuk ka arsim formal** | | **Fillor** | | **E mesme e ulët** | | **E mesme e lartë** | | | Fakulteti (bachellor) | Pasuniversitar (master) | Doktoraturë | Gjithsej |
| | Dinë shkrim dhe lexim | Nuk dinë shkrim dhe | 4 klasa, sistemi fillor | Sistemi i ri 5 klasor | 8 klasa, sistemi i vjetër | 9 klasa, sistem i ri | 12 klasa sistemi i vjetër | 12 klasa, sistem i ri | Kolegj | | | | |
| Hani i Elezit | 402 | 299 | 762 | 750 | 2076 | 773 | 1537 | 662 | 78 | 205 | 13 | 1 | 7,5585 |
| % | 5.3 | 4.0 | 10.1 | 9,9 | 27.47 | 10.2 | 20.3 | 8.8 | 1.0 | 2.7 | 0.2 | 0 | 100 |
| Kosovë | 43702 | 43827 | 71623 | 70948 | 210138 | 77631 | 98748 | 54395 | 10640 | 29424 | 2811 | 228 | 1,429,1755 |
| % | 6.1 | 6.1 | 10 | 9.9 | 29.5 | 10.9 | 13.8 | 7.6 | 1.5 | 4.1 | 0.47 | 0.03 | 100 |

**Tabela 12** Niveli i arsimimit në Han të Elezit dhe Kosovë

[9] Agjencinë e Statistikave të Kosovës
[10] Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

# Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale



Shërbimet shëndetësore në komunë kryhen në nivelin parësor, i cili përfshinë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Qytezë dhe Ambulancën e Mjekësisë Familjare (AMF) në Gorancë. QKMF ofron shërbim për të gjithë qytetarët e komunës ndërsa AMF për qytetarët e Gorancës dhe Rezhancës.

QKMF funksionon në objektin e ndërtuar gjatë viteve '80-ta dhe të shtuar/ rinovuar disa herë pas vitit 2008. Përderisa hapësira e objektit dhe parcelës nuk janë të mjaftueshme, gjendja fizike e objektit është shumë e mirë dhe institucioni ofron shërbime për qytetarët 24 orë në ditë. Aty ofrohen këto shërbime: ekzaminim i përgjithshëm, shërbime infermierie, analiza laboratorike, trajtim urgjent, rreze rëntgen, stomatologji dhe shërbimi i farmacisë. AMF ofron shërbimin e ekzaminimit të përgjithshëm me mjekun 3 ditë / javë dhe shërbim infermierie 5 ditë/ javë. Objekti është relativisht i ri dhe në gjendje funksionale ndërsa parcela ka sipërfaqe më se të mjaftueshme.

Stafi shëndetësor i punësuar për ofrimin e shërbimit shëndetësor primar është si në vijim:

| **Stafi mjekësor i QKMF-së dhe AMF-së** | |
|---|---|
| Drejtor i QKMF-së | 1 |
| Mjek i përgjithshëm | 6 |
| Stomatolog | 1 |
| Teknik laborant | 1 |
| Teknik i radiologjisë | 1 |
| Teknik mjekësor (infermier) | 19 |
| Punëtor teknik (pastrues, shofer, etj.) | 3 |
| Gjithsej | 32 |

**Tabela 13:** Stafi shëndetësor në Han të Elezit i ndarë sipas shërbimeve të ofruara

Marrë parasysh tabelën më lart dhe legjislacionin në fuqi (UA Nr. 08/2017), ka mungesë të mjekëve dhe teknikëve familjarë, pediatrit dhe stomatologut si për nga kualifikimi ashtu edhe për nga numri i tyre. Ka edhe mungesa tjera të stafit.

Në lidhje me rrezen e mbulimit gjeografik të territorit, janë banorët e Gorancës dhe Krivenikut që duhet të udhëtojnë maksimum 7km' deri në QKMF për të marrë shërbim. Përderisa të tjerët janë më afër, 5548 banorët e Qytezës dhe vendbanimeve përreth kanë distancë 1 km' ose më pak. Në të njëjtën kohë, me shërbimet e ofruara nga AMF, janë banorët e Rezhancës të cilët duhet të udhëtojnë maksimalisht 2 km' për ti marrë ato, përderisa Gorancasit i kanë në qendër të fshatit. Edhe pse kjo infrastrukturë e mbulon relativisht mirë të gjithë territorin e komunës, mungesa e stafit profesional adekuat mjekësor, si dhe mungesa e barnave esenciale dhe tjera të nevojshme janë sfidat kryesore me të cilat përballet shërbimi shëndetësor në të dy institucionet me theks në AMF. Prandaj, qytetarët në zonat rurale duhet të udhëtojnë për në qendrën komunale për të kërkuar kujdes mjekësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila duhet të përballojë numër të shtuar të pacientëve.

# Hapësirat Publike



# 7. Hapësirat Publike

Shikuar përgjithësisht, si rezultat i strukturave kryesisht rurale në vendbanime të ndara në lagje, si dhe procesit më të vonshëm të urbanizimit të qendrës komunale, hapësirat në trajtë të shesheve janë në mungesë.

Ekziston sheshi i qytezës i cili së bashku me hapësirën publike për ecje dhe hapësirën e gjelbër përreth paraqet rastin më pozitiv të një hapësire publike të rregulluar. Ky shesh shtrihet në vet bërthamën e qytezës dhe ofron qasje të drejtpërdrejtë të funksionet kryesore urbane. Mes tjerash, shërben edhe për aktivitete të socializimit, rekreacionit pasiv, pushimit, lëvizjes[11], etj.

Hapësira publike të rregulluara ka edhe në qendër të Gorancës tek AMF-ja dhe në Paldenicë tek kroi mbi fshat; përderisa ka potenciale për hapësira publike përgjatë Lumit Lepenc.

Shikuar përgjithësisht, hapësirat e reja potenciale për shndërrim në hapësira publike, si dhe përmirësimi i qasjes dhe krijimin e infrastrukturës së gjelbër, mbeten një kërkesë për të ardhmen, që do të varen edhe nga ritmi i zhvillimeve të reja në vendbanime.

## 7.1. Parku i Qytetit

Hapësira prej 21693 m². e destinuar për Park të Qytetit gjendet në pjesën lindore të zonës urbane. Sipërfaqja e gjelbër me pyje, shkurre e barë është unike përgjatë luginës së Lumit Dimca. Lëvizjet për këmbësorë janë relativisht mirë të rregulluara duke përfshirë edhe disa objekte për organizime të ndryshme. Parku ka nevojë për mirëmbajtje të rregullt dhe intervenime të mëtutjeshme për qasje drejt tij nga zona urbane dhe më tej, sipërfaqe rekreacionale dhe të ngjashme.

## 7.2. Koridoret e gjelbërta

Shtegu për këmbësorë nga Uji i Thartë deri te Pika Kufitare (3.2 km) tashmë është shndërruar në një korridor të gjelbër që nga prezantimi i gjelbërimit në shumicën e segmentit të tij. Përderisa mirëmbajtja duhet të jetë më serioze, shirita gjelbërimi mund të rregullohen edhe për kufizim mjedisor të zonës industriale dhe në hapësira tjera të identifikuara.

Lumi Lepenc dhe përrojet Dimca, Rezhanca dhe Laçi që kalon nëpër territorin e komunës me brigjet e tyre ofrojnë potencial për rregullim dhe shndërrim në shtigje atraktive për ecje dhe rekreacion[12].

## 7.3. Menaxhimi i mbeturinave

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në tërë territorin e Komunës së Hanit të Elezit (100%) Në. qytezë ofrohet dy herë në javë, kurse në vendbanimet tjera një herë në javë. Mbeturinat deponohen në deponinë e përkohshme në Ferizaj apo në deponinë e përhershme regjionale në Velekincë, Gjilan. Shërbimi ofrohet nga qeveria lokale përmes Ndërmarrjes Publike Lokale – NPL "Pastrimi" që nga 1 janari 2017. Çmimet fikse mujore janë 5 euro për ekonomi familjare, 8 euro për biznese dhe 13 euro për çdo zbrazje të kontejnerit 1100 litërsh (secila me kontrata të veçanta). Duke përfshirë aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve, NPL ka një staf prej 21 veta, ndërsa ka në

[11] Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtja e Mjedisit
[12] Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

pronësi 3 kamionë, 2 traktor, 1 veturë dhe disa mekanizma shtesë për mbeturina.

Shtrirja e shërbimit është si në vijim:

| **Nr.** | **Vendbanimet** | **Shërbimi** | **Nr. i klientëve amviseri** | **Nr. i klientëve të tjerë** | | **Gjatësia e rutës së shërbimit (m')** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Qytezë (nga hekurudha në rrugën nacionale N2) | 2'/javë | 430 | Biznese 82 | Institucione 8 | 5-km |
| **2** | Qytezë me vendbanimet përreth | 1'/javë | | | | |
| **3** | Paldenicë | 1'/javë | 265 | 2 | 1 | 4- km |
| **4** | Gorancë | 1'/javë | 136 | 3 | 1 | 7-km |
| **5** | Rezhancë | 1'/javë | 79 | | | |
| **6** | Seçishtë | 1'/javë | 340 | 2 | | 5-km |
| **7** | Krivenik | 1'/javë | 43 | | | 7-km |
| **8** | Dimcë | 1'/javë | 37 | | | 2-km |
| **9** | Pustenik | 1'/javë | 88 | 2 | | 5-km |
| **10** | Laç | 1'/javë | | | | 7-km |
| **11** | Dremjak | 1'/javë | 18 | | | 3-km |
| **12** | Vërtomicë (i zbrazur) | JO | 0 | | | 0 |
| **13** | Neçavc (i zbrazur) | JO | | | | 0 |
| | | Gjithsej: | **1436** | 91 | 10 | **38** |

**Tabela 20:** Numri i klientëve të shërbyer dhe gjatësia e rutës së shërbimit për vendbanime

Deponitë jo-formale - Si rezultat i gjendjes së krijuar për disa vite pa ofrues formal të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave (para 2017), në territorin e komunës ka ende 2 deponi ilegale të mbeturinave edhe pse një numër i madh janë eliminuar. Kësaj i duhet shtuar edhe deponitë e mbeturinave ndërtimore edhe pse Komuna e HiE ka përcaktuar një lokacion për mbeturina të tilla në lokacionin e mihjes sipërfaqësore të mergeles. Kjo gjendje e krijuar në terren paraqet një nga sfidat më të mëdha të Komunës së HiE respektivisht NPL Pastrimi.

Mbeturina tjera - Mbeturinat e azbestit të gjeneruara nga fabrika e produkteve të azbest-çimentos para vitit 1999, në vitet 2017-18 janë pastruar nga shtrati i lumit Lepenc dhe nga vet uzinat e fabrikës dhe janë deponuar në pjesën e minierave të vjetra të kromit në Gorancë ngjitur kufirit me Maqedoninë. Në këtë mes vlerësohet se duhet bërë hulumtime shtesë në terren për të ditur nëse janë pastruar në tërësi këto mbetje të rrezikshme.

## 7.4. Hapësirat e gjelbërta

Me përjashtim qytetit të Hanit të Elezit Natyra e Sharrit dhe Karadakut dhe e korridoreve përgjatë rrjedhave ujore përbëjnë rrjetin e gjelbër unik të shtrirë në mbi 75% territorit komunal. Ky ekosistem natyror deri së voni kryesisht i paprekur ofron ujin e pastër nga krojet dhe përrenjtë e shumtë, pastrimin e ajrit dhe ujit të ndotur, resursin për energji dhe ngrohje, lokacionin shumë të përshtatshëm për relaksim për banorët si dhe kushte esenciale për botën ujore dhe jashtë saj.

## 7.5. Degradimi i mjedisit

Komuna e Hanit të Elezit respektivisht zona urbane me vendbanimet përreth në lindje të lumit Lepenc edhe më tutje vazhdon të konsiderohet si njëra nga pikat më të ndotura në Kosovë sa i përket ndotjes së ajrit. Gjatë trajtimit të përgjithshëm të gjendjes mjedisore, problematikë serioze është identifikuar edhe ndotja e ujit kryesisht nga ujërat e zeza, kontaminimi i brigjeve të lumit Lepenc nga mbetjet e asbest-çimentos dhe mbeturinave të ngurta, ndotja e tokës nga deponitë ilegale të mbeturinave, ndotja e përgjithshme dhe dëmtimi i peizazhit nga gurëthyesit, degradimi i pyjeve, si dhe humbja e tokës bujqësore përmes ndërtimit të paligjshëm.
Edhe pse ekzistojnë të dhëna formale, studime hulumtuese dhe profesionale për përcaktimin e normës së ndotjes (ujit, tokës dhe ajrit) në komunë nuk janë bërë ende. Ky problem nuk është i pranishëm vetëm në komunë, por është i pranishëm edhe në nivel vendi. Por duke pasur parasysh ndotjen evidente posaçërisht të ajrit, reaksioni formal duhet të jetë më urgjent në këtë rast. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të përmirësojë ndjeshëm gjendjen në mbrojtjen e mjedisit[13].

## 7.6. Ndotja e ujit

Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre (shih aneksin 10 - Harta e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësor ndaj ndotjes). Ky rrjet shkakton derdhjen e ujërave të zeza pa trajtim paraprak, me një ndikim negativ në cilësinë e ujit si dhe në jetën bimore dhe shtazore. Pasojat e kësaj ndotje mund të shkojnë edhe më tej duke shkaktuar ndikime negative në tokë dhe në ajër. Në rastin e Hanit të Elezit, kjo ndotje grumbullohet edhe nga Komunat e Kaçanikut, Ferizajt dhe Shtërpces ,të cilat njëjtë ujërat e zeza i lëshojnë në lumenj (Nerodime dhe Lepenc) të pa trajtuara. Si përgjigje ndaj kësaj dukurie, dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore, komuna është duke e ndërtuar sistemin kryesor të kanalizimit duke përfshirë edhe kolektorët ku do të përfshihen të gjitha vendbanimet e komunës.

Karakteristike për Hanin e Elezit është edhe ndotja e lumit dhe bregut të Lepencit nga mbetjet e asbest-çimentos të derdhura për dhjetëra vite nga industria tashmë jo funksionale. Para 4 viteve, MMPHI realizoi një projekt ku gërmoi dhe transportoi këto mbetje në deponinë e përgatitur enkas në rrafshnaltën e Gorancës (Zheden). Megjithatë, vlerësimet nga qeveria lokale dhe banorët e Lagjes së Anëlumit (zona urbane) tregojnë se ka ende mbetje të tilla përgjatë breglumit të Lepencit. Edhe ujërat industriale të pa trajtuara mund të shkaktojnë ndotjen e tyre. Duke e ditur karakteristikat industriale të komunës, duhet bërë hulumtime dhe monitorime në këtë drejtim nga ndotës potencial.

Zhvillimet tjera shqetësuese potenciale që kanë të bëjnë me ndikimet në lumin Lepenc janë ndërtimi i planifikuar i 2 hidrocentraleve (Lepenci 1 dhe Lumi i Kotlina) që janë vlerësuar se mund të ndikojnë negativisht në tërë ekosistemin e ujit të pastër të Pellgut të Lepencit për shkak të devijimit të 70% të ujit në gypa për kilometra të tëra dhe arsyet tjera[14]. Për më tepër lumi paraqet një nga elementet kryesore të mjedisit të kategorizuar si Trashëgimi Natyrore.

[13] Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
[14] Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

## 7.7. Ndotja e tokës

Mbeturinat e ngurta të akumuluara në deponitë ilegale janë ndër ndotësit kryesorë të tokës në komunë. Këto janë kryesisht deponi ilegale të mbeturinave shtëpiake, dhe në disa raste mbetjeve të ndërtim/rrënimit, të cilat kryesisht gjenden në afërsi të rrugëve (shih aneksin 10 - Harta e deponive ilegale). Ndikimet negative të këtyre deponive janë të shumta, ku përveç kontaminimit të drejtpërdrejtë të tokës dhe ajrit, ndikimi i tyre mund të bartet në rrjedhat e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nëpërmjet reshjeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike për çdo vit e bën evidentimin e deponive ilegale dhe organizon pastrimin e tyre. Në mungesë të një sistemi të kompletuar dhe të mjaftueshme të kanalizimit, ujërat e zeza duhet të trajtohen si ndotës potencial të tokës. Kjo ndotje mund të shkaktohet nga kalimi i ujërave të zeza në zonat e ujit sipërfaqësor apo rrjedhave nëntokësore, varësisht nga forma e shkarkimit të tyre - drejtpërdrejtë në rrjedhat e ujit (në shumicën e rasteve) ose në sipërfaqen e tokës.

Përveç ndotjes së drejtpërdrejtë, si një formë tjetër e degradimit të tokës është ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Po ashtu, problem të veçantë paraqet edhe degradimi i pyjeve përmes prerjes ilegale.

## 7.8. Ndotja akustike

Sa i përket ndotjes akustike, nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme. Fakti që përmes territorit të komunës kalon autoudha R6 dhe nacionalja N2 ndërsa asnjëra nga to nuk ka ndonjë formë mbrojtëse, tregon se zhurma është evidente. Gjithashtu ndotësit tjerë janë veprimtaritë industriale si Sharrcem, Kosovaplast (në zonën urbane) dhe gërmimet grumbulluese (gurëthyesit) brenda territorit të komunës.

# Shërbimet Publike

# 8. Infrastruktura

Infrastrukturën e Komunës së Hanit të Elezit e përbëjnë 9.64 km rrugë rajonale të asfaltuara, 28 km rrugë lokale të asfaltuara që lidhin zonën urbane me atë rurale, dhe mbi 30km rrugë lokale të asfaltuara brenda zonës urbane dhe atyre lokale. Në kuadër të infrastrukturën së komunës përfshihen edhe 9 km trotuare, 2.75 km shtigje për çiklistë, 73 km ndriçim publik, rreth 22 km ujësjellës dhe rreth 120 $m^2$ hapësira të gjelbëruara. Pjesa më e madh e këtyre investimeve janë bërë nga buxheti i komunës, por ka pasur mbështetje edhe nga donatorët e ndryshëm. Më shumë detaje në tabelë.

| **Lloji i infrastrukturës** | **Gjendja 2021** |
|---|---|
| Rrugë të asfaltuara regjionale (Magjistralja dhe Autoudha) (km) | 9.64 |
| Rrugë lokale te asfaltuara (Zona Urbane - Vendbanim) (km) | 28.06 |
| Rrugë lokale te asfaltuara (brenda Zonës Urbane) (km) | 8.52 |
| Rrugë lokale te asfaltuara brenda vendbanimeve rurale (kryesore) (km) | 21.84 |
| Trotuare (Zona Urbane dhe Zona Rurale) (km) | 9.04 |
| Shtigje për çiklistë (km) | 2.75 |
| Ndriçim publik (km) | 73 |
| Ujësjellës (km) | 21.7 |
| Kanalizim atmosferik (km) | 3.1 |
| Kanalizim i ujërave të zeza urbane (km) | 29.4 |
| Hapësira të gjelbëruara (publike) ($m^2$) | 1200 |

**Tabela 14:** Infrastruktura në komunën e Hanit të Elezit




**Figura 7:** Harta infraskturore urbane e territorit të komunës së Hanit të Elezit

## 8.1. Transporti

Në Han të Elezit ekzistojnë tri linja të rëndësishme të transportit: autostrada Prishtinë-Shkup, rruga magjistrale Prishtinë-Shkup dhe linja hekurudhore Fushë Kosovë-Shkup. Këto nyje të transportit kanë një rëndësi të madhe dhe e bëjnë Hanin e Elezit një vend kyç që lidh Kosovën dhe Maqedoninë dhe me vendet e tjera të Ballkanit.

Rruga që lidh Hanin e Elezit dhe Glloboçicën më gjatësi rreth 13.5 km, nga të cilat 11.3 km janë brenda territorit Hani i Elezit është gjithashtu me rëndësi të madhe, pasi që ajo lidh dy vendkalimet kryesore kufitare midis Kosovës dhe Maqedonisë dhe vlerësohet si një rrugë e rëndësishme për lidhjen rajonale.

Rrugë tjera me rëndësi brenda territorit të Komunës janë edhe Hani i Elezit-Secishte-Krivenik (3.7 km), Hani i Elezit-Peldenicë (2.24 km), Hani i Elezit-Gorancë (5.43 km), Hani i Elezit-Meliq-Pustenik (4.46 km), Peldenicë-Dremjak (2.9 km), Neqavcë-Dremjak (4.3), Gorancë-Krivenik (4.22 km), Krivenik-Secishte (2.4 km), etj.

| Lloji i infrastrukturës transportuese | Gjatësia në km |
|---|---|
| Autostradë | 5.17 |
| Rrugë magjistrale (autoudha) | 4.47 |
| Rrugë lokale te asfaltuara që lidhin zonën urbane me vendbanime | 28.06 |
| Rrugë lokale te asfaltuara brenda zonës urbane | 8.52 |
| Rrugë lokale te asfaltuara brenda vendbanimeve rurale | 21.84 |
| Hekurudhë | 2.4 |

**Tabela 15:** Infrastruktura transportuese rrugore dhe hekurudhore në territorin e komunës së Hanit të Elezit

Rrugët e komunës së Hanit të Elezit që lidhin qendrën me zonat rurale janë kryesisht rrugë që kalojnë përmes maleve dhe janë të vështira për mirëmbajtje.

Krahas rëndësisë që kanë këto rrugë për komunën, ato kanë edhe ndikimet e tyre mjedisore sepse janë një burim i ndotjes së ajrit dhe burim i zhurmës.




**Figura 8:** Harta e rrugëve dhe transportit publik

## 8.2. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre

Lumi Lepenci që kalon nëpër territor të Komunës së Hanit të Elezit, përfaqëson rrjedhën më të rëndësishme ujore në këtë territor. Lumi është i tipit të hapur me një rrjedhje në drejtim të jug-lindjes, dhe formon pellgun e tij ujor në këtë rajon, që përveç Hanit të Elezit, përfshinë edhe Kaçanikun, Shtërpcën dhe një pjesë të Ferizajit. Pellgu ka një sipërfaqe prej 800 km2 dhe prurje mesatare prej 8 m3 /sek.

Burimet tjera ujore me rëndësi përfaqësohen nga lumenjtë të vegjël dhe përrenj që rrjedhin në dy anët perëndimore dhe lindore të luginës së lumit Lepenc. Nga këto rrjedha veçohen lumenjtë e vegjël Ortica, Kriveniku, Kalanderi, Kotlina dhe Radovica, si dhe përrenjtë: përroi i Rezhancës, përroi i Najs dhe ai i Dimcës. Të gjitha këto rrjedha derdhen në lumin Lepenc. Ka edhe përrenj të vegjël në gjithë territorin e komunës që karakterizohen me rrjedha ujore periodike.




**Figura 9:** Harta hidrologjike e territorit të komunës së Hanit të Elezit

Është evidentuar edhe një burim të ujit mineral në vendin e ashtuquajtur Uji i Tharte, afër rrugës magjistrale Prishtinë-Hani i Elezit. Ka burime të ujit natyral në pothuajse të gjitha fshatrat e Hanit të Elezit. Ujërat nëntokësore janë vlerësuar në një thellësi të madhe dhe që nuk arrijnë standardet e zbatueshme të cilësisë për ujë të pijes.

### 7.9.**Mbulimi me shërbimin e ujësjellësit-**

Hani i Elezit, me ujësjellës furnizohet nga dy burime. Burimi i Glloboqicës dhe nga burimi i prrockës së Dimcës. Me burimin e Glloboqicës janë të mbualuara: Lagjja e re, Lagjja nën Hekurudhë, Seqishtë, dhe lagjet Meliq e Brava. Ky sistem menaxhohet nga KRU  Bifurkacioni, nën-njësia në Han të Elezit.

Nga burimi i prrockës së Dimcës me shërbimin e ujësjellësit mbulohet zona urbane e Hanit të Elezit dhe Lagjja e Ujit të Thartë. Kjo pjesë e ujësjellësit menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Hanit të Elezit.

| Burimi i furnizimit | Rrjeti i ujësjellësit | Vendbanimet e përfshira | Organi menaxhues |
|---|---|---|---|
| Burimi i Glloboqicës | Rrjeti i furnizimit nga burimi i Glloboqicës | Lagjja e Re e Hanit të Elezit, Lagjja nën Hekurudhë, Seqishtë, Lagjja Meliq, Lagjjaa– | KRU Bifurkacioni, Nën-njësia në Hanin e Elezit |
| Burimi i Prrockës së Dimcës | Rrjeti i furnizimit nga Prrocka e Dimcës | Zona urbane e Hanit të Elezit dhe Lagjja e Ujit të Thartë | Komuna e Hanit të Elezit, Drejtoria e Shërbimeve Publike |
| Pa burime publike të ujit të pijes | Pa rrjet të furnizimit publik të ujësjellësit | Paldenicë, Krivenik, Dimcë, Dërmjak, Neqavc, Vërtomicë dhe Pustenik | I pa përcaktuar |

**Tabela 16:** Shërbimi i ujësjellësit sipas vendbanimeve

Sa i përket mbulueshmërisë me shërbimin e ujësjellësit, ky shërbim ofrohet për rreth 62% të banorëve të komunës ose për 1452 ekonomi familjare. Për më shumë shihni tabela 17.

| Mbulimi me shërbimin e ujësjellësin në komunën e Hanit të Elezit | Nr. | % |
|---|---|---|
| Numri i përgjithshëm i banorëve | 9403 | 100 |
| Numri i ekonomive familjare në komunë | 1452 | 100 |
| Numri i ekonomive familjare të përfshira me shërbimin e ujësjellësit | 906 | 62.3 |
| Objekte të institucioneve publike në komunë | 16 | 100 |
| Numri i objekteve të institucioneve të përfshira me shërbimin e ujësjellësit | 16 | 100 |
| Numri i bizneseve aktive në komunë | 352 | 100 |
| Numri i bizneseve të përfshira me shërbimin e ujësjellësit | 230 | 65.3 |

**Tabela 17:** Mbulushmëria me shërbimin e ujësjellësit

Problemet kryesore me të cilat përballen banorët e Hanit të Elezit sa i përket furnizimit me ujë janë: mirëmbajtja jo e mirë dhe e rregullt e sistemeve të ujësjellësve, keqpërdorimet e ujit, mungesa e ujit gjatë sezonës së verës, mungesa e matësve të ujit, prishjet e shpeshta të pompave të ujit dhe mungesa e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm në disa lokalitete.

Në rrjetin e ujësjellësit që mbulohet nga Glloboqica qytetarët kryejnë obligimet ndaj kompanisë por një pjesë janë të pa kujdesshëm dhe nuk i kryejnë obligimet. Problem tjetër është humbja e ujit në rrjetin e ujësjellësit për shkak se në këtë rrjet ka kyçje ilegale.

Në pjesën e rrjetit të ujësjellësit i cili furnizohet nga prrocka e Dimcës uji është jo i pijshëm për arsye se uji nuk përpunohet. Uji turbullohet dhe është i papërshtatshëm për pijë sidomos gjatë reshjeve atmosferike dhe gjatë sezonës dimrit. Për shkak të problemeve ligjore ende nuk ka fabrikë për përpunimin e ujit që nga viti 2010. Komuna nuk ka kompetenca ligjore për menaxhimin e këtij problemi ndërsa KRU Bifurkacioni edhe pse ka qenë nënshkruese e marrëveshjes për menaxhimin

e kësaj fabrike si dhe rrjetit të ujësjellësit kjo e fundit nuk i ka marra obligimet, kështu që kjo pjesë e ujësjellësit që 11 vite mirëmbahet nga organet komunale.

Komuna ka në plan që bashkëpunim me zyrën zvicerane CDI, dhe KRU Bifurkacioni të realizoj projektin për funksionalizimin e fabrikës, rehabilitimin e një pjese të rrjetit të ujësjellësit, vendosjen e ujëmatësve. Menaxhimin i këtij rrjeti të ujësjellësit pritet të kalojë në kompetenca nga KRU Bifurkacioni. Vendbanimet të cilat nuk kanë rrjet të ujësjellësit janë: Paldenicë, Krivenik,Dimcë, ndërsa për arsye të numrit të vogël në vendbanimet Dërmjak, Neqavc, Vërtomicë dhe Pustenik banorët bëjnë zgjidhej individuale.

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, dhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, janë aktet nënligjore që e rregullojë mbrojtën e ujërave të pijshëm. Sa i përket përgjegjësive institucionale Kompanitë Regjionale të Ujësjellësit (KRU) kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor për konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik (IKSHPK), është institucion përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK ka obligim që të sigurojë që uji i distribuuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendore për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik.

Komuna e Hanit të Elezit, ndodhet në zonën e shërbimit të KRU Bifurkacioni. Sipas raporteve të IKSHP, cilësia e ujit të pijes për zonën e KRU Bifurkacioni, sa i përket parametrave mikrobiologjik ka përputhshmëri me standardet 98.6%, ndërkaq përputhshmëria me parametrat kimik është 96.7 %[15]. Rezultate pak a shumë të ngjashme për cilësinë e ujit të pijes në zonën e shërbimit të KRU Bifurkacioni, raportohen edhe sipas Raportit të performancës së KRU-ve për vitin 2019, ku sa i përket parametrave mikrobiologjik përputhshmëria është 95.5%, ndërkaq përputhshmëria me parametrat kimik është 92.1%[16].

### 8.3. Mbulimi me shërbimin e kanalizimit

Në territorin e komunës së Hanit të Elezit nga 11 vendbanime në rrjetin e kanalizimit janë të përfshira: zona urbane –Hani i Elezit, fshatrat Paldenicë, Seqishtë, Gorancë, Rezhancë, Krivenik, dhe lagjet Meliq-Brav. Një pjesë e rrjetit të kanalizimeve menaxhohet nga KRU Bifurkacioni, nën-njësia në Han të Elezit, ndërsa pjesa tjetër nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së

[15] *Cilësia e ujit të pijshëm në Kosovë 2016, IKSHPK.*
[16] *Raporti i Performancës së KRU-2018, ARRU.*

Hanit të Elezit. Vendbanimet: Neqavc, Vërtomic dhe Pustenik nuk janë të përfshira në rrjetin e kanalizimit[17].

| Rrjeti i kanalizimit | Vendbanimet e përfshira | Organi menaxhues |
|---|---|---|
| Rrjeti i Glloboqicës | Lagjja e Re e Hanit të Elezit, Lagjja nën Hekurudhë, Seqishtë, Lagjja Meliq, Lagjja–Brava. | KRU Bifurkacioni, Nën-njësia në Hanin e Elezit |
| Rrjeti i Prrockës së Dimcës | Zona urbane e Hanit të Elezit dhe Lagjja e Ujit të Thartë | Komuna e Hanit të Elezit, Drejtoria e Shërbimeve Publikë |
| Pa rrjet të kanalizimit | Neqavc, Vërtomic dhe Pustenik | I pa përcaktuar |

**Tabela 18:** Shërbimi i kanalizimit sipas vendbanimeve

Sa i përket mbulueshmërisë me shërbimin e kanalizimit, ky shërbim ofrohet për rreth 80.6% të banorëve të komunës ose për 1171 ekonomi familjare. Për më shumë shihni tabela 16.

| Mbulimi me shërbimin e kanalizimit në komunën e Hanit të Elezit | Nr. | % |
|---|---|---|
| Numri i përgjithshëm i banorëve | 9403 | 100 |
| Numri i ekonomive familjare në komunë | 1452 | 100 |
| Numri i ekonomive familjare të përfshira me shërbimin e kanalizimit | 1171 | 80.6 |
| Objekte të institucioneve publike në komunë | 16 | 100 |
| Numri i institucioneve të objekteve publike të përfshira me shërbimin e kanalizimit | 16 | 100 |
| Numri i bizneseve aktive në komunë | 352 | 100 |
| Numri i bizneseve të përfshira me shërbimin e kanalizimit | 248 | 70.5 |

**Tabela 19:** Mbulushmëria me shërbimin e kanalizimit

Problemet **-** të gjitha këto rrjete të kanalizime derdhen në lumin Lepenc ose në prrocka të ndryshme pa trajtim paraprak të ujërave të zeza. Komuna planifikon që të rregulloj një kolektor të përbashkët për pjesës më të madhe të kanalizimeve dhe në bashkëpunim me donatorët të adresojë edhe problemin e trajtimit të ujërave urbane përmes trajtimit të tyre.

[17] Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

# Kultura, Sporti dhe Turizmi



# 9. Kultura dhe Sporti

## 9.1. Kultura

Në komunën e Hanit të Elezit funksionon qendra kulturore „Imri Curri“, ku në këtë qendër janë të përfshira salla kryesore për organizimin e manifestimeve të ndryshme kulturore si: manifestime përkujtimore, shfaqje teatrale dhe koncerte të ndryshme. Poashtu në objekt gjinden edhe sallat për takime dhe aktivitet të tjera, biblioteka e qytetit me një kapacitet të mjaftueshëm të librave, është funksionale edhe këndi për ekspozita (piktura, veshje tradicionale, traditat popullore, monumente të lashta të gjetura në trevat komunës). Në kuadër të aktiviteve kulturore është edhe Shoqëria Kulturore Artistike SHKA”Sharri”, e formuar më 1974, e që janë pjesëmarrës në pothuajse çdo aktivitet duke sjellë një laramani të këngëve dhe valleve të bukura tradicionale.

## 9.2. Sporti

Në komunën e Hanit të Elezit ekzistojnë klubet sportive si Klubi i Futbollit “Sharri” për të gjitha grup moshat që merr pjesë në garat e organizuara nga Federata e Futbollit të Kosovës.

Klubi i mundjes “Dardania” i cili merre pjesë në garat në Kosovë dhe jashtë saj. Më herët por edhe tani, ka pasur mundës të suksesshëm që kanë fituar medalje të arta në nivel vendi edhe medalje ndërkombëtare.

Gjithashtu edhe është e organizuar edhe Klubi i Volejbollit “Sharri për gjininë femërore.

Komuna jonë ka 3(tri) salla sportive. Një në Han të Elezit tek SHFMU “Ilaz Thaçi". Në fshatin Gorancë tek SHFMU “Veli Ballazhi", dhe në fshatin Paldenicë tek SHFMU “Kështjella e Diturisë". Gjithashtu edhe stadiumin i futbollit “Suad Brava” ku i mban aktivitet Klubi i Futbollit “Sharri”.

Ekziston edhe një fushë sportive private e mbuluar e futbollit të vogël ku rinia dhe moshat tjera praktikoj lojën e futbollit te vogël.

Kohët e fundit ka marrë hov edhe sporti i bjeshkatarisë me Klubin Alpin të Hanit të Elezit (jo i regjistruar). Ky klub është shumë aktiv me ecje gati të përjavshme. Rreth 10 ecje në vit organizohen nëpër bjeshkët e Hani të Elezit duke mbledhur bjeshkatarë nga shumë vend të Kosovës dhe Maqedonisë dhe duke promovuar trashëgiminë natyrore dhe kulturore të vendit.

Të gjitha organizatat e lartpërmendura (përveç Klubit Alpin) janë të regjistruara si OJQ dhe funksionojnë me subvencione vjetore nga qeveria lokale dhe në raste të caktuara nga organizata tjera.

## 9.3. Turizmi

Për shkak të karakteristikave gjeografike të Hanit të Elezit, përveç trashëgimisë kulturore, trashëgimia natyrore reflekton me bukurinë e saj. Konfigurimi i terrenit, lumi Lepenc dhe peizazhet natyrore të kombinuara me ndërtesat tradicionale të banimit përfaqësojnë një vlerë të madhe që duhet trajtuar dhe mbrojtur. Puset e Nikës janë një vendbanim i Hanit të Elezit, i cili cilësohet me shtëpi të vjetra banimi të ndërtuara sipas stilit arkitektonik autokton. Pikë tjetër referimi për vizitë në këtë vend janë edhe Varrezat e Dëshmorëve që cilësohet si njëri ndër

lokalitetet më të rëndësishme të vendit. Pjesa e vjetër e fabrikës së çimentos si dhe apartamentet e vjetra ngjitur saj, të ndërtuara në kohën e fillimit të zhvillimit industrial, janë vlerësuar si fondament i rëndësishëm që tregon identitetin e vërtetë të Hanit të Elezit andaj me rivitalizimin dhe adaptimin e tyre në një hapësirë për mundësi drejtë turizmit industrial do të shërbente si një pikë referimi për hulumtim të historisë dhe për zhvillim të turizmit. Parku Memorial Bllaca '99, është pjesë e historisë së luftës së viteve 1999 të Kosovës dhe pikë referimi e çdo personi që vjen në Han të Elezit me qëllim të vizitës së saj. Në këtë Qendër Përkujtimore gjendet "Muri i Harresës", një mozaik që simbolizon sakrificën e nënës shqiptare dhe treni muze me mbishkrimin Bllaca 99 si pjesë e kujtimeve të asaj kohe. Kjo hapësirë gjatë këtij viti u pasurua edhe me drunjë dekorativ, shtigje të ecjeve dhe sheshe. Planifikohet që shumë shpejt të vendoset edhe një instalacion i një tende që pasqyron saktë vendin ku shqiptarët kishin qëndruar gjatë kohës së dëbimit[18].

[18] Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

# 10. Buxhet

Disa nga vështirësitë që janë përballur komunat në Republikën e Kosovës janë: mungesa e një fondi adekuat qendror për investime kapitale të nxitur nga projektet i cili do të menaxhohej nga qeveria sipas një sistemi të unifikuar, mungesa e një tregu kreditor që do t'i mundësonte komunave qasjen në fonde për zhvillim me kamata të ulëta, mungesa e mekanizmit për fondet për emergjenca të paparashikuara. Ekziston një dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake (mesatarisht 18%) dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës (mesatarisht 82%).

Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:

- Tatimi në pronë;
- Tatimi në tokë;
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë biznesore;
- Taksat për leje të ndërtimit;
- Taksa për shfrytëzimin e pronës komunale;
- Taksa për regjistrimin e automjeteve motorike;
- Taksat administrative komunale (taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si certifikatat e lindjes, martesës, vdekjes, shtetësisë etj.);
- Bashkë-pagesat në arsim;
- Bashkë-pagesat në shëndetësi dhe
- Të hyra tjera.




**Grafiku 10:** Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitet 2021-2025

## 10.1. Të hyrat komunale

Në tabelat më poshtë kemi paraqitur të hyrat vetanake dhe transfert qeveritare për vitet 2021-2023 dhe parashikimin dhe vlerësimin për vitet 2024-2025

| Te hyrat vetanake | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Vitet | Viti 2021 | % | viti 2022 | % | Viti 2023 | % | Planifikimi për vitin 2024 | % | Vlerësimi 2025 | % |
| Taksat komunale | 110 087,00 € | 38,95% | 118 855,00 € | 31,75% | 267 884,00 € | 47,83% | 75 000,00 € | 27,35% | 78 774,00 € | 27,77% |
| Tatimi në pronë | 94 753,00 € | 33,53% | 140 000,00 € | 37,40% | 105 326,00 € | 18,80% | 151 848,00 € | 55,36% | 155 853,00 € | 54,95% |
| Tatimi në tokë | 52 450,00 € | 18,56% | 85 572,00 € | 22,86% | 117 411,00 € | 20,96% | 32 065,00 € | 11,68% | 32 772,00 € | 11,56% |
| Ngarkesat komunale | 25 334,00 € | 8,96% | 29 920,00 € | 7,99% | 69 500,00 € | 12,41% | 15 463,00 € | 5,61% | 16 213,00 € | 5,72% |
| **Gjithsej** | **374 347,00 €** | **100,00%** | **374 347,00 €** | **100,00%** | **560 121,00 €** | **100,00%** | **274 376,00 €** | **100,00%** | **283 612,00 €** | **100,00%** |

**Tabela 23:** Të hyrat vetanake

| Transferat qeveritare | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Viti 2021 | % | Viti 2022 | % | Viti 2023 | % | Planifikimi për vitin 2024 | % | Vlerësimet 2025 | % |
| Granti i përgjithshëm | 1 055 957,00 € | 47,32% | 1 112 582,00 € | 46,78% | 1 431 545,00 € | 51,32% | 1 583 941,00 € | 51,52% | 1 694 053,00 € | 52,33% |
| Granti për Arsim | 849 714,00 € | 38,08% | 939 957,00 € | 39,52% | 993 487,00 € | 35,61% | 1 089 623,00 € | 35,43% | 1 122 311,29 € | 34,66% |
| Granti për Shëndetësi | 325 871,00 € | 14,60% | 325 871,00 € | 13,70% | 364 561,00 € | 13,07% | 401 338,00 € | 13,05% | 421 405,00 € | 13,01% |
| **Gjithsej** | **2 231 542,00 €** | **100,00%** | **2 378 410,00 €** | **100,00%** | **2 789 593,00 €** | **100,00%** | **3 074 902,00 €** | **100,00%** | **3 237 769,29 €** | **100,00%** |

**Tabela 24:** Transferat qeveritare

## 10.2. Shpenzimet Buxhetore

Siç shihet në vijim, shpenzimet rrjedhëse mestare ndër vite 77.51% janë mesatarisht të shpenzimeve komunale dhe ato kapitale mesatarisht 22.49%[19]. Nga shpenzimet rrjedhëse, më të lartat janë ato për paga dhe mëditje, pastaj shpenzimet për mallra dhe shërbime, subvencionet dhe shpenzimet komunale[20].

[19] Drejtoria për Buxhet dhe Finaca

[20] Instituti GAP (https://www.institutigap.org/home)

| Shpenzime komunale | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Vitet | Viti 2020 | | Viti 2021 | | viti 2022 | | Viti 2023 | |
| Paga dhe Mëditje | 1 519 196,00 € | 55,40% | 1 602 781,00 € | 63,60% | 1 756 083,00 € | 63,63% | 1 702 822,65 € | 50,83% |
| *Shpenzime Kapitale* | 629 772,18 € | 22,97% | 440 127,00 € | 17,46% | 455 000,00 € | 16,49% | 985 392,00 € | 29,42% |
| Mallra dhe Shërbime□ | 303 236,00 € | 11,06% | 335 258,00 € | 13,30% | 385 975,00 € | 13,99% | 465 000,00 € | 13,88% |
| *Subvencione dhe Transfere* | 61 104,00 € | 2,23% | 75 000,00 € | 2,98% | 80 000,00 € | 2,90% | 100 000,00 € | 2,99% |
| Shpenzime Komunale | 60 000,00 € | 2,19% | 67 000,00 € | 2,66% | 67 700,00 € | 2,45% | 96 500,00 € | 2,88% |
| *Rezerva*□ | 168 786,82 € | 6,15% | 0,00 € | 0,00 € | 15 000,00 € | 0,54% | 0,00 € | 0,00% |
| **Gjithsej** | **2 742 095,00 €** | **100,00%** | **2 520 166,00 €** | **100,00%** | **2 759 758,00 €** | **100,00%** | **3 349 714,65 €** | **100,00%** |

**Tabela 25:** Shpenzimet komunale

PËRPARËSITË
• Strukturë e re e popullsisë
• Pozitë e mirë gjeografike (komunë ndërkufitare) dhe lidhje të mira të komunikacionit rrugor dhe hekurudhor.
• Resurse nëntokësore (mergele, gurë gelqeror, krom, zhavorrit, gurit për ndërtim etj.
• Industri e zhvilluar.
• Sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore të punueshme
• Vend me tradit të vjetër në industri dhe bujqësi.
• Kushte të mira klimatike për zhvillim të bujqësisë, perimtarisë, pemëtarisë, blegtorisë etj.
• Trashëgimi të pasur kulturore dhe arkeologjike
• Resurse turistike
• Administratë të besueshmëri në shkallë locale dhe vendi.
• Të fokusuarit në mirëqenien e qytetarëve
• Subvencione nga komuna për bujqësi, sport, kultur etj..
• Investime të vazhdueshëme në infrastukturën rrugore, parqe etj.
• Natyra me dy Masivet malore dhe lumenjte unik.

DOBËSITË
• Buxheti i ulët (mundësi të ulëta për rritjen e të hyrave vetanake.
• Migrimi kombëtar dhe ndërkombëtar.
• Ekzistenca e industris ndotëse (edhe pse janë bërë hapa pozitiv në këtë derjtim)
• Ndërtime në toka bujqësore
• Qasje e pamjaftueshme në fonde investive dhe Zhvillimore.
• Subvencionim i pamjaftueshëm i fermerëve.
• Informim jo i mjaftueshëm i bizneseve dhe qytetarëve rreth granteve nga donatorët e ndryshëm.
• Mungesë e resurseve njerëzore me profil në bujqësi dhe turizëm.
• Buxhet i pamjaftueshëm komunal për mbështetje më të theksuar të bizneseve vendore.
• Dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës.
• Mungesë e kulturës së promovimit dhe konsumimit të produkteve vendore.
• Mos shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe derdhja e ujërave të zeza në lumenjë.

MUNDËSITË
• Vazhdim i shfrytëzimit të mundësive të mbështetjes nga qeveria qendrore.
• Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë.
• Zhvillimi i turizmit vendor nëpërmjet promovimit të resurseve natyrore në veqanti asaj malore, peizazheve dhe trashëgimisë kulturore.
• Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake.
• Shfrytëzimi i fondeve të BE-së dhe i skemave të granteve për zhvillim.
• Lehtësimi i procedurave administrative rreth regjistrimit të bizneseve.
• Ofrimi i trajnimeve në baza të rregullta për bizneset ekzistuese dhe ato të reja, me theks të veçantë në udhëzimet rreth aplikimit për grante.
• Ruajtja e mjedisit si riciklimi i mbeturinave, rregullimi i shtratit të lumenjve, rritja e hapësirave të sipërfaqeve të pyllëzuara dhe hapësirave të gjelbëruara.

RREZIQET
• Zbatimi I ulët i ligjeve dhe administrate e ngathtë e gjykatave (proceset marrin vite).
• Migrim I rinisë.
• Zvogëlimi i vazhdueshëm i fondit të tokës bujqësore.
• Teknologjia e vjetërsuar për punimin e tokës bujqësore.
• Ekonomia joformale dhe evazioni fiscal.
• Konkurrencë jo e drejtë si pasojë e prezencës së ekonomisë joformale
• Zvogëlimi i interesimit të donatorëve për investime
• Rënie e nivelit të arsimimit nga viti në vit.
• Emigrimi i kuadrove profesionale.

## Vizioni

Hani i Elezit do të formësohet në rajon si nyje ekonomike, duke ndërtuar zhvillimin e saj mbi industrinë prodhuese, bujqësinë, trashëgiminë dhe duke shfrytëzuar pozitën gjeografike të saj për një shtrirje të horizontit në shumë sektor.

## Misioni

Zhvillimi i qëndrushëm urban, ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore, mjedis i pastër, përkrahje e industrisë prodhuese dhe bujqësisë do të jenë pikësynimet që Komuna e Hanit të Elezit do të ketë, si praktika të cilat përmes këtij dokumenti strategjik synohen të arrihen.

## Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2028

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2028 për komunën e Hani I Elezit ka edhe planin e vet të zbatimit që mbulon periudhën 2024-2028, i cili përbëhet nga aktivitetet, afati i zbatimit të tyre, kostoja totale, burimi i financimit dhe institucionet udhëheqëse që do realizojnë. Plani i zbatimit të strategjisë do të rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në strategji. Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal përbëhet nga indikatorët matës, të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike në strategji. Megjithëse komuna do të monitorojë dhe paraqesë raporte të rregullta, është e domosdoshme të vlerësohet nëse janë arritur rezultatet e synuara. Komuna do ti monitoroj gjatë gjithë kohës së implementimit.

# Objektivat e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik

## ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TURIZMI

### 1. Promovimi i Komunës së Hanit të Elezit në rajon

1. Organizimi i panaireve vendore
2. Hartimi dhe plotësimi i dokumenteve informative dhe prezantimi i tyre përpara komuniteteve duke përfshirë kampanja, webfaqe promovuese, evente të ndryshme
3. Hartimi i strategjive të ndryshme sektoriale
4. Fushata promovuese përmes potencialeve zhvillimore duke përfshirë pikat me mundësi turizmi
5. Organizimi i takimeve informuese rreth mundësive zhvillimore të komunës me mërgatën dhe mundësive për investime
6. Shenjëzimi apo vendosja e tabelave informuese për zonat me rëndësi
7. Pjesëmarrje në panairet ndërkombëtare duke promovuar vlerat e komunës

### 2. Zhvillimi i pikave me potencial turistik

1. Hartimi i Strategjisë për Turizëm
2. Dizajnimi i parqeve rekreative në fshatin Gorancë dhe në Paldenicë
3. Krijimi i hapësirave turistike malore dhe krijimi i mundësive për bujtina dhe gastronomi
4. Krijimi i shtigjeve të ecjes dhe çiklizmit malor nëpër zonat rurale
5. Investime të mëtutjeshme tek Bllaca 99
6. Rregullimi i hapësirës tek zona e shkronjave "UÇK"
7. Hartimi digjital i Hartës Turistike

### 3. Zhvillim i qëndrushëm ekonomik

1. Shqyrtimi i Hartave Zonale të Komunës
2. Rregullimi i infrastrukturës teknike për zonat ekonomike të caktuara
3. Rregullimi i infrastrukturës së Tregut Ditor në qytet
4. Minimizimi i ndotjes në mjedis nga industritë prodhuese dhe faktorët ndotës të tjerë
5. Shtimi i shiritave të gjelbërimit pranë zonave ekonomike dhe zonave urbane ku ndotja është më e theksuar
6. Investimet tek burimet e ujit mineral në Han të Elezit në partneritet publiko-privat
7. Partneritet me donatorët e jashtëm për përkrahjen e bizneseve prodhuese lokale për mundësitë e eksportit të prodhimeve
8. Mbështetja/subvencionimi i bizneseve inovative fillestare në bazë vjetore
9. Organizimi i takimeve informuese dhe aktiviteteve të tjera me qëllim të orientimit në karrierë dhe aftësimit për punë
10. Angazhimi i praktikantëve të rinjë në institucionet publike me qëllim të përfitimit të përvojave institucionale
11. Hartimi i programeve për ringjalljen e zanateve të vjetra
12. Organizimi i konferencave dhe punëtorive me fokus ekonomin

## ARSIMI

### 1. Rritja e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme

1. Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore
2. Rregullimi i hapësirave të jashtme shkollore
3. Rregullimi i infrastrukturës në Institucionin Parashkollorë

4. Mirëmbajtja dhe furnizimi i vazhdueshëm me inventar dhe pajisje të nevojshme për institucionet arsimore

### 2. Ngritja e cilësis në arsimin parauniversitar

1. Konsilidimi i mekanizmave për sigurim të cilësis dhe ofrimit të trajnimeve për mësimdhënje më cilësore
2. Punëtori me fokus orientimin në profesion

## KULTURË RINI DHE SPORT

### 1. Promovimi i kulturës dhe sportit në Han të Elezit

1. Përgatitja e kalendarit dhe shënimi i aktiviteteve
2. Organizimi dhe pjesëmarrja në gara komunale dhe ndërkomunale
3. Kampanja promovuese
4. Akademi dhe evente të ndryshme
5. Panaire vendore dhe ndërkombëtare
6. Subvencionimi i OJQ-ve
7. Përkrahja e sh.k.a Sharri në manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare

### 2. Rivitalizimi i objekteve me trashigimi

1. Infrastrukturë e përmirësuar tek shkolla Muze
2. Konzervim dhe restaurimi i objekteve me trashegimi në Pust e Nikës
3. Intervenimi në depot e parkut të qytetit dhe kthimi i tyre në hapësira për ekspozita

### 3. Hartimi i planit për rini

1. Organizimi i festivale, Teatrove, Muzikaleve, Shfaqjeve Dokumentareve
2. Organizimi i ekspozitave në pikturë dhe skulpturë
3. Hiking ecje në male

## SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

### 1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore

1. Fushata sensibilizuese për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme
2. Rifunksinalizimi i sektorit të stomatologjisë
3. Aktivitete të ndryshme në ditët ndërkombëtare të shëndetësisë

### 2. Shërime të përmirësuara në shërbimet sociale

1. Hartimi i planit për banim social
2. Aktivitete dhe fushata të ndryshme në kuadër të shërbimeve sociale
3. Pajisja e Komunës me plane hapësinore

## URBANIZËMI DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT

1. **Mbrojtja e mjedisit nga ndotja**
    1. Hartimi i Planit të ri Zhvillimor të Komunës
    2. Hartimi i Hartës Zonale
    3. Hartimi i planit të ri rregullues urban për zonën qendër të Hanit të Elezit
    4. Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis

## BUJQËSIA DHE ZHVILLIM RURAL

1. **Vetëdijesimi i lartë rreth fermave**
    1. Organizimi i panairit lokal
    2. Promovimi I bujqësisë përmes rrjeteve sociale
    3. Fushata senzibilizuese për bujqësi organike
    4. Hartimi i strategjive për mbështetje të fermave
2. **Zhvillimi i fermave**
    1. Subvencionimi i fermave
    2. Rehabilitimi dhe ndërtimi i sistemeve të ujitjes
    3. Krijimi i qendrave grumbulluese të produkteve bujqësore
    4. Hartimi i planeve për menagjimin e kullosave
    5. Organizimi i trajnimeve për fermerët

## SHËRBIMET PUBLIKE

1. **Mirëmbajtja e hapësirave publike**
    1. Mirëmbajtja e rrugëve lokale verë-dimër, hapësirat Publike , varrezat etj
    2. Mirëmbajtja e ndriçimit publik
    3. Mirëmbajtja e kanalizimit
    4. Shtrimin e ndriçimi për dekorimin e qytetit

2. **Ofrimi cilësor i shërbimeve publike**
    1. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal
    2. Pastrimin e deponive ilegale
    3. Vendosjen e shportave të mbeturinave nëpër qytete dhe fshatra

Tabela 1: Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2024-2028 dhe përgjegjësit për implementim

## ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TURIZMI

| Objektivi | Pritshmëritë | Aktiviteti/Projekti | Përgjegjësi për Implementim | Afati i Zbatimit | Vlera e parashikuar | Burimi i Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1. Promovimi i Komunës së Hanit të Elezit në rajon** | ○ Promovimi i potencialeve zhvillimore<br>○ Tërheqje e investimeve të huaja dhe lokale<br>○ Zhvillim ekonomik | 1. Organizimi i panaireve vendore | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2028 | 3,000.00 € | Komuna HE |
| | | 2. Hartimi dhe plotësimi i dokumenteve informative dhe prezantimi i tyre përpara komuniteteve duke përfshirë kampanja, webfaqe promovuese, evente të ndryshme | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2027 | 10,000.00 € | Komuna HE |
| | | 3. Hartimi i strategjive të ndryshme sektoriale | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2025 | 3,500.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |
| | | 4. Fushata promovuese përmes potencialeve zhvillimore duke përfshirë pikat me mundësi turizmi | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2028 | 3,000.00 € | Komuna HE |
| | | 5. Organizimi i takimeve informuese rreth mundësive zhvillimore të komunës me mërgatën dhe mundësive për investime | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2028 | 1,000.00 € | Komuna HE |
| | | 6. Shenjëzimi apo vendosja e tabelave informuese për zonat me rëndësi | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2027 | 4,000.00 € | Komuna HE |
| | | 7. Pjesëmarrje në panairet ndërkombëtare duke promovuar vlerat e komunës | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2028 | 3,000.00 € | Komuna HE |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2. Zhvillimi i pikave me potencial turistik** | ○ Zhvillimi i pikave me potencial turisik<br>○ Hulumtimi i pikave të reja për zhvillim<br>○ Tërheqje e investimeve | 1. Hartimi i Strategjisë për Turizëm | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik<br>Drejtoria për Urbanizëm | 2024-2025 | 3,500.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |
| | | 2. Dizajnimi i parqeve rekreative në fshatin Gorancë dhe në Paldenicë | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024 | 50,000.00 € | Komuna HE |
| | | 3. Krijimi i hapësirave turistike malore dhe krijimi i mundësive për bujtina dhe gastronomi | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik<br>Drejtoria për Urbanizëm | 2025-2026 | 80,000.00 € | Komuna HE |
| | | 4. Krijimi i shtigjeve të ecjes dhe çiklizmit malor nëpër zonat rurale | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik<br>Drejtoria për Urbanizëm | 2025-2026 | 25,000.00 € | Komuna HE<br>Donatorë të jashtëm |
| | | 5. Investime të mëtutjeshme tek Bllaca 99 | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2025 | 50,000.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |
| | | 6. Rregullimi i hapësirës tek zona e shkronjave "UÇK" | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2025 | 50,000.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |
| | | 7. Hartimi digjital i Hartës Turistike | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2026 | 5,000.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |
| **3. Zhvillim I qëndrushëm ekonomik** | ○ Zhvillim I balancuar I zonave me potencial ekonomik<br>○ Shfrytëzueshmëria racionale e burimeve natyrore<br>○ Mbrojtje e mjedisit nga industria prodhuese<br>○ Krijimi I zonave ekonomike | 1. Shqyrtimi i Hartave Zonale të Komunës | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik<br>Drejtoria për Urbanizëm | 2024 | 5,000.00 € | Komuna HE |
| | | 2. Rregullimi i infrastrukturës teknike për zonat ekonomike të caktuara | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik<br>Drejtoria për Urbanizëm | 2024-2027 | 50,000.00 € | Komuna HE<br>Donator të jashtëm |
| | | 3. Rregullimi i infrastrukturës së Tregut Ditor në qytet | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik<br>Drejtoria për Urbanizëm | 2024-2025 | 65,000.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ○ Biznese solide duke shfrytëzuar potencialet e komunës | 4. Minimizimi i ndotjes në mjedis nga industritë prodhuese dhe faktorët ndotës të tjerë | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis | 2024-2028 | 5,000.00 € | Komuna HE |
| | | 5. Shtimi i shiritave të gjelbërimit pranë zonave ekonomike dhe zonave urbane ku ndotja është më e theksuar | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis | 2024-2027 | 35,000.00 € | Komuna HE Sektori privat-bizneset |
| | | 6. Investimet tek burimet e ujit mineral në Han të Elezit në partneritet publiko-privat | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2025 | 100,000.00 € | Komuna HE |
| | | 7. Partneritet me donatorët e jashtëm për përkrahjen e bizneseve prodhuese lokale për mundësitë e eksportit të prodhimeve | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2025-2027 | 12,000.00 € | Komuna HE |
| | | 8. Mbështetja/subvencionimi i bizneseve inovative fillestare në bazë vjetore | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2024-2027 | 20,000.00 € | Komuna HE Organizata të huaja |
| | | 9. Organizimi i takimeve informuese dhe aktiviteteve të tjera me qëllim të orientimit në karrierë dhe aftësimit për punë | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Drejtoria për Arsim | 2024-2028 | 5,000.00 € | Komuna HE Organizata të huaja |
| | | 10. Angazhimi i praktikantëve të rinjë në institucionet publike me qëllim të përfitimit të përvojave institucionale | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Drejtoria për Arsim Drejtoria për Administratë | 2024-2027 | 4,000.00 € | Komuna HE |
| | | 11. Hartimi i programeve për ringjalljen e zanateve të vjetra | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 2025-2027 | 10,000.00 € | Komuna HE |
| | | 12. Organizimi i konferencave dhe punëtorive me fokus ekonominë | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Drejtoria për Rini | 2024-2028 | 5,000.00 € | Komuna HE Organizata të huaja |

# ARSIMI

| Objektivi | Pritshmëritë | Aktiviteti/Projekti | Përgjegjësi për Implementim | Afati i Zbatimit | Kostoja e parashikuar | Burimi i Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Rritja e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme | -Ngritje e cilësisë në arsim<br>-Qasje e barabartë në shkollim | 1. Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore | DKA<br>DUKMM | 2024-2026 | 100,000.00 | Komuna HE<br>Masht |
| | | 2. Rregullimi i hapësirave të jashtme shkollore | MASH-i | 2024-2026 | 60,000.00 | Komuna HE<br>Donatorë të Jashtëm |
| | | 3. Rregullimi i infrastrukturës në Institucionin Parashkollorë | DKA<br>DUKMM | 2024-2026 | 50,000.00 | Komuna HE<br>Donatorë të Jashtëm |
| | | 4. Mirëmbajtja dhe furnizimi i vazhdueshëm me inventar dhe pajisje të nevojshme për institucionet arsimore | DKA<br>MASH-i | 2024-2026 | 50,000.00 | Komuna HE<br>Donatorë të Jashtëm |
| 5. Ngritja e cilësis në arsimin parauniversitar | -Rini të orientuar në profile dhe të gatshëm për treg të punës | 1. Konsilidimi i mekanizmave për sigurim të cilësis dhe ofrimit të trajnimeve për mësimdhënje më cilësore. | DKA<br>MASHT<br>OJQ | 2024-2028 | 10,000.00 | Komuna HE<br>Masht<br>Donatorë të Jashtëm |
| | | 2. Punëtori me fokus orientimin në profesion | DKA | 2024-2028 | | Komuna HE<br>Masht<br>Donatorë të Jashtëm |

## KULTURË RINI DHE SPORT

| Objektivi | Pritshmëritë | Aktiviteti/Projekti | Përgjegjësi për Implementim | Afati i Zbatimit | Kostoja e parashikuar | Burimi i Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. **Promovimi i kulturës dhe sportit në Han të Elezit** | -Aktivitete më të shumta rinore<br>-Promovim i vendit<br>-Tërheqje e investimeve në sport dhe kulturë | 1. Përgatitja e kalendarit dhe shënimi i aktiviteteve | DKRS | 2024-2026 | 3,000.00 | Komuna HE |
| | | 2. Organizimi dhe pjesëmarrja në gara komunale dhe ndërkomunale | DKRS<br>MKRS | 2024-2026 | 3,000.00 | Komuna HE<br>MKRS |
| | | 3. Kampanja promovuese | DKRS<br>OJQ | 2024-2026 | 3,000.00 | Komuna HE |
| | | 4. Akademi dhe evente të ndryshme | DKRS | 2024-2026 | 5,000.00 | Komuna HE |
| | | 5. Panaire vendore dhe ndërkombëtare | DKRS<br>OJQ | 2024-2028 | 5,000.00 | Komuna HE<br>Donatorë të Jashtëm |
| | | 6. Subvencionimi i OJQ-ve | DKRS | 2024-2028 | 30,000.00 | Komuna HE |
| | | 7. Përkrahja e sh.k.a Sharri në manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare | DKRS<br>OJQ | 2024-2028 | 5,000.00 | Komuna HE<br>Donatorë të Jashtëm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. Rivitalizimi i objekteve me trashigimi | -Mbrojtje e trashëgimisë kulturore<br>-Nxitje të turizmit dhe promovimit | 1. Infrastrukturë e përmirësuar tek shkolla Muze | DKRS | | 100,000.00 | Komuna HE<br>MKRS |
| | | 2. Konzervim dhe restaurimi i objekteve me trashegimi në Pust e Nikës | MKRS<br>DZHET<br>OJQ | 2024-2026 | 50,000.00 | Komuna HE<br>MKRS HE |
| | | 3. Intervenimi në depot e parkut të qytetit dhe kthimi i tyre në hapësira për ekspozita | MKRS<br>DZHET<br>OJQ | | 50,000.00 | Komuna HE<br>Donatorë të Jashtëm |
| 3. Hartimi i planit për rini | -Aktivitete rinore<br>-Socializim i ngritur | 1. Organizimi i festivale, Teatrove, Muzikaleve, Shfaqjeve Dokumentareve | DKRS<br>MKRS<br>DZHET | 2024-2026 | 50,000.00 | Komuna HE<br>MKRS |
| | | 2. Organizimi i ekspozitave në pikturë dhe skulpturë | DKRS<br>DZHET | 2024-2027 | 5,000.00 | Komuna HE<br>Donatorë të Jashtëm |
| | | 3. Hiking ecje në male | DKRS<br>OJQ | 2024-2027 | 1,000.00 | Komuna HE |

# SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

| Objektivi | Pritshmëritë | Aktiviteti/Projekti | Përgjegjësi për Implementim | Afati i Zbatimit | Vlera e parashikuar | Burimi i Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1. Përmirësimi I cilësisë së shërbimeve shëndetësore** | ○ Rritje kushteve shëndetësore<br>○ Sigurimi I hapësirave sipas standardeve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ<br>○ Sigurimi I hapësirave të mjaftueshme për punë më efikase | 1. Fushata sensibilizuese për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, OJQ të ndryshme | 2024-2028 | 5,000.00 € | Komuna HE |
| | | 2. Rifunksinalizimi i sektorit të stomatologjisë | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, OJQ të ndryshme | 2024-2028 | 10,000.00 € | Ministria e Shëndetësisë |
| | | 3. Aktivitete të ndryshme në ditët ndërkombëtare të shëndetësisë | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, OJQ të ndryshme | 2024-2028 | 10,000.00 € | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna HE dhe OJQ të ndryshme. |
| **2. Shërbime të përmirësuara në shërbimet sociale** | ○ Ofrimi kushteve më të mira për banim social<br>○ Vetëdijesim për shërbimet sociale | 1. Hartimi i planit për banim social | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 2024 | 5,000.00 € | Komuna HE dhe OJQ të ndryshme |
| | | 2. Aktivitete dhe fushata të ndryshme në kuadër të shërbimeve sociale | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 2024-2028 | 5,000.00 € | Komuna HE |

# URBANIZËMI DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT

| Objektivi | Pritshmëritë | Aktiviteti/Projekti | Përgjegjësi për Implementim | Afati i Zbatimit | Kostoja e parashikuar | Burimi i Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.Ambient më cilësor dhe zhvillim i qëndrushëm urban | ○ Zhvillim i njëtrajtshëm i vendit<br>○ Reduktim i ndotjes së ajrit<br>○ Reduktim i ndotjes së ujit<br>○ Redukti i ndotjes së tokës | 1. Hartimi i Hartës Zonale | Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit | 2024-2032 | 60,000 | Komuna HE<br>GIZI Gjerman |
| | | 2. Hartimi i planit të ri rregullues urban për zonën qendër të Hanit të Elezit | Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit | 2025-2033 | 40,000 | Komuna HE<br>Donatorët |
| | | 4. Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis | DUKMM<br>DSHP<br>DZHE | 2024-2028 | 300,000 | Komuna HE<br>SharrCem<br>Donatorët |

# BUJQËSIA DHE ZHVILLIM RURAL

| Objektivi | Pritshmëritë | Aktiviteti/Projekti | Përgjegjësi për Implementim | Afati i Zbatimit | Vlera parashikuar | Burimi i Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Vetëdijesimi i lartë rreth fermave | ○ Promovimi i potencialit të fermës<br>○ Zhvillim i bujqësisë organike | 1. Organizimi i panairit lokal | DBPZHR-ja, DZHE | 2024-2028 | 2,500.00 € | Komuna HE<br>Organizatat e huaja |
| | | 2. Promovimi I bujqësisë përmes rrjeteve sociale | DBPZHR-ja, ,DAP | 2024-2028 | 1,000.00 € | Komuna HE |
| | | 3. Fushata senzibilizuese për bujqësi organike | DBPZHR-ja | 2024-2025 | 2,000.00 € | Komuna HE |
| | | 4. Hartimi i strategjive për mbështetje të fermave | DBPZHR-ja, Shoqatat e huaja | 2024-2026 | 2,500.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |
| 2. Zhvillimi i fermave | ○ Zhvillimi i balancuar i sektorëve të bujqësisë<br>○ Mbështetja e fermës me subvencione dhe grante | 1. Subvencionimi i fermave | DBPZHR-ja, MBPZHR-ja | 2023-2028 | 150,000.00 € | Komuna HE, MBPZHR-ja |
| | | 2. Rehabilitimi dhe ndërtimi i sistemeve të ujitjes | DBPZHR-ja | 2025-2028 | 20,000.00 € | Komuna HE |
| | | 3. Krijimi i qendrave grumbulluese të produkteve bujqësore | MBPZHR-ja, Donatorët | 2025-2028 | 30,000.00 € | MBPZXHR-ja<br>Donatorë të jashtëm |
| | | 4. Hartimi i planeve për menagjimin e kullosave | DBPZHR-ja, | 2024-2025 | 2,000.00 € | Komuna HE |
| | | 5. Organizimi i trajnimeve për fermerët | DBPZHR-ja, Organizatat e huaja | 2024-2028 | 1,000.00 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |

## SHËRBIMET PUBLIKE

| Objektivi | Pritshmëritë | Aktiviteti/Projekti | Përgjegjësi për Implementim | Afati i Zbatimit | Kostoja e parashikuar | Burimi i Financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mirëmbajtja e hapësirave publike | ○ Ambient me mirëmbajtje më të mirë<br>○ Infrastrukturë më të përmirësuar | 1. Mirëmbajtja e rrugëve lokale verë-dimër, hapësirat Publike , varrezat etj | Npl Pastrimi sh.a | 2024-2028 | Për çdo vit kalendarik<br>203200 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |
| | | 2. Mirëmbajtja e ndriçimit publik | DSHPE<br>Operatorët Ekonomik | 2024- 2028 | 60,000 € | Komuna HE |
| | | 3. Mirëmbajtja e kanalizimit | DSHPE<br>Operatorët Ekonomik | 2024-2028 | 40,000 € | Komuna HE |
| | | 4. Shtrimin e ndriçimi për dekorimin e qytetit | DSHPE<br>Donator të jashtëm | 2024-2028 | 40,000 € | Komuna HE<br>Organizata të huaja |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2. Ofrimi cilësor i shërbimeve publike** | ○ Shërbime më të përmirësuara të mbeturinave<br>○ Mirëmbajtje të rrugëve | 1. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | DSHPE<br>Operatorët Ekonomik | 2024-2028 | 10,000 € | Komuna HE |
| | | 2. Pastrimin e deponive ilegale | DSHPE<br>DUKMM | 2024-2028 | 20,000 € | Komuna HE<br>Donator të tjerë |
| | | 3. Vendosjen e shportave të mbeturinave nëpër qytete dhe fshatra | DSHPE<br>OJQ<br>DUKMM | 2024-2028 | 10,000€ | Komuna HE |

**Republika e Kosovës / Republic of Kosova**
**Komuna -Municipality**
**Hani i Elezit**

**02/Nr.10771 /2023**

| | |
|---|---|
| **DATA:** | 28.12.2023 |
| **PËR :** | Kuvendin e Komunës |
| **NGA:** | Kryetari i Komunës<br>z. Mehmet Ballazhi |
| **LËNDA:** | Shkresë Përcjellëse: Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012 |

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim propozim vendimin për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.469/2012.

Shkresës përcjellëse ja bashkangjesim dokumentacionet:
Kërkesën nga Bashkësia Islame dega në Han të Elezit,
Propozim vendimin nga Kryetari i Komunës dhe
Vendimin për heqjen e shpenzimeve të varrimit me numër 01/Nr.469/2012

Me respekt

Republika e Kosovës / Republic of Kosova

Komuna - Municipality

Hani i Elezit

**Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008 neni 58, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës këtë Propozim Vendim:**

## PROPOZIM VENDIM

### PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/NR.469/2012

1. Miratohet propozim vendimin për rritjen e shumës së shpenzimeve të rasteve mortore në Komunën e Hanit të Elezit, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e njëjtë.

2. Në bazë të kërkesës së Bashkësisë Islame 10/Nr.10761/2023 e datës 28.12.2023 , dega në Han të Elezit, për arsye të ngritjes së çmimeve dhe mos mbulimit të shpenzimeve të çmimeve në treg propozojmë që të miratohet kjo kërkesë dhe të ndryshohet shuma prej 170 €, në 250 €.

3. Ky propozim vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Propozim vendim njoftohen:

-Kryetari i Komunës,
-Bashkësinë Islame dega në Han të Elezit,
-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
-Arkivi i Komunës.

**Hani i Elezit:**
**Data: 28.12.2023**

**Kryetari i Komunës**
**Mehmet Ballazhi**

Republika e Kosovës
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
The Islamic Community of Republic of Kosova
Këshilli i Bashkësisë Islame - Hani i Elezit
The Council of Islamic Community – Hani i Elezit

Nr. 38/2023 Data: 26.12.2023

جمهورية كوسوفا
الإتحاد الإسلامي في كوسوفا
الوقف الإسلامي في هاني آلزت
الرقم ______ التاريخ ______

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - OPSTINA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT
Nr.i Prot. 10/10761
Nr.i Faq. 1 Data 28.12.'23

KUVENDIT KOMUNAL HANI I ELEZIT

Drejtoria e shërbimeve publike

z.Arsim Dernjani

# KËRKESË

Lënda: Ngritja e çmimit të pagesës për tarifen e përgatitjes dhe përcjelljes së xhenazes, për shkak të inflacionit të përgjithshëm në nivel shtetëror, nga 170 (Njëqindeshtatëdhjetë) euro në **250 (Dyqindepesëdhjetë) euro**, me kushtet e parapara sipas marrëveshjes paraprake

Gjithashtu kërkojmë nga Kuvendi Komunal që Këshillit të Bashkësisë Islame në Han të Elezit në vend të Çertifikatës së vdekjes siç ka qenë më pare ti kërkohet ***Raporti Mjekësor i vdekjes*** nga Ambulanca si dëshmi për kryerjen e shërbimeve të varrimit

Arsyetim:

Duke pasë në konsideratë vështërsitë me të cilat po ballafaqohemi ne si Institucion në mosmbulimin e shpenzimeve për shkak të ngritjes së çmimeve në tregë, kërkojmë nga ju të nderuar një ngritje simbolike në kuadër të tarifës së përgjithëshme të xhenazes, ashtu siq e kemi përmend më lartë.

Mbesim me shpresë se kërkesa jonë do të aprovohe!

KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME • THE COUNCIL OF ISLAMIC COMMUNITY • HANI I ELEZIT

Kryetari

Dr.sci. Musa Vila

Republika e Kosovës
Republic of Kosova

Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

*01/ Nr. 469/2012*

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008 nenit 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 15, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2012 mori:

VENDIM

PËR

HEQJEN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT

I

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 02/469/2012 për Heqjen e shpenzimeve të varrimit për të gjitha rastet mortore ne Komunën e Hanit të Elezit.

II

Në baze te diskutimeve në mes të BI ( Bashkësisë Islame), dega në Han të Elezit, shpenzimet e varrimit qe behen me rastin e vdekjes se një individi janë në vlerë prej 170 €.

III

Shpenzimet e varrimit nga pika II e këtij vendimi janë si në vijim:

- Lajmërimi
- Pastrimi i Xhenazes
- Derrasat e varrimit
- Mbeshtjellesi ( qefini )
- Falja e xhenazes
- Çertifikata e Vdekjes

IV

Mjetet do të merren nga kategoria për Mallra dhe Shërbime në kuadër të Drejtorisë se Sherbimeve Publike.

V

Pagesa e shpenzimeve do te behet çdo tre muaj nga Komuna e Hanit të Elezit në bazë te numrit te vdekjeve.

VI

Shpenzimet që do të hiqen me rastin e vdekjes së një individi do të dëshmohen me prezantimin e certifikatës së vdekjes nga Bashkësia Islame.

VII

Me këte vendim qytetarët nuk lirohen nga pagesa e anëtarësisë së Bashkësisë Islame.

VIII

Ky vendim hynë ne fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit dhe pas nenshkrimit të marrëveshjes në mes Komunës dhe Bashkësinë Islame, dega në Han të Elezit.

IX

Me këte Vendim njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkësinë Islame dega në Han të Elezit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

*Hani i Elezit:*
Data: 01.*02.2012*

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi